



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Nr. 001/060 – 77029

Më: 18 qershor 2024

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 30 paragrafit 1 dhe nenit 35 paragrafit 2, të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, dt. 15 tetor 2008, thërres mbledhjen e VII/2024 (shtatë) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, e cila do të mbahet më **27 qershor 2024 (e enjte)**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në **ora 10:00**.

Prandaj, ftoheni që në cilësinë e anëtarit të Kuvendit të Komunës, të merrni pjesë në punën e kësaj mbledhjeje, duke ju përmbajtur orës, datës dhe vendit të caktuar.

Për punën e kësaj mbledhjeje, propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 30 maj 2024, vazhduar më 04 qershor 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (2025-2027);
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;
6. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar-qershor 2024;
7. Informatë rreth raportit së punës të Zyrës për Integritet Evropian për vitin 2023;
8. Raporti i Këshillit të fshatit Zym i Hasit për periudhën janar-qershor 2024;



Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

SKUPŠTINA OPŠTINE PRIZREN

Br.001/060-77029

Dana:18 juna 2024

Na osnovu člana 43 Zakona za Lokalnu Samoupravu, člana 30 stav 1 i član 35 stav 2, Statuta opštine Prizren, br. 01/011-5643, dana 15 oktobra 2008 sazivam VII (sedmu) redovnu sednicu Skupštine opštine Prizren koja će se održati **27 juna 2024 (Četvrtak)**, u sali za sastanke skupštine opštine sa početkom od **10:00 časova**.

Stoga se pozivate da u svojstvu člana Skupštine opštine učestvujete na rad ove sednice, pridržavajući se vremenu, danu i određenom mestu.

Za rad ovog sastanka predlažem ovaj

DNEVNI RED

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika od dana 28 maja 2024;
2. Razmatranje i usvajanje dnevnog reda;
3. Podizanje raznih pitanje odbornika;
4. Razmatranje i usvajanje Srednjoročnog Okvira Budžeta (2025-2027);
5. Razmatranje i usvajanje prijedlog-odluke o objavljivanju opšteg javnog interesa
6. Izveštaj rada Gradonačelnika opštine za period januar-juni 2024;
7. Informacija o izveštaju rada Kancelarije za Evropske Integracije za 2023 godinu;
8. Izveštaj Saveta sela Zjum Hasa za period januar-juni 2024;



Antigona Bytyqi
Predsedavajuća Skupštine



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

PRİZREN BELEDİYE MECLİSİ

No. 001/060 – 77029

Tarih : 18 Haziran 2024



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Yerel Özyönetim Kanun'un 43.maddesi, 15 Ekim 2008 tarihli ve 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün 30. Maddesi, 1. Fıkrası, 35. Maddesi, 2. Fıkrası gereğince **27 Haziran 2024 tarihinde (perşembe günü)** saat **10.00'dan** başlayarak **"Beyaz Evde"** Prizren Belediye Meclisi oturum salonunda düzenlenecek olan Prizren Belediye Meclisin VII./2024 (yedinci) düzenli oturumunu çağırıyorum. Belediye Meclisi üyesi niteliğinde işbu oturum çalışmaları için belirtilen saat, tarih ve yerde katılmanız üzere davetlisiniz:

İşbu toplantı için şu gündem noktaları belirlenmiştir.

G Ü N D E M

1. 30 Mayıs 2024 tarihli ve onun devamı olan 04 Haziran 2024 tarihli toplantı tutanakların görüşülmesi ve onaylanması;
2. Gündemin görüşülmesi ve onaylanması;
3. Meclis üyelerin soruları ve çeşitli konuların dile getirilmesi;
4. (2025-2027) Orta Vadeli Bütçe Çerçevesinin görüşülmesi ve onaylanması;
5. Genel çıkarın ilan edilmesi ile ilgili öneri – kararın görüşülmesi ve onaylanması
6. Ocak – Haziran 2024 dönemine ilişkin Belediye Başkan'ın çalışma raporu;
7. 2023 yılına ilişkin Avrupa Entegrasyon Ofisin çalışma raporu hakkında bilgi;
8. Ocak – Haziran 2024 dönemine ilişkin Zym i Hasit köy kurulun raporu;



Meclis Başkanı
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBALI

Nga mbledhja VI / 2024 e rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 30 maj 2024 e vazhduar më 04 qershor 2024 duke filluar nga ora 10:00, në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

Në fillim të mbledhjes ishin të pranishëm 27 anëtarë të Kuvendit, u bashkëngjiten edhe të tjerë.

Më 30 maj të pranishëm në mbledhje ishin një pjesë e ekzekutivit komunal, ndërsa më 4 qershor ishin shumica e ekzekutivit komunal, nënkryetari.

Po ashtu të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, OSBE-ja dhe përfaqësuesit e mediemeve.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Atëherë, sipas rekomandimeve të KPF-së për këtë mbledhje kemi këtë rend dite:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve: 28 mars 2024 (rregullt); 23 prill 2024 (jashtëzakonshme); 30 prill e vazhduar më 03 maj 2024 (rregullt) ;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 001/011-53593 të datës 23 prill 2024;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr.01/011-3250 dt.08.03.2012 për përdorimin e gjuhëve në komunën e Prizrenit;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për shërbime komunale në Komunën e Prizrenit;
7. Miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimeve (sipas rekomandimeve të MMPHI-së);
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit të punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës (2024-2026);
9. Informatë rreth raportit të punës së zyrës-njësisë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, për vitin 2023.

Pa humbur kohë po fillojmë menjëherë me pikën e parë që ka të bëjë me procesverbalet. Po Dafina Bllaca fjalën.

Dafina Bllaca (PDK): Përshëndetje kryesuese, përshëndetje të gjithë kolegë kuvendarë. Të gjithë e dimë që një seancë mbahet ku kuvendarët duhet të drejtojnë çështje rreth ekzekutivit, drejtuar edhe kryetarit. Ndërsa sot nuk po shoh që kemi kushte për të vazhduar me seancë përderisa është një papërgjegjësi aq e madhe, ku para nesh nuk është as ekzekutivi, nuk është as kryetari, as nënkryetari. Nuk e di çfarë kushte kemi me vazhdu ne për me mbajtë këtë seancë!

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Dafin. Dikush tjetër rreth procesverbaleve te pika e parë jemi, po Dafina.

Dafina Alishani (LVV): I bashkangjitem emnakes sime, është seriozisht shumë një papërgjegjësi e madhe, mosprezenca e drejtorëve, kryetarit edhe kjo tregon shumë qartë se sa e vlerësojnë kuvendin edhe kuvendarin. Një ditë në muaj e kemi edhe ato më nuk kanë as durim me na dëgju, as durim me i pas kërkesat tona. Nëse mundeni me bë thirrje ekzekutivit edhe kryetarit ose po e lirojmë sallën mbasi s'paskem vlerë ne si kuvend!

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Për drejtorë të tjerë nuk e di, vetëm e di që drejtoresha e arsimit shumë shpejt do të na bashkangjitet, vetëm është në një takim me një delegacion nga Turqia. Kështu që bile kërkoj nga unë që t'ia marrim pyetjet ose t'i shënoni me shkrim. Për të tjerë drejtorë nuk e di se a do të kthehen apo jo, a do të na bashkangjiten. Jemi te pika e parë për procesverbalet, Agim Muqaj fjalën.

Agim Muqaj (AAK): Përshëndetje për të gjithë. Sigurisht dhe unë pajtohem me kolegët paraprakë. Me të vërtetë nuk ka kushte për të vazhduar seancën, sepse ne jemi këtu zëri qytetar dhe duhet të debatojmë, të ngrisim çështje dhe të marrim përgjigje direkt. Kështu mendoj që sot duhet të anulohet këtë seancë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Dikush tjetër rreth procesverbaleve? Unë e hapa si pikë të parë çështjen e procesverbaleve.

Karanfil Haxhillari (LVV): Po shihet këtu me të vërtetë ka një muaj të cilët kuvendarët kemi çështje shumë të rëndësishme për të ngritur këtu. Dhe unë nuk e di në këtë rast, respekt për drejtorët të shëndetësisë, emergjencave të bujqësisë edhe turizmit, por neve këtu do të na bjen me fol vetë me vete. Kemi shumë çështje për të ngritur dhe nuk do të kemi përgjigje. Dhe në këtë rast në momentin që neve nuk kemi përgjigje dhe qytetarët kanë me mbet përsëri në terr informativ sepse kemi mungesë të 90% të ekzekutivit, si dhe kryetarit të komunës. Prandaj edhe unë mendoj që kur të jenë ekzekutivi gati, sepse në fund të ditës, këto pikat e rendit të ditës janë kërkesa të ekzekutivit, të cilët duhet të shtyhen përpara. Dhe neve na thirrin këtu, që t'ia shtyjme pikat e tyre përpara, kurse vetë ata nuk janë këtu. Me të vërtetë nuk është në rregull edhe nuk është fer. Prandaj edhe unë mendoj, a din që le të vetëdijësohet ekzekutivi, le të vijë, të na dëgjojë si kuvendar, mos t'ju ikë obligimeve statutores të komunës dhe pastaj vazhdojmë seancën.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Atëherë meqë u dhanë katër propozime me mendim të njëjtë, po e qes në votim kush është për me vazhdu edhe kush është për me shty për një ditë tjetër.

Dafina Alishani (LVV): Ku kemi të drejtë me vendos a vazhdohet seanca apo jo. Merret prononcimi i gjithë kuvendarëve apo përfaqësuesve të shefave të grupit edhe ose e lirojmë sallën. Kur kemi votuar ne me vazhdu seancën a jo?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po përderisa kam kuorum unë më duhet me vazhdu. Në qoftë se lirohet salla....

Dafina Alishani (LVV): Tash ta prishim kuorumin ne! Po bëni thirrje publike si kryesuese, le të kthehen ekzekutivi, le të kthehen se këtë detyrë e kanë. Këtu kemi ne rregullore të cilat kanë direkt punë me drejtoritë përkatëse. Edhe sponsorizuesit nuk i kemi këtu.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Atëherë qëndrimin VV-ja e dha, vazhdojmë me shefin nga PDK.

Adrit Krasniqi (PDK): Duke e parë që muajt tjetër ka me qenë shumë muaj i ngjeshur sikur me me festa, sikur edhe me seanca të tjera. Tash pak për mos me ra si në banale, ka mundësi edhe ne një ekskursion me bë asambleja. Unë po kërkoj që sot me u mbajt edhe po tentojmë me i telefonuar drejtorëve. Kryetari është me një takim në Prishtinë, nënkryetari është jashtë vendit. Kryetari e kakonfirmuar pjesëmarrjen kur ta kryejmë takimin në Prishtinë. Për drejtorët nuk kemi informata, ata kanë konfirmuar, po presim që në çdo moment me ardh. Ne jemi për me vazhdu kryesuese!

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po, LDK?

Qemal Krasniqi (LDK): Faleminderit. Edhe grupi i kuvendarëve të LDK-së i mbështet parafolësit. Kjo është pabesësi totale. Edhe është e vërtetë që edhe ne si kuvendarë të LDK-së kemi shqetësimet, kërkesat që sot kemi pritur këtu t'i shfaqim, mirëpo mosprezenca e drejtorëve tregon nivelin se ku ka ardhur kuvendi i Prizrenit. Kështu që edhe ne jemi që kjo seancë mos të vazhdojë, derisa drejtorët të jenë prezent.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po e marrim edhe mendimin e AAK-së.

Agim Muqaj (AAK): Sigurisht se dhe aleanca i mbështet parafolësit. Me këtë format ekzekutivi sigurisht se nuk jemi për vazhdimin e seancës.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Nisma?

Shukri Quni (Nisma): Faleminderit kryesuese. Unë i pashë shumë prononcime, por nuk po di tash, diçka paska krisë, po s'kokna në ngjarje për çka koka këtu në pyetje. Ajo mirret vesh për çka. A po atëherë udha mbarë ju qoftë. Unë, drejtoresha po shoh, ne kemi pasur rast që s'kemi pasdrejtorë kurrë, por ne nuk vijmë këtu për drejtorë, po vijmë këtu për me i ngritur çështjet për qytetarë. Në muajin në prill nuk është mbajtur asnjë mbledhje. Kjo është mbledhja e rregullt edhe është fundi, po mendoj muajin maj është fjala. Për çka po doni me e shty ose mos me mbajt këtë mbledhje nuk po e di. Unë s'jam i informuar fare! Unë jam për me u mbajt kjo mbledhje, për asnjë drejtor nuk vij këtu hiç! Po vij për ata qytetarë të cilët më kanë votuar edhe me i ngrit ato çështje. Ne kemi me ngrit këtu çështje, lëreni këto sot, në ndonjë mbledhje tjetër bojkotoni. E sot kemi çështje me ngrit shumë, edhe mbani mbledhjen, se drejtorët mos ardhshin punë e madhe!

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Po vazhdojmë me deklaratimet e partive të tjera, YTHP.

Ertan Simitçi (Ythp): Faleminderit kryesuese. Pse nuk janë këtu drejtorët apo ekzekutiv, le të mendon kryetari edhe le ti heq vërejtjen të gjithë drejtorëve.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju lutem, po flet zoti Ertan, ju lutem, zoti Ymer. Ju lutem.

Ertan Simitçi (Ythp): Kryesuese kështu, pse nuk janë këtu drejtorët, po mendoj që nuk është çështje e jona. Qytetarët e shohin, janë televizionet, janë mediat këtu, si kuvendartë, po mendoj që ne e kemi kryer obligimin, kemi ardhur. Po mendoj që vërejtjet janë me vend, po seanca apo kjo mbledhje duhet të vazhdohet. Pikat e kemi të cilat drejtorët janë kanë qenë sponsorizues. Kur vjen ajo pika, e vlerësojmë a duhet me votu a mos me votu. Përndryshe jemi për me vazhdu.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Atëherë prej subjekteve politike boshnjake nuk kemi. Dafina përsëri fjalën.

Dafina Billaca (PDK): Më lejoni vetëm të potencoj që nuk ka të bëjë aspak me politikë siç edhe i dëgjova disa nga folësit këtu që thanë, qenka një interes apo çfarëdo qoftë që e thanë. Unë jam një kuvendare që kërkoj respekt nga ekzekutivi. Jam me votën e qytetarëve dhe përderisa nuk shoh kuvendar këtu, unë kam të drejtën time të shpreh ato që mendoj, pavarësisht se çfarë qëndrimi mban partia ime.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit po zoti Çuni.

Shukri Quni (Nisma): Shiqoni. Ne kemi mbajtur mbledhje pa asnjë drejtor të ekzekutivit kur ka qenë Vetëvendosja. Keni fotografi, e keni inçizime, ka dalë mos u gut! Kemi mbajtur mbledhje, s'jemi mërzhitur për atë punë hiç. Po e kemi lëshuar mbledhjen kur ka qenë edhe kryetari, edhe plot drejtorë ka pas aty, kemi dalë përjashtë. Jemi arsyetu për çka. Unë ju thashë, nëse keni bisedu ju më herët, është diçka tjetër. Unë s'jam rrjedha për çka! Atëherë, mbledhja le të mbahet, çka kemi me i thënë, t'i thojmë këtu, drejtorat na përgjigjen edhe na kërkojnë prej tyre.

Karanfil Haxhillari (LVV): Cilët drejtor o la Shuk?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Po këta që janë këtu, drejtorët?

Shukri Quni (Nisma): A s'po të dokën ty këta drejtor?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Drejtoresha e arsimit më ka thënë që shumë shpejt do të na bashkangjitet, ndoshta dhe dikush tjetër që nuk më ka lajmëruar. Kryetari gjithashtu paska biseduar me shefin që do të na bashkangjitet, kështu që si kryesuese e kuvendit, jemi organ vendimmarrës, jemi organ i pavarur. Kështu që mundemi me vazhdu, pyetjet të gjitha do t'jua përcjellim drejtorëve, ose për kryetarin nëse keni.

Dafina Alishani (LVV): Kryesuese a bën veç pak. Pikat të cilat janë këtu, të sponsorizuara dhe të cilat kemi ne pyetje lidhur me këto pika, duhet me qenë drejtorët. Bartja e mjeteve është financat. Ku është financat?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): E kemi zyrtarin këtu.

Dafina Alishani (LVV): Drejtorin unë po dua me pyet.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po drejtorin nuk ka mundësi tash me qenë edhe në punëtori me sa e di është....

Dafina Alishani (LVV): Kam çështje, kam çështje për inspektoriat, kam çështje për Dshp-në, kam çështje për arsimin. Ku janë?... Po jo bre, çfarë paraqitni, sa herë kemi paraqit na këtu pyetje, a kemi marrë përgjigje prej drejtorëve të cilët nuk kanë qenë prezent? Aspak! A aq vështirë është me ardhë në muaj një ditë me i ngu' asamblistat? Nëse, ne po e luajmë rolin tonë, nëse ne po e përfaqësojmë qytetarin, edhe qytetari duhet me i pa kështu ekzekutivin, edhe ata janë për këtë punë. Pse kjo arrogancë? Edhe pse arsyetoni arrogancën e ekzekutivit. Kjo s'po më hyn në kokë mua. Ju keni liruar sallë për shkak të arrogancës së disa drejtorëve në mandatin e kaluar. Sot po keni tolerancë për arrogancë. Kjo veç çka e fuqizon kuvendin, të gjitha drejtorët këtu kur janë e mbajmë. Ne kemi pyetje për secilën drejtori.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Të lutem Dafinë, nuk jam duke e mbrojtur arrogancën e askujt edhe askush nuk është duke ju ndalë me e liruar sallën. Po si kryesuese po propozoj ta vazhdojmë me mbledhjen. E drejta juaj është kush do me e liru. Karanfil Haxhillari edhe zoti Quni pastaj se me radhë qysh e keni kërkuar.

Karanfil Haxhillari (LVV): Neve thjesht po kërkojmë që kuvendarët të respektohen nga ekzekutivi. Shtuar kjo edhe nga seanca e fundit ku drejtori në fjalë i cili sot s'ka ardhur, në bisedë e sipër thotë që unë nuk ndi për kuvendar, për ju. Prandaj, unë kam prit që ai që të vijë dhe të ballafaqohet me kuvendar. Dhe ai sot nuk vjen dhe lëshimi i sallës tonë është për t'i vetëdijësuar dhe për t'i ndërgjegjësuar drejtorët e ekzekutivit, të cilët marrin rroga nga taksapaguesit e qytetit. Dhe ne e lëshojmë sallën tash.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Zotëri Quni.

Shukri Quni (Nisma): Dëgjo. Ne në fillim thamë, unë në fillim thashë, këtu paska diçka. Thashë s'jam informuar. Unë jam sot më i mllefur se ti me i kritiku, duke filluar prej drejtoreshës së arsimit, prej drejtorit të shërbimeve publike, edhe drejtorat që s'janë. Unë jam më i mllefur se ti sot. Por që ju paske pasur, qatë e pashë ju diçka paskët... jo po u pa kjo tash. Se për me mbrojt arrogancën Dafina Alishani, kurrë s'e kam mbrojtur, drejtësinë po. Drejtësinë po! Për arrogancë, kërkuar s'ja mbroj hiç, as nuk ndij për atë punë. Vetëm pak, ta kryej unë! Për që kemi lëshu mbledhje, sa keni qenë ju, bile sot më krijuat mua një lloj kundërshtari pa lidhje. Se kam pas me kërkuar falje disa drejtorëve që e kanë kaluar mandatin e kaluar, sot. Por ratë ju, qatë s'ka me e bë! Sepse me sjellje... kadal more se s'jeni duke ikur, çfarë keni? Po ç'ka paskët? Po ikni!

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju lutem, le ta përfundon zotëri Quni edhe me radhë do ta merrni fjalën. Pa i përfunduar kolegu qysh me ja nis tjetrin me fol, s'po kuptoj.

Shukri Quni (Nisma): Ti prit, unë e kryj... Unë e kam dalë prej mbledhjes për shkak teje bre. Unë për shkak teje e kam lëshuar mbledhjen këtu në asamble, ta kam dhënë fjalën, kam me të votuar edhe kam ndejt në mbledhje dhe s'kam ndi as për kryetarin e partisë, as për kryetarin, as për kërënd hiç. As tash s'ndi për kërënd. Po le atë muhabet ti! Unë s'jam te dit çka keni, unë këtë po dua me dit. Unë jam ka ju tregoj shqip, unë sot kam pas me prishë më shumë se ju, kam pas me ju kërku disa drejtorëve që sot ata janë në vendin e tyre, që këta janë duke punuar më keq se ata. Me

i kërku atyre falje që kam gabuar, që ju kemi kundërvu ti Dafinë që po thua. Arrogancën nuk e mbroj, e mbroj të drejtën. Unë kam pasur sot me ju treguar atyre, po fal juve, sot ju i pshtutë ata. Çka jo?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Të lutem, Karanfil, ulu prej vendit, të lutem.

Shukri Quni (Nisma): Po ti, përmendja, thua drejtorit. Çka paskan more?.

Karanfil Haxhillari (LVV): Kryesuese, në momentin që drejtorët vijnë nga pushimet, vijnë nga eksekurzionet, te punëtorët, çfarë po di unë, dhe janë të gatshëm të vijnë në seancë, neve na thirr si kuvendar dhe vijmë këtu.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po këta drejtorë të tjerë që janë prezent këtu, Karanfil? Tash. Në qoftë se ata nuk ju kanë respektuar neve si kuvendarë edhe ne këta që janë këtu. Faruku fjalën e ka, pastaj edhe Bujari. Ju lutem. Ju lutem, ju lutem. Bujar Hasani fjalën e ka. Të nderuar kolegë kuvendarë, të nderuar pranishëm. Me sa po e shohim nuk kemi kuorum me vazhdu punimet e kësaj mbledhje. Për kohën...

Shukri Quni (Nisma): Kanë dalë të gjithë. Kryesuese. Unë, kur e ke marrë detyrën, koxha të kam pas dhënë vërejtje. Koxha i ke marrë ato vërejtje jo për me u përmirësu, po e kam ditur që vjen kjo. Se është fundi i mandatit tash. Në fund të mandatit lëshohen mbledhjet. Janë ato interesat që s'ja kanë kryer njerëzve, personale, se jo për qytetarë, se më pas kanë për qytetarë tash, ku te ngritja e çështjeve edhe që i kemi këto probleme që i ngrejme këtu, i kishim ngritur secili dhe kishim dalë për jashtë. Edhe unë kisha dalë. Po kaq që ke e organizuar, që unë s'jam i njoftuar, se më shumë jam duke mbrojtur opozitën sesa pozitën. Më shumë jam duke kritikuar unë drejtorët, kam pas sot me kritiku drejtoreshën e arsimit, drejtorin e shërbimeve publike, e di ai, se mbrëmë veç kam kontaktuar me të, edhe drejtorin e urbanizimit e drejtorin e inspektorateve. Unë sjam në ngjarje, tash qohen e dalin pa e ditur ne tjerët, kjo s'është në rregull. Po faji është normal te ekzekutivi. E kështu që mos u habit tash, se jemi nga shkojmë tash për 2025 veç kemi hyrë, ka zgjedhje. Këto ndodhin. Mjerë qytetarët, kënd na kanë votuar. Qe, këtu është problemi. Se kur të hy unë disave me ju thënë këtu, që kanë hyrë në punë, qeky kuvendi i ka shti në punë, që ajo votë e qytetarit. Kur hy me ju thënë disave që kanë kryer për interesa personale, prej atyre drejtorëve të ekzekutivit. Unë edhe një fjalë e kam përdorur. Kur e do njerin... e kam përdor një fjalë shumë banale, po tash nuk po e përdori. Po po e përdori pak më moderne. Kur e ke njerin domethënë që e do për interes vecen, interesi soset, ajo të jetë në oborr. Tash është sos interesi, edhe këto tash i keni. Keni me i pas hala. Kjo fillimi është, e keni me e pa tash e mbrapa.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Quni. Egzona, pastaj Ertani.

Egzona Hoxhaj (PDK): Po kryesuese, për shkak që qysh po kërkohet përgjegjësi prej ekzekutivi, edhe ne si legjislativ e kemi përgjegjësinë ndaj qytetarëve të komunës Prizren, për shkak që ekzekutivi është i zgjedhur prej kryetarit, por ne jemi zgjedhur direkt prej votës së qytetarit. Kështu që sot të gjithë ata që e lëshuan këtë sallë, më së pari kanë përgjegjësi ndaj kuvendit të fëmijëve, të cilët po presin që edhe me u votu drafti i punës të rregullores për të drejtat e fëmijëve në komunën e Prizrenit, që e kanë kërkuar që ky dokument kaq i rëndësishëm për ta, të votohet para 1 qershorit. Po qysh po shihet shumica dhe opozita i tradhëtuan me një farë forme edhe pse në mbledhjen e

KPF-së, të gjithë kemi të pajtimit që me realizu këtë kërkesë të tyre. Kështu që qytetarët e Prizrenit le ta shohin edhe vetë kanë e kanë votuar.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Ertani.

Ertan Simitçi (Ythp): Faleminderit kryesuese. Është diçka që legislative ka detyrën kompetencat e të veta, ekzekutivi ka të veta. Sot qytetarët e komunës së Prizrenit përmes televizionave, përmes rrjeteve sociale e shikojnë edhe monitorojnë të gjitha këto. Pa asnjë arsytim përveç politikës apo inatrive, legjislativi me liru sallën po mendoj që nuk është e drejtë. Kanë arsytetime të ndryshme çdo parti politike, po respekt ndaj qytetarëve, respekt ndaj fëmijëve që sot janë këtu. Respekt të gjithë punëtorët e komunës që po përbëjnë përgatitjet për sot edhe ne sot me lëshu sallën me si me thënë, me caktuar për një datë tjetër po mendoj që hiç nuk është etike. Andaj, mirë është kryesuese që të bëjmë një takim me shefat e grupeve sa më shpejt, që sot të vazhdohet kjo seanca. Nëse caktohet me një datë tjetër, besoni që do të kemi, të gjithë i kemi obligimet e ndryshme, mediat e kanë përgjegjësi të ndryshme. Në qershor kemi aktivitete të ndryshme, po ngarkohet qyteti pa asnjë arsytim, pa asnjë fakt.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Ertan. Në qoftë se nuk ka dikush tjetër.

Adrit Krasniqi (PDK): Atëherë, edhe unë po propozoj që sot të mbliidhen shefat e grupeve edhe ta vendosim a me vazhduar sot apo ndonjë ditë tjetër. Për me vazhduar ndonjë ditë tjetër, qershori është shumë i ngarkuar, si me seanca solemne, si me seancën në rregull, si me aktivitete të tjera. Ju kisha lutur që sa më shpejt sot me i thirr shefat e grupeve dhe me mundësi me vazhduar sot.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit të gjithë. Atëherë po e ndërprejmë për momentin, po i thërras menjëherë shefat e grupeve që ta kemi një takim. Po, takohemi në ora 11:10 min.

PAS TAKIMIT

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Të nderuara media, të pranishëm. Atëherë u rikthëm përsëri në sallën e kuvendit dhe pas një takimi disa minutësh të cilët e mbajtëm me shefat e grupeve, u dakorduam që kjo seancë të shtyhet për një ditë tjetër. Ashtu siç e patë, mbetëm pa u kuorum në kuvend, disa anëtarë të kuvendit e liruan sallën, të cilët patën mospajtueshmëri, domethënë për shkak të mungesës së kryetarit, nënkryetarit dhe një pjese të madhe të drejtorëve, ata nuk ishin dakord që të vazhdojnë me punimet e kësaj seance. Për kohën dhe datën e mbajtjes së kësaj mbledhje, e cila do të mbahet shumë shpejt në një ditë tjetër, do t'ju informojmë me kohë. Ju faleminderit!

VAZHDIMI I MBLEDHJES – 04 QERSHOR 2024

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Shumë të nderuar kolegë kuvendarë, i nderuari ekzekutiv, i nderuari nënkryetar, të nderuara media, të gjithë ju të pranishëm, përshëndetje për të gjithë. Ashtu siç jeni njoftuar me kohë, sot kemi thirrur vazhdimin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës së datës 30.5.2024. Prezent jemi 25 anëtarë të Kuvendit dhe për rend dite kemi këto pika.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve: 28 mars 2024 (rregullt); 23 prill 2024 (jashtëzakonshme); 30 prill e vazhduar më 03 maj 2024 (rregullt) ;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 001/011-53593 të datës 23 prill 2024;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr.01/011-3250 dt.08.03.2012 për përdorimin e gjuhëve në komunën e Prizrenit;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për shërbime komunale në Komunën e Prizrenit;
7. Miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimeve (sipas rekomandimeve të MMPHI-së);
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit të punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës (2024-2026);
9. Informatë rreth raportit të punës së zyrës-njësisë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, për vitin 2023.

Pika parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve

Antigona Bytyqi (Kryesuese): A dëshiron dikush me e marrë fjalën në lidhje me këtë pikë? Në qoftë se jo, vetëm t'i presim kolegët le t'i zënë vendet e tyre. Atëherë po e hedhim në votim. Prezent jemi 29 anëtarë të Kuvendit. Kush është për që të miratohen këto procesverbale? Ju lutem dorën ta mbani edhe pak. 26 për. Kundër a ka? 0 kundër. Domethënë tre janë të pa deklaruar. Ju faleminderit të gjithëve.

Pika e Dytë

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës

Antigona Bytyqi (Kryesuese): A ka dikush diçka me shtu rreth rendit të ditës? Po, Ilir Gashi fjalën.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit zonja kryesuese, përshëndetje për ekzekutivin dhe kolegët kuvendarë dhe të pranishmit të tjerë. Me qëllim të përkrahjes së bizneseve të dëmtuara materialisht për shkak të punimeve të stërgjatura në qendrën historike të Prizrenit, grupi i kuvendarëve të Lëvizjes Vetëvendosje propozon që në rend të ditës të futet edhe një pikë në lidhje me subvencionimin dhe kompenzimin e dëmit për bizneset të shkaktuara si pasojë e punimeve në qendrën historike. Ne, grupi i kuvendarëve të Lëvizjes Vetëvendosje, propozojmë që pika e rendit të ditës për subvencionimin e bizneseve që veprojnë brenda qendrës historike, të përfshijë në vete faljen e borxhit të taksave komunale për shfrytëzimin e hapësirës publike për gjashtë muajt e kaluar, si dhe lirimin nga këto taksa për gjashtë muajt e ardhshëm, lirimin nga pagesa e qirasë nga muaji mars deri në muajin dhjetor për bizneset që shfrytëzojnë me qira lokalet komunale në qendrën historike të Prizrenit dhe kompenzimin e një pjese të humbjes së bizneseve duke llogaritur diferencën në mes të hyrave të deklaruara në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar me të hyrat e deklaruara gjatë muajve sa po zhvillohen punimet në qendrën historike të Prizrenit. Grupi i kuvendarëve të Lëvizjes Vetëvendosje fton të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës së Prizrenit, ta përkrahin futjen e kësaj pike në rend të ditës dhe ta miratojmë të njëjtën me qëllim që t'i dilet krah bizneseve të dëmtuara nga punimet në qendrën historike të Prizrenit. Faleminderit për dëgjim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Gashi, dikush tjetër? Atëherë në qoftë se nuk ka dhe dikush tjetër, propozimin e Ilir Gashit po e hedhim në votim që edhe kjo pikë t'i shtohet sot rendit të ditës. Kush është për prezent jemi 30? 26 jemi për. Kundër? 0 kundër. Abstenim a kemi? 2 abstenim. Atëherë, bashkë me propozimin e ri po e hedhim në votim rendin e ditës në tërësi. Kush është për që të miratohet ky rend i ditës? Prezent jemi 30. Ju lutem ta mbani dorën edhe pak. Unanimisht. Ju faleminderit shumë.

Pika e Tretë

Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Kush e dëshiron fjalën me e marrë? Po Florenti fjalën. Pastaj Bajrami edhe Ymrajna.

Florent Ukaj (LDK): Faleminderit e nderuar kryesuese, të nderuar të pranishëm, të nderuar qytetarë. Sot para jush dua të ngris çështjen mjaft të rëndësishme që lidhet me bujqit. Po bëhen gati një vit nga dëmet e shkaktuara në bujqësi, por nga drejtorja e bujqësisë dhe pse i ka vlerësuar dëmet nuk ua lëshojnë mjetet financiare bujqve. Është jo normale që bujqit të presin me muaj për diçka që ju takon. Mendoj që bujqit nuk e meritojnë injorancën nga ana juaj sepse edhe pse përballen me shumë vështirësi nuk po i lënë tokat në tjerë. Andaj pyetja ime për ju është: kur do ti marrin mjetet financiare që ju takojnë dhe që i meritojnë? Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Florent. Fjalën e ka Bajram Kastrati, përgatitet Ymran Fusha.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit kryesuese, përshëndetje ekzekutiv, kolegë kuvendarë, qytetarët e Prizrenit. Pyetje për drejtorin e shërbimeve publike. Kemi disa operatorë që kanë ankesa për mospagesë të rregullt, punimet që kanë zhvilluar nuk ju është bërë pagesa sipas tyre. A ka arsye në lidhje me këtë çështje, pasi që shumë punime po ngecin në gjysmë? Gjithashtu kam edhe një çështje që është në interes të diskutohet. Kemi pasur shumë kërkesa dhe ankesa në lidhje me kabllot e shumta në shtyllat elektrike, në qytet dhe fshatra që rrezikojnë vazhdimisht qytetarët. Siç po shihet, asnjë interesim nga ana e Kedsit, a do të ndërmerrni masa që ky institucion të jetë më i përgjegjshëm, apo do vazhdojmë të mbesim nën mëshirën e tyre deri në pafundësi. Një pyetje për drejtorin e Shëndetësisë. QMF-ja në Arban ka nevojë dhe kërkesë për një stomatolog dhe dy mjekë shtesë, pasi që numri i pacientëve është në rritje, ndërsa stafi mjekësor është i vogël për t'i dalë në shërbim. Gjithashtu ambollanta në Arban ka nevojë për intervenime në nyjet sanitare, nxemje dhe intervenime të tjera. Edhe pse ndërtimi i saj është bërë në një kohë jo shumë të largët, por fatkeqësisht ndërtimi i saj lënë për t'u dëshiruar. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Kastrati. Fjalën e ka Ymran Fusha, përgatitet Qemal Krasniqi.

Ymran Fusha (PDK): Përshëndetje për të gjithë. Drejtorit të shërbimeve publike, drejtor kam tre kërkesa. Mbasiqë jemi në prag të festave, dita e lidhjes së Prizrenit, 25 vjetori i çlirimit të Prizrenit, festa e Kurban Bajramit, festivalet e ndryshme, pritja e bashkëatdhetarëve, po propozoj dhe po kërkoj nga ju që të zbukurohet Prizreni. Drejtor në zonën industriale të lehtë në rrugën operacioni Shigjeta, mungon infrastruktura, sepse aty janë bizneset që kanë vështirësi të qarkullojnë me makina për shkak të gropave, besoj që do të merrni parasysh kërkesën. Kërkesa e tretë është për ndriçim publik në rrugën Adem Jashari, në rrugën e Bushatit në Dardani dhe rruga mbretëresha Teut. Në drejtoritë të urbanizmit dhe komisionit për emërimin e rrugëve. Përmes kësaj kërkesë dokoresha Shkëndija Hoda-Uka paraqet kërkesën për riemërimin e rrugës Vatra Shqiptare me emrin e babait të saj njëherë inxhinier Galip Hoda. Inxhinieri Galip Hoda si një ndër inxhinierët e parë të diplomuar të hidroteknikës në nivel të Republikës së Kosovës. Në kërkesë bashkangjes kërkesën e dokoreshës. Dhe e fundit është drejtoria e shëndetësisë. Drejtor, paraprakisht ju falenderoj për intervenimin urgjent në QMF-2 në Lakuriç për rregullimin e shkallëve ku ishin të rrezikuar qytetarët. Isha, isha në vizitë të urgjencës ku edhe falenderoj publikisht stafit të përkryer të urgjencës për gatishmërinë për me ofruar ndihmën e shpejtë në rastet urgjente shëndetësore. Por gjatë bisedës erdhëm në përfundim që numri i ekipeve shëndetësore nuk është i mjaftueshëm për shkak se është numri i madh i rasteve. Sipas statistikave të vitit 2023, ekipet kanë ofruar 40.000 shërbime. Kërkesa ime është që të shtohen ekipet mjekësore të intervenimit të urgjencës. Dhe kërkesa e dytë përfshin edhe drejtoreshën e arsimit. Drejtoreshë dhe drejtor, kam një kërkesë nga ju për një bashkëpunim. Stafi urgjencës ka shprehur gatishmërinë në mënyrë vullnetare të trajnojnë nga dy arsimtarë në çdo ndërrim të shkollave për dhënien e ndihmës së parë. Arsyeja është se në rastet kur ka ndonjë urgjencë shëndetësore në mes të nxënësve ose stafit, personat e trajnuar të japin ndihmën e parë derisa të mbërrinë urgjencën në vendin e ngjarjes. Po ashtu kjo mund të zbatohet edhe tek bizneset që të dërgojnë stafin e tyre në trajnim, duke filluar edhe nga ata të ofrojnë stafin e vet për trajnim. Kërkesa e tretë përfshin orarin e barnatoreve kujdestar në komunën

e Prizrenit. Drejtor, nëse ka mundësi të rregullohet orari i kujdestarisë së barnatoreve është kërkesa e pacientëve, sepse në afërsi të QKMF-së nuk ka barnatore kujdestar dhe pacientët detyrohen të shkojnë në mes të natës për të kërkuar barnatore të hapur. Kërkesa është që të jetë një barnatore kujdestar e hapur afër çdo institucioni shëndetësor kujdestar gjatë natës.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Fusha. Fjalën e ka Qemal Krasniqi, përgatitet Haziz Hodaj.

Qemal Krasniqi (LDK): Përshëndetje kryesuese. Më vjen mirë që sot janë të pranishëm drejtorët këtu. Gjithashtu edhe këta i përshëndes. Kam dy- tre çështje që do t'i ngrisi këtu. E para ka të bëjë rreth drejtorisë së bujqësisë. Gjatë javëve të fundit jemi dëshmitarë të gjithë nga moti i ligë ka patur shumë të rreshura, breshër dhe si pasojë dëmet janë evidente. Para luftës së Kosovës, ka pasur stacione meteorologjike për evidentimin e reve re-breshër sjellës. Sipas të dhënave në territorin e Kosovës, para vitit 99 ka qenë funksionale diku rreth 110 pika lansuese të raketave speciale, të cilat kanë shpartalluar retë dhe kanë parandaluar breshërin. Ky sistem ka funksionuar me anë të një radari që tash në Kosovë është jashtë funksioni. Edhe në regjionin tonë, pra të Prizrenit, ishin diku shtatë, tetë sosh, pra stacionet e sistemit mbrojtës kundër breshërit, ato tani janë jashtë funksionit dhe askush nuk merret me këtë çështje, e cila është në një rëndësi të madhe. Pra stuitë e fuqishme po shkaktojnë dëme të mëdha bujqësore. E di që kjo çështje nuk është kompetencë e drejtorisë së bujqësisë, por nga drejtoria e bujqësisë po kërkoj që në bashkëpunim me ministrin e bujqësisë dhe ministrat përkatës, të mirren me këtë çështje që sa më parë të vendosen masat mbrojtëse kundër breshërit, sepse është shumë me rëndësi për popullatën e në veçanti për fermerët. Çështje tjetër ka të bëjë me drejtorinë për punë dhe mirëqenie sociale. Drejtor, unë edhe në mandatet e kaluara, si anëtar i Kuvendit e kam ngritur një çështje që ka të bëjë me disa banesa që ato banesa sot e atë ditë janë të uzurpuara. Disa nga ato janë të uzurpuara dhe nuk dihet se kush jeton në to. Ato banesa kanë statusin tash do të thotë janë pronë të Kuvendit komunal, por shfrytëzohen nga dikush tjetër. Ju pyes, a jeni marrë ju si drejtor me këtë çështje dhe a dini gjë rreth këtyre banesave? Kaq kisha, faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Krasniqi. Fjalën e ka Haziz Hodaj, përgatitet Levent Bush.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit shumë kryesuese. Kjo çështja e Shadervanit është bërë temë e diskutimit në qytetin e Prizrenit tash. Edhe sinqerisht nuk e di kujt i bjen përgjegjësia, në çfarë niveli është, ka arritur realizimi i atij projekti, po me të vërtetë në kohën kur qyteti frekuentohet dhe vizitohet më së shumti, ajo tani me qenë në atë gjendje është mjerim. Doli sot një pikë shumë shumë, një kërkesë interesante për me i kompenzu bizneset që janë në Shadervan edhe kanë pengesa për shkak të mosrealizimit të projektit. Kjo është precedent i rëndë mandej, se ne nuk e dimë sa ka më së gjatë realizimi i këtij projekti, por neglizhenca të tilla kemi parë anë e mbanë të qytetit vazhdimisht. Dhe mandej do të detyrohemi veç nëpër mbledhje me ju fal bizneseve taksat, tatime për shkak të neglizhencës së punimeve në qendër të qytetit. Një pyetje tjetër e kam për një lagje Gurisht, atje çfarë është ajo te ai trafo stadioni ku bëhet shpërndarja e rrymës. Më ka rastësish me qenë me një rast vdekje se kemi një mik atje, ka vdekur një mikesh edhe sinqerisht e ndisha shumë veten keq si anëtar i kuvendit, megjithëse i një partie opozitare dhe i pamundshëm me bë asgjë në atë drejtim, po e ndisha veten keq kur u drejtonin, a jemi edhe ne pjesë e këtij qyteti. Ata në kohën e dimrit janë në mes të baltës, e në kohën e verës janë në pluhur vazhdimisht. Unë e

di që ka pasur probleme aty me pronat, unë e di që ka pasur probleme aty vazhdimisht, mirëpo një intervenim qoftë edhe i përkohshëm do të duhej urgjentisht të ndërmerren në atë lagje. Ata janë nën mëshirën e Zotit. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zoti Hodaj. Fjalën e ka Levent Bush, përgatitet Bujar Hasani.

Levent Bus (KDTP): 16:40 – 19:45 minuta.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zoti Bush. Fjalën e ka Bujar Hasani, përgatitet Shukri Quni.

Bujar Hasani (i Pavarur): Faleminderit kryesuese. Unë në fillim do të kërkoj një mirëkuptim sepse ndoshta pak do ta zgjas pak më shumë, por megjithatë do të mundohem me i përfshirë të gjitha ato unë që do t'i shtroj sot pyetje. Së pari për juve kryesuese kam një pyetje. A ke mundësi me na treguar dallimin mes ndërmarrjes publike ekoregjioni edhe ndërmarrjes publike stacioni i autobuseve, për arsye se komisioni i aksionarëve, ndërmarrjes publike ekoregjioni nuk paguhet fare, ndërsa komisioni i ndërmarrjes publike, stacioni i autobuseve është paguar në bazë të raportit që na kanë pru, që e kemi pasur edhe në seancat e kaluar, me vlera të cilat unë i kam me evidentuar edhe janë këtu diku: për muajin e parë kanë marrë 2873 euro, tre anëtarë, që i bie 957 euro të paktën ashtu si i kanë dhënë. Muajin e dytë njëjtë. Muajin e tretë kanë marrë 1436 euro, tre anëtarë, 478 euro pagë mujore edhe kështu. Me ligjin për ndërmarrjet publike është e përcaktuar kjo, shumë të qartë si funksionon këto ndërmarrje publike. Aty nuk parashihet pagesa e komisionit të aksionarëve. Kam vendimin e qeverisë, i cili vendim e bën kategorizimin e ndërmarrjeve publike, në ndërmarrjet publike qëndrore, regionale edhe lokale. Në bazë të këtij kategorizimi, vendimi i qeverisë bën edhe mënyrën e kompenzimit të anëtarëve të bordit, jo anëtarëve të komisionit. Kategoria e parë, kryesuesi është 800 euro, anëtarë 600 euro. Kategoria e dytë, kryesuesi është 650 euro, anëtarët janë 460 euro. Kategoria e tretë, kryesuesi është 450 euro, anëtarët janë 320 euro. Si dhe kategoria, domethënë për anëtarët e komisionit të auditorit. Andaj unë shfrytëzoj rastin që të drejtohem edhe organeve të drejtësisë, të cilat mirren, duhet të mirren me këtë çështje, sepse sipas mendimit tim, është bërë një keqpërdorim i detyrës zyrtare nga ana e komisionit të aksionarëve që është caktuar nga ky kuvend. Kur është marrë vendimi për themelimin e kësaj ndërmarrje, shumë mirë thuhet aty se si funksionon ndërmarrja publike. Neni dy i përcakton detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij komisioni. Janë të përcaktuara me ligjin për ndërmarrjet 03/L-087 për ndërmarrjet publike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, numër 3/2008. Dhe vendimi ekziston. Andaj unë kërkoj një përgjigje nga ana juaj, si dhe nga organet e drejtësisë të cilat duhet të merren me këtë çështje, sepse sipas mendimit tim, këtu ka keqpërdorim të pozitës zyrtare. Pyetja tjetër është për drejtorin e shërbimeve publike. Drejtor, te posta këtu, vendi ku është e përcaktuar për autobus lokal. Aty tani nga erdha, bëra një fotografi, aty thotë, treni turistik. Ky vend a është për këtë tren turistik apo është për stacion të autobusëve lokal? Nën një. Nën dy. Nëse ke mundësi me na dhënë një përgjigje në bazë të cilit ligj, të cilit nen, funksionon ky tren, sepse në kohën e Mytaher Haskukës, ky tren nuk ka funksionuar. Domethënë me na dhënë përgjigje në bazë të cilit ligj, cilit nen funksionon ky tren. Dhe pyetjen që ta kam bërë për seancën e kaluar për kanalizimin në fshatin tim Randobravë, si dhe prockën të cilën është një kërkesë pothuaj që sa kohë. Kërkoj këto përgjigje, si dhe përgjigje nga ana e drejtorit të inspektorateve që kam bërë që dy, tre seanse

apo s'di, nuk di, nuk më ka dhënë përgjigje për objektet në ... të cilët unë i kam ngritur në këtë seancë edhe nuk kam marrë asnjë përgjigje me shkrim as me gojë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Hasani. Fjalën e ka Shukri Quni, përgatitet Shqipe Shatri.

Shukri Quni (Nisma): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje për të gjithë. Kam një çështje me ngritë, është fjala për Drejtorinë e Bujqësisë. Kam bërë kërkesë drejtor për shtrimin e një rrugë apo ndoshta del edhe ndonjë tjetër me zhavorr, është fjala për rrugët fushore. Pastaj e kam një kërkesë për pastrimin e vijave, është fjala për ujitjen e tokës, kullimin ta quaj kështu. Ndërsa Drejtoreshës së Arsimit kam ngritur një çështje edhe më herët dhe nuk kam marrë përgjigje, është fjala për pronën komunale që është ngjitur me shkollën e mesme në gjimnazin Remzi Ademaj. Domethënë kërkoj përgjigje nga kjo, si qëndron çështja e asaj prone, i kam cekur herat e kaluara, s'ka nevojë tash me përsërit prapë. Drejtoria e Turizmit, për punimet që kanë ngecur tek gurrat, që i quajmë ne gurrat e Suzisë në fshatin Nashec, pse nuk punohet? Edhe a mbikëqyren këto punime? Këto veç, e di që është ky projekt dy vjeçar, por një vjet veç kaloj. Kontratën e punës e kam. Dhe po dua me ditë sa herë që marrin mjete ata është mirë me ditë edhe ne si kuvendar për shembull se çfarë punë po kryeni dhe sa mjete po ja lëshoni. Se ka ankesa prej punëmarrësve që komuna nuk po lëshon pare, sidomos te Drejtoria e Shërbimeve Publike, drejtori tha, m'i ke bërë pyetjet tha, m'i ke dërguar tha, po drejtor kjo është kërkesë e tyre se i kam premtuar atij punëmarrësit që ka me e ngritë këtë çështje nëse komuna nuk ju bënë pagesë juve. Se neve ashtu ashtu po na shkojnë nga 7 milionë a 8 milionë suficit, e kështu është mirë që ato mos me na shku ato suficit, por me i pagu firmat që me i rregulluar ato punime. Pastaj Drejtoria e Shërbimeve Publike, se di tash ti kam shkruar këto pyetje, po nuk kam qare pa ta cek prapë rregullimin e grupave sepse ndoshta dhe Dafina Alishani ndoshta ta thotë, se shumë herë po me i përsërit kërkesat e mia. Pastaj ndriçimi, se e di që u bërë bajat kjo rruga po unë po vij aty pari, ju nuk po vini, ato gropat që i kanë pre ato asfaltet, e duhet me u rregullu. Edhe ndriçimi publik, drejtor i shërbimeve publike, në Nashec nuk është i kryer! Plus ka dhe prishje edhe nuk vijnë me i rregullu fare. E për çështjen e pagesave e ngriti edhe kolegu këtu Bajram Kastrati. Mirë është me na dhënë një përgjigje nëse është e vërtetë që nuk marrin do të thotë mjete ato firma që në fakt punëmarrësi se punëkryes ende s'mund me i quaj ata, vetëm si punëmarrës i kanë marrë punimet pa i kry punimet ende. Të tjerat i ki aty, tash ndoshta i kryen! Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Fjalën e ka Shqipe Shatri, përgatitet Tajar Susuri.

Shqipe Shatri (LVV): Faleminderit kryesuese. Sot në këtë kuvend do të parashtroj tri kërkesa, drejtuar drejtorisë së arsimit fillimisht. E nderuara drejtoreshë zonja Veselaj Gutaj, nëse mund të na sqaroni ku qëndron problemi i moskompensimit të mësimdhënësve të cilët pothuajse gjatë gjithë vitit shkollor janë duke mbajtur orë shtesë, pra honorare. Z. Çele Lamaj, kërkoj nga drejtoria juaj që të fillojnë aksionin për kositjen e barit dhe pastrimin e anësorëve të rrugëve edhe në fshatrat e Hasit. Gjithashtu për drejtorinë e inspektoriatit, i nderuar zotëri Ukimeri, është koha e fundit që inspektorët komunalë edhe pse në numër ndoshta të kufizuar të kapaciteteve të tyre, të dalin në terren, sidomos në fshatra për të ushtruar kontroll në pikat e shitjes siç janë marketet, furrat e bukës e të tjera, me theks të veçantë në kontrollimin e afateve të produkteve të konsumit, sepse jo rrallëherë po kemi ankesa të konsumatorëve duke u ballafaquar me afatet e skaduara ose produkte të cilat nuk ruhen si duhet. Sidomos tani kur jemi në stinën e verës dhe produktet ushqimore mund

të prishen. Gjithashtu në fokus të inspektimit në aspektin e çmimeve ti kushton një rëndësi, ngase po ka diferenca nga një pikë e shitjes në pikën tjetër për produktin e njëjtë. Këto devijime, për të mos thënë abuzime, janë shumë të theksuara më shumë në fshatra. Prandaj kërkoj nga drejtoria juaj i nderuar drejtor, që të ushtroni kontrollin dhe të parandaloni këto devijime, sepse pos që e kurseni buxhetin e qytetarëve, e mbron edhe shëndetin e tyre. Ju faleminderit për vëmendje dhe mirëkuptim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Shatri. Fjalën e ka Tajar Susuri, përgatitet Karanfil Haxhillari.

Tajar Susuri (LVV): Faleminderit kryesuese. Përhëndetje për të gjithë. Pyetje për drejtorin e shërbimeve publike. Drejtor, një pyetje konkrete, si shpjegohet fakti se rruga të cilën e keni asfaltuar në fshatin Vlashnje në gjatësi prej 1100 m. Gjysma e rrugës në hyrje të fshatit nga rruga kryesore deri në kryqëzimin e rrugëve në fshat, më saktësisht deri tek ambulanta e fshatit me një gjatësi prej 500 m, fare nuk ka infrastrukturë nëntokësore, pra pa kanalizim. Dhe në këtë hapësirë shtrihen mbi 100 parcela, të cilat detyrohen që në një kohë tjetër ta dëmtojnë ose ta presin asfaltin e shtruar, për ta bërë kanalizimin funksional. Gjithashtu nuk ka asnjë ujëmbledhës për ujërat atmosferikë. Ndërsa një pjesë tjetër, pjesa tjetër nga ambulanta e fshatit deri në dalje nga fshati Kobaj me gjatësi nga 500 m, ka kanalizim të vjetër, por ka vetëm tre ujëmbledhësa për largimin e ujërave atmosferikë. Pyetja është kjo. Kjo rrugë, ky investim, a është sipas standardeve apo vetëm edhe një punë e keqe e juaja si drejtor? Si shpjegoni, si shpjegoheni të asfaltoni rrugën pa infrastrukturë nëntokësore dhe vetëm me tre puseta me gjatësi prej 1100 m. Ku do të derdhen ujërat atmosferikë, sigurisht rruga dhe parcelat për skaj saj do të vërshohen. Gjithashtu në këtë foltore, në pyetjen e një kuvendari, patë deklaruar se punimet përkatësisht vazhdimin e shtruarjes së asfaltit do të vazhdojnë deri në fshatin Kobaj. Pra diku edhe 500-600 metra të tjera. Pasi që veç aty ndodhet makineria, kjo nuk po ndodh dhe makineria është tërhequr. A është ky edhe një tjetër fjalë e juaja pa mbulesë? Sepse po më vjen keq me të thënë drejtor, një tjetër mashttrim publik i radhës. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, fjalën e ka Karanfil Haxhillari, përgatitet Egzona Hoxhaj.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesuese, të nderuar kolegë kuvendarë, ekzekutiv. Unë e kam një çështje tejet me rëndësi për të ngritur, është fjala për farmakosin e vjetër. Siç e pamë, farmakosi i vjetër, një fabrikë e prodhimit të bardhave, të cilët para lufte punonin në tri ndërrime, tashmë është rrafsh me tokë. Në qoftë se ja shtojmë faktin edhe që në shkurt të vitit 2024, sipas IKMM-së, ky ishte edhe aset me statut të mbrojtjes së përhershme. Pyetja është dhe nuk besoni që nuk e di as kujt t'ia drejtojë. Me çfarë leje është bërë rrënimi i atij objekti? Qytetarët e asaj lagje nuk e kanë haberin se çfarë do të ndodhë aty. Nuk ka ndonjë paralajmërim, nuk ka ndonjë shpjegim për asnjë qytetar se çfarë definitivisht do të ndodhë në atë pjesë të qytetit. Shtoja faktin që farmakosi i vjetër është në vijë me zonën historike të qytetit të Prizrenit. Pyetja tjetër shkon për drejtorin e inspektoriateve. Bazuar në hulumtimin që e ka bërë betimi për drejtësi, shohim që villat në Prizren, ngriten pasi janë pajisur me leje për ndërtim shtallash kuajsh apo ferma kuajsh, dhe sot në Landovicë dhe në Korishë kemi prej shtallave të kuajve, kemi villa të cilët të gjithë e dimë për çfarë shërbejnë. Nga ky, gjithmonë po bazohem nga ky hulumtim se a do të ndërmerret diçka që t'i ndalojmë sepse është mbushur gjithandej Prizreni me villa? Dhe a do të

mirret nga ana e inspektorateve sepse në këtë emision apo në këtë hulumtim shumë çka kemi parë. Tepër shumë kemi parë se si funksionojnë dhe si janë të ndërlidhura nëpunësit tuaj dhe akterët e ndryshëm të cilët i bëjnë këto gjëra. Dhe në fund e kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike. Rruga prej stanave të Struzhës deri në qafa e Kushninit, ku kanë mbërri punimet. Komuniteti Struzhjan është shumë i interesuar për këtë rrugë. Ky projekt është që po bëhen tre vite e gjysëm dhe ku janë punimet dhe kur parashihet që të përfundojnë këto punime. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëria Haxhillari. Fjalën e ka Egzona Hoxhaj, përgatitet Petrit Hoxhaj.

Egzona Hoxhaj (PDK): Faleminderit kryesuese, i nderuar nënkryetar, të nderuar ekzekutiv, të nderuar kolegë kuvendarë, media, shoqëri civile, të nderuar qytetarë të komunës së Prizrenit. Unë kam një kërkesë shumë shkurt për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Drejtor është kërkesë e banorëve të fshatit Tupec, që të vendosen dy stacione të autobusëve në të dy krahët në fshatin Tupec, konkretisht afër përmendorës së dëshmorit Reshat Çoçaj. Kjo për shkak që fëmijët e fshatit Tupec, çdo ditë udhëtojnë për me shkuar në shkollë në fshatin Gjonaj. Të njëjtën kohë edhe banorët janë gjithmonë prezent dhe përpër shkak të rrezikshmërisë që është shumë afër rrugës kryesore që i lidh të gjitha fshatrat e Hasit, është e nevojshme që ata t'i kenë dy stacione të autobusëve, plus përderisa dhe kemi hapësirë të mjaftueshme, sepse e kemi diskutuar shumë herë që ndoshta vendosja e stacioneve të autobusëve është shumë e rëndësishme që të bëhet në të gjitha fshatrat, po aty ku po na mungon hapësira publike, është e mirëkuptueshme që s'kemi mundësi me intervenu. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Hoxhaj. Fjalën e ka Petrit Hoxhaj, përgatitet Islam Thaçi.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese. Përhëndetje për të gjithë. Kam kërkesa për drejtorinë e bujqësisë dhe drejtorinë e turizmit. Por po ia nisi për drejtorinë e turizmit. Pse janë ndërprerë punimet në gurrën e fshatit Poslisht, ku është problemi dhe gjendja jo e mirë e ndërprerjes, saqë edhe para dy- tre dite reagoja mënyrën se si janë lënë muret në këto që mund të ndodhë ndonjë fatkeqësi dhe kërkoj që të rregullohet kjo dhe të sanohen këto parregullsi. Tjetra ka të bëjë, tek muzeu i Landovicës, kush i ka çelësat e këtij muzeu? Pse ky muzeu është mbyllur, do të thotë, dhe me mbylljen e këtij muzeu po e mbyllim një histori të UÇK-së. Kërkoj që të hapet sa më shpejt dhe të jetë në guidat turistike të agjencive turistike dhe në këtë mënyrë të promovohet ky muze. Unë e di që në vitet e kaluar është investuar dhe me të vërtetë është një muze që është gjynah për me qenë mbyllur. Tjetra ka të bëjë, kam bërë një kërkesë për fshatin Muradem, një rrugë malore dhe e di që drejtorja ka një kod buxhetor dhe nuk më është kthyer asnjë përgjigje për këtë kërkesë. Kërkoj që në këtë mënyrë të promovohet dhe të rregullohet rruga që përfshinë grykën e Lumëbardhit dhe është mirë që kjo rrugë të shtrohet. Ndërsa kërkesa tjetër për drejtorinë e bujqësisë ka të bëjë shqetësimi i banorëve të fshatit Zhur, lidhur me disa arusha të cilat kanë filluar të hyjnë nëpër oborret e shtëpisë. Është mirë që të merret masa në këtë drejtim. Është mirë që të merret masa në këtë drejtim dhe të ju hiqë shqetësimi këtyre banorëve. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Hoxhaj. Fjalën e ka Islam Thaçi, përgatitet Ilir Gashi.

Islam Thaçi (LVV): Faleminderit kryesuese. Pyetja ime e parë është i dedikohet dy drejtorive, drejtorisë së inspektorat dhe drejtorisë së shërbimeve publike. Të nderuar drejtorë, hiç më pak se javën e kaluar ishim dëshmitarë se në sheshin Shadërvan një qytetar është lënduar i cili kishte rënë me një gropë të hapur nga një qytetar tjetër apo nga një nga një biznes aty, po pastaj e mora vesh që hapja e asaj gropës ishte bërë pa leje përkatëse nga drejtoria e shërbimeve publike, për t'u qasur apo për ta bërë lidhjen në instalimet e fundit që janë bërë. Unë e di drejtor Ukaj që drejtoria e inspektorateve nuk është përgjegjëse në mënyrë direkte sa i përket ligjit për sigurinë në vendpunishte. Mirëpo është shqetësuese ngase rasti ka ndodhur në qendër të Prizrenit dhe tani me sa di keni filluar me kujdestari në këtë drejtori edhe mos të vërehet kjo. Edhe më shqetësuese është se si vitin e kaluar po del që mbi 50% të projekteve në një drejtori të caktuar, inspektorët nuk i kanë inspektuar edhe po del që me reagimin e opozitës vërehet që ato objekte kanë qenë pa leje përkatëse. Do të thotë inspektorët e kanë përgjegjësinë të inspektojnë pavarësisht a ka s'ka leje edhe kush është investitor. Do të thotë kanë përgjegjësi ligjore të inspektojnë edhe vendpunishtet ku bëhen edhe investimet nga komuna apo edhe nga institucione të tjera përkatëse. Pyetja e dytë është për drejtorinë e shëndetësisë dhe kryetarin e komunës. Bëhet fjalë për një vendim të cilin e ka lëshuar ushtruesi i detyrës, zëvendës drejtorit të QKMF-së, vendimi i nxjerrë më 19 prill 2024, me numër protokoli 11/41, duke u bazuar në ligjin e punës 03/L-212 bazuar në nenin 17.2. E që tërësisht është në kundërshtim me ligjin 08/L-197, respektivisht me nenin 86.1 dhe dy duke u bazuar në nenët 63, 64, 65, 66 të ligjit për zyrtarët publikë. Bëhet fjalë për transferimin e punëtorit higjienik Pranver Asllani nga fshati Zhurë. Nga QMF-1 në AMF Lubizhd e Hasit dhe AMF Kushnin Has. E që është më qesharake se në këtë vendim në arsyetimin e tij nuk jepet mbështetja se si i punësuar do duhej të arrijë një qëllim të caktuar për interes të institucionit. Madje nuk ka as afate të përcaktuara ashtu siç e parashih ligji. Ndërsa e vërteta është se nga insinuatat e punësuar në një QMF ku ka qenë i punësuar personi në fjalë, ka ndodhur një hakmarrje pa dëshmi përkatëse. Do të thotë, drejtor, si është e mundshme që kjo me ndodh? Meqënëse ky rast u bë edhe medial javëve të kaluara. Pavarësisht që kryetari i komunës nuk është në sallë të Kuvendit, dua me ngrit një çështje e që është shumë interesante. Kryetari me një akt vendim të datës 07 maj të vitit 2024 ka anuluar 152 akt vendime të tjera. Dua me i lënë mesazh kryetari të komunës, kujdes kryetar, se po të njëjtut që ishin në kohën e kryetarit Ramadan Muja e kanë çuar në përgjegjësi. Nga se ligji i procedurës së përgjithshme administrative parasheh se një vendim mund të shfuqizojë një vendim tjetër paraprak. Vetëm gjykatat e kanë fuqinë ligjore që me një vendim të shfuqizojnë disa vendime brenda një vendimi. Pyetja tjetër është për drejtorin e urbanizmit, është pyetje konkrete. Për drejtorinë e urbanizimit, mua më intereson, a është legalizuar objekti në lagjen Jeni Mahall, ku ka komuna e Prizrenit marrëveshje partneritetit publiko-privat, e që lidhet me çështjen që e kam ngritur disa herë, do të thotë me fatin e përfituesve të 14 banesave të familjeve të dëshmorëve. Do të thotë pyetja konkrete është, a është legalizuar ky objekt? Ju faleminderit. Kaq.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Thaçi. Fjalën e ka Ilir Gashi, përgatitët Shkëlzen Kastrati.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit zonja kryesuese. Kryetari Totaj po vazhdon me mungesa. Besoj të janë të paarsyeshme. E duhemi me ja ulur notën e sjelljes së fundvitit. Në mungesë të tij, unë pyetjen do t'ia drejtoj drejtorit të turizmit, ka të bëjë me lidhje me projektin e teleferikut. Në çfarë faze janë punimet rreth këtij projekti? A është kryer studimi i fizibilitetit dhe a do të merret parasysh mundësia e realizimit të projektit me partneritet publiko-privat? Sepse deri tash edhe nga

deklaratat e juaja edhe të kryetarit, projekti mundet me kushtu diku deri në 6 milionë euro, që janë shuma të konsiderueshme për buxhetin komunal. A është shqyrtuar pra mundësia që ky projekt të realizohet me partneritet publiko-privat. Një pyetje për drejtorin Qelë Lamaj. Zotëri Lamaj, ndriçimi publik para disa muajve keni premtuar se procesi i tenderimit do të përfundojë dhe më së vonë nga muaji i prill do të kemi operatorin ekonomik. Me sa po shihet ende asgjë nuk ka përfunduar sepse terri po mbisundon në shumë lagje të qytetit dhe fshatrave. Në çfarë faze është edhe kjo, ku është problemi? Edhe një pyetje për zotërin Lamaj. Rruga e Ulqinit, aty ku kryqëzohet me rrugën Edi Durham, është punuar para disa muajve, por tani nuk ka punime dhe rruga është pothuajse e pakalueshme. Kanë mbetur shumë kupza, shumë gropa, dhe një rrugë tjetër është menjëherë në anën e majtë të rrugës Ulqini, që bashkohet, një rrugicë që bashkohet me rrugën Besim Telaku, është e pashtuar, e parregulluar, e pa mirëmbajtje. Çka është problemi me këtë rrugë? A është pronë private, a ka konteste pronësore, pse nuk është e rregulluar? Faleminderit për dëgjim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zoti Gashi. Fjalën e ka Shkëlzen Kastrati.

Shkëlzen Kastrati (PDK): Faleminderit kryesuese, të nderuar ekzekutiv, kolegë kuvendarë, të gjithë të pranishëm. Unë pata një propozim për drejtorinë e urbanizmit. E dimë që disa prej kushteve janë kur lëshohet leja e ndërtimit, nëse është e mundur të vendoset edhe një kusht që të paktën sa banesa ndërtohen me pas edhe parkingje. Nja dy katë nën tokë, me shku do të thotë me krijuar vetë banesa, me krijuar parkingje të reja. Edhe vetë banorët le të pakohen aty, por edhe për komunitetin në përgjithësi. Është njëri prej kushteve që kanë hapësirë gjelbëruese edhe shfrytëzimi do të thotë ato edhe shfrytëzohet për gjelbërim edhe për parkim. Që nuk i plotëson kushtet dmth aty vetë ndërtesa me u parku qytetarët. Kështu që njëra prej kushteve nëse është e mundshme, nëse duhet me u votu edhe në asamble, po mendoj që jemi të gatshëm, mos me ju lëshu leja e ndërtimit pa krijuar dhe minimum nja 50 apo 100 parkingje vetë ndërtesa. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Kastrati. Selman Sokolaj fjalën.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesuese. Pronën e AKP-së ku gjente stadiumi i Arbanës, janë zhvilluar shumë ndeshje në vitet 90 edhe shfrytëzohet nga klubi futbollistik Arbana. Më 26 janar të vitit 2023 e kemi shpallur si interes të përgjithshëm, interes publik edhe i kemi drejtuar AKP-së që ajo të mos privatizohet, të mos të hyjë në listën e privatizimit. Me 9 shkurt domethënë e ka marrë ligjshmërinë, ky vendim i Kuvendit komunal, mirëpo prej asaj dite nuk kemi informacione se çfarë ka ndodhur me këtë rast. Ndoshta kryetari i komunës po të ishte këtu, ose drejtori i kulturës, rinisë dhe sportit do të na jepte përgjigje, domethënë interesi edhe i klubit edhe i banorëve edhe për shkak të historisë që bartë ajo fushë është me dit që ku kanë shkuar procedurat e kësaj pune. Se kolegu Petrit Hoxhaj e ngriti edhe çështjen e gurrës Poslishtit është një projekt që është tu ndërtuar në Poslishtë. Atu përveç që ka ngecje në punime, ka edhe uzurpim në bazë të pretendimeve të banorëve aty, ka pretendime për uzurpim. Edhe për atë uzurpim është i njoftuar edhe drejtori i inspektorateve, që është prezent këtu edhe deri më tani nuk ka marrë asnjë masë. Unë po mendoj që çështja kryesore që ai projekt edhe shumë është e dëmshme kjo dhe kjo sjellje është e papranueshme, që ai projekt nuk po vazhdon tutje. Për shkak se ka dhe numër është i tenderuar është në rregull. Po vazhdojnë shumë punime në Prizren pa projekte, aty ka projekt nuk po vazhdoen punimet. Për shkak se aty ka uzurpu një eksponent i PDK-së. Në bazë të pretendimit të banorëve, këto janë të gjitha të faktuara edhe mundemi me i ngritur në detaje, mirëpo kjo është

veç si shqetësim që ju si ekzekutiv të merrreni me këtë çështje. Zoti Lamaj, nivelizimi diçka s'po ju punon, se kam plan me ju bë pyetje se s'po na merrni seriozisht për përgjigje, mos merr shënime, po shaktet s'po të punojnë nivelizimi, gjeje ndonjë trikë, zbuloje ndonjë trikë, bëje nivelizimin. Kryesuese, zoti Ukaj në seancën e fundit me u drejtu pak si me kërcënim, që i ka dy përgjigje, një me email edhe një përmes gjykatës. Unë po i pres të dyjat, ende asnjë s'e kam marrë, këtu jam. Edhe po i pres të dyjat, mos po të shtohen ty të tjerat. Për shkak se... kryesuese veç pak. Inspektori Enver në bazë, sigurisht duhet me qenë Enver Bytyqi. Inspektori Enver, i thotë qytetarit që ankohet: “ani de mos ka bërë ndonjë send të madhe që e paska qit një kiosk aty”. Kjo është mendësia e inspektorit, po kjo është mendësia e drejtorit. Nuk është punë e madhe, nuk po vazhdon projekte. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Dikush tjetër prej anëtarëve të Kuvendit? Po, Kujtesa Shatri edhe Dafina Alishani.

Kujtesa Shatri (LDK): Faleminderit kryesuese. Përhëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë dashta t'ja bëj një pyetje drejtorit të financave. E di që jemi bërë e tepërt me këtë pyetje, mirëpo unë e dashta me pyet edhe njëherë për mjetet për nënat lehona nuk i kanë dalë askujt. Kështu që kam shumë pyetje prej nënave, dua një përgjigje nga drejtori.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Shatri, Dafina Alishani fjalën.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit. Ne nuk jemi bërë të tepërt, po arroganca e këtij pushteti është bërë e tepërt. Ka muaj të tëra që e ngrisin çështjen e njëjtë edhe kjo është përbuzje edhe ndaj nënave, po edhe ndaj 13 asambleistëve që e kanë pasur të vetmen kërkesë si grup edhe nuk e keni marrë parasysh. Gjysma nuk është paguar zotëri nënkryetar, mos gënjeni në kuvend se na lodhet tu na gënjy. Vetëm pesë veta i kanë marrë ato paga, ato subvencione. Për të tjera, zotëri Sulltan, ju ka dy seanca që keni thënë muajin e ardhshëm, muajin e ardhshëm... Kush ka filluar? Diskriminim po bëni edhe në subvencionime. Është më se e vërtetë edhe prit. Është përbuzje më edhe për secilën kuvendare këtu edhe për secilën qytetare e cila ka bërë aplikimin. Dilni edhe tregoni bre thuani nuk kemi mundësi, i kemi bërë pazare dika tjetër, kemi dhënë subvencione më shumë se sa që duhet nëpër Ojq, i kemi premtuar më shumë se sa që duhet, edhe nënat lehona nuk janë prioritet për neve. Dilni, arsyetoheni kështu. Muajt e tërë na duhet këtu edhe vetëm buzëqeshni. A hiç s'ka peshë kërkesa e asambleistëve këtu a? Si grup joformal ju kemi bërë kërkesën. Bile shumicës ja keni mbushur mendjen me votu buxhetin për shkak kësaj pike. Edhe tash përbuzni jo gjysma, jo pak, jo s'di çka, është marre! Edhe jeni duke luajtur hajgare me gra. Me secilën grua që ka aplikuar jeni duke luajtur hajgare. Hiç nuk është për me qesh! Pyetjen e kam për drejtorin e bujqësisë, drejtor qysh është situata për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim të qytetit. A ka ndonjë plan? Edhe a mundeni me na informu kur përfundon kjo fazë? Drejtorja e administratës nuk është këtu, po me fillimin e sezonës verore dhe me numrin e madh të diasporës, mendoj që duhet të kemi një plan konkret edhe për shtimin e kapaciteteve në administratë, për shkak që e dimë që ka fluks të madh edhe me ja bërë lehtësimin e tyre në marrjen e shërbimeve. Drejtori i inspektoriateve, e kam ngritur si shqetësim, jeni kthyer me përgjigje, keni thënë nuk është e vërtetë. Parkingu pas shtëpisë së bardhë inkason para! Kontrolloni inspektorat, nxerrni nëpër terren, nuk po munden me i ndalë ndërtimet, bile këto pagesa le t'i ndalin. Edhe jam tepër kurioze me ditë se si ka mundësi në fshatin e juaj po bëhen ndërtimet edhe nuk po i shihni ju. A keni marrë ndonjë masë për këto inspektorë të cilët kanë dalë sipas hulumtimit të betimit në drejtësi edhe çka pason pas kësaj? Edhe pse u

intrigova nga kolegu nga Nasheci, nëse i ndreqni ato gropat të cilat i ka ngritur kolegu, unë e kam edhe pyetjen për drejtorinë e turizmit, është demolu komplet ajo pjesa për piknik që është bërë në mandatin e kaluar. A keni ndonjë buxhet ose ndonjë planifikim për rregullimin e kësaj? Nëse jo, a mundeni me kërkuar ndihmë prej DSHP-së, se DSHP-ja me e bë atë, sepse fundja qytetarët aty këtë sezon duhet me shfrytëzu dhe me një investim shumë të vogël mundeni me e rregulluar atë pjesë. Drejtoresha e arsimit, kam pranuar shumë ankesa prej nxënësve, gjoja është se Dafina Alishani nuk po lejon me shku nëpër ekskursionë. Zonjë, ligji nuk e lejon, jo Dafina! Nuk është, hiç korrekte me përdorë emrin tim karshi nxënësve, edhe këto pazare që po i bëni ju për ekskursionë me i gjuajt nxënësat tek unë. Me çfarë drejte ju përdorni emrin tim edhe thoni që Dafina nuk po ju lejon me shkuar në ekskursionë? Mbaj përgjegjësi edhe ju... Unë nuk kam, nuk kam.... unë vetëm një postim e kam edhe ju me atë postim e shfrytëzoni veç me denigru një asambleiste edhe me më sulmu lidhje pa lidhje. Mirruni me ligje dhe udhëzime administrative, merruni me shkolla, merruni me drejtorë të cilët shkelin ligjin, e mos u merrni me Dafinën. Drejtor, rruga tek Tea-ja. Disa herë e kam ngritur, prapë po dua me e ngrit. Ju në secilin prononcim këtu keni thënë që ne nuk dimë asgjë, ju dini, shyqyr që po dini. Na keni thënë që, aty është shtresa e parë, është shtruar dhe mos u ngutni se do të vijë shtresa e dytë. Tash po e shoh që një pjesë e asfaltit është gryer. Ku ka mbetur ajo pjesa e shtresa e parë, çfarë është arsyeja e gryerjes së atij asfalti? Edhe kush merr përgjegjësinë ose edhe që ajo shtresa e parë është shtruar gabim. A keni marrë ndonjë masë kundrejt operatorit ekonomik apo jo? Edhe sa i përket shenjëzimit të rrugëve, ne kemi shumë aksidente dhe shumë fatalitete besa. Ju mbajeni në mend për një rrugë në të cilën keni bërë zebra e nuk ka trotuare. Kur e keni në mend me bëzebra, me i bërë shenjëzimet në rrugë ku ka nevojë e jo nëpër rrugica. Keni thënë, atëherë kur kemi reaguar ka më shumë se një vit. Keni thënë që shumë shpejt do të fillojë edhe shenjëzimi i gjithë qytetit. E ki vështirë me i pa zebrat në qytet edhe besoj që kjo do të ishte shumë mirë me u bë sa më shpejt, për shkak që ka edhe fluks të madh edhe vizitorë të mëdhenjë. Edhe e fundit, a mundeni me dalë me një plan dinamik për Shadërvanin? Ne kemi vazhdimisht ankesa prej bizneseve edhe ankesa kryesore është që komuna nuk komunikon ose nuk i komunikon informatat lidhur me Shadërvanin. Domethënë ka pasur një pritje një muajsh, ku dikush thotë ministria po ja ndal, dikush thotë kedsi nuk po i kryen punimet, dikush thotë hidroregjioni. A mundeni me i mbajt të informuar qytetarët se jeni duke punuar në zemër të qytetit edhe besoj që secili qytetar po do me e ditë se çka po ndodh me Shadërvanin. Ju keni premtuar që punimet kanë me shkuar pjesë pjesë, pa i penguar as bizneset as qytetarët, por ne po e shohim një kaos në qytet. Sezona ka filluar edhe vazhdimisht ju po thoni që deri në fund të vitit mbarojnë punimet, kur e dimë që kontrata është tre vjeçare. A mundeni me na informu çka parashihet deri në fund të vitit me përfunduar, edhe arsyen e ndalesës së punimeve përgjatë një muaj e gjysmë që nuk ka pasur punime aty? Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Dafinë. Dikush tjetër prej anëtarëve të Kuvendit, në qoftë se nuk e kam parë se s'është lajmëruar? Në qoftë se nuk ka prej anëtarëve të Kuvendit, nënkryetari e ka fjalën.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Faleminderit kryesuese, të nderuar anëtarë të Kuvendit, kolegë nga ekzekutivi, drejtorë të drejtorive. Nuk kam me zgjat shumë edhe s'kam ndonjë përgjigje për pyetjet që janë bërë, se besoj drejtorët janë këtu. Veç dola me e demantu atë që e tha Dafina. Më vjen keq që e përdor fjalën gënjen. Në fakt kjo e ka të kundërtën, me atë “rr” që mua më vjen keq me përdor se e ruaj respektin për anëtarët e Kuvendit. Në muajin prill, përkatësisht maj, janë

paguar 666 nëna lehona. Ose në vlerë 200.000 euro. Domethënë raporti zyrtar i drejtorisë së financave, me të cilën edhe unë edhe drejtori, por edhe kryetari jemi marrë drejtpërdrejtë me vendos si prioritet për muajin maj, e prioritet do të jetë natyrisht edhe për muajin qershor, e besoj që në korrik përfundon si proces. Kështu që Dafina e ka pak stilin me manipulu edhe kur flet edhe me krijuar opinion negativ, po para qytetarëve duhet me qenë i sigurtë edhe korrekt. Mundësitë janë këto. Kush e di qysh funksionon buxheti i komunës edhe i organizatave buxhetore, duhet me dit edhe qysh bëhet shpërndarja e mjeteve. Subvencionet janë kategori e të hyrave vetanake. Nuk mundesh ti sa të kesh dëshirë me i mbledh dhe me i shpërnda ku do ti. Sepse ka strukturë, ka tavan edhe ka hapësira në të cilat drejtori shkojnë. Prandaj janë 13 drejtori, nja 7 ose 8 kanë subvencione edhe në bazë të proporcionit bëhet shpërndarja e mjeteve. Përkundër kësaj, në muajin maj ju është dhënë prioritet pagesës për nënat lehona. Edhe në qershor do të jetë i njëjti veprim edhe besoj që në korrik përfundon ky proces. Nuk është pse po don Dafina, po kjo është prioriteti i yni. Nëse dikush i ka lënë nënat lehona një vjet pa pagesë, është pikërisht ish-qeverisja që në vitin 2022 nuk ka parapa asnjë cent për këtë projekt. Kështu që përkundrazi s'është hiç me fol, mos manipulo!

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Drejtoresha e arsimit fjalën.

Luljeta Gutaj (DKA): Faleminderit kryesuese, i nderuar nënkryetar zoti Gashi, të nderuar kolegë drejtorë, asamble të nderuar qytetarë të komunës së Prizrenit, media dhe të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit për pyetjen të nderuar kuvendarë. E filloj me zotin Quni, prona lidhur me afërsinë e shkollës së gjimnazit Remzi Ademaj. Ne kemi, jemi marrë me këtë çështje, e kemi drejtuar kërkesën e drejtorinë e pronave, ka probleme pronësore rreth asaj çështje dhe po presim një epilog. Në momentin që kemi përgjigje do t'ja kthejmë, do t'ju njoftojmë edhe juve me përgjigjen zyrtare. Sa i përket kompenzimit të mësimdhënësve, e nderuar zonja Shatri, e kemi filluar vitin 2024 me 35 norma më pak se sa numri që ka qenë në komunën e Prizrenit për normat mësimore, të reduktuara nga Ministria e Arsimit në raport me numrin e nxënësve. Dhe ka qenë një sfidë e madhe jo për Prizrenin, por për të gjithë Kosovën, në raport me numrin e nxënësve dhe mësimdhënësve, duke ditur edhe hapjen e çerdheve të reja, pompozitetin e Ministrisë së Arsimit dhe në anën tjetër kemi reduktime. Ka qenë dashtë të angazhohmë mësimdhënësin në kohë të caktuar për hanore dhe pengesat kanë qenë te mbulesa, mirëpo pikërisht sot dokumentin të cilin presim që ta votoni ju si asamble, është bartja e mjeve në pjesën e arsimit dhe ajo do t'i mbulojë të gjitha ato pjesë ose borxhe të cilat i kemi te mësimdhënësit. Pyetjen tjetër, zonja Fusha, faleminderit për propozimin e një projekti të cilin e kemi shqyrtuar edhe në kuadër të zhvillimit të planit zhvillimor të arsimit në komunën e Prizrenit. Kemi paraparë diçka për ekipet emergjente, por është një propozim konkret dhe besoj që bashkë me drejtorin e shëndetësisë, një mundësi e mirë për mësimdhënësit që trajnohen për raste emergjente. Kurse zonja Alishani, për atë që e thatë që nxënësit, unë ju kam thënë nxënësve diçka ose të paktën vetëm një herë kam biseduar, është krejtësisht e pavërtetë, krejtësisht e pavërtetë! Të gjitha kritikët janë shumë të vlefshme për mua si drejtues e arsimit dhe në secilin pozicion që kam mbajtur. Mirëpo kur ato kanë argumente dhe kur ato fliten me fakte, u ndihmojnë për me bë punë më të mira. Ama jo kur jepni informata të pasakta kudo që thoni ju, unë nuk i lexoj fare statuset nëpër Facebook se nuk kam kohë, kam shumë punë. As nuk e lexoj asnjëherë statuset e tua, as nuk e di çfarë shkruan edhe çfarë flet. Unë merr me punën, me argumentin. Pasaktësia e informatave ose çfarëdo ngjyre, çfarëdo ngjyre që jepni, cilësdo çështje e ka një feedback. Kush të ka shkruar çfarë të ka shkruar, sigurisht që ju keni përgjigje dhe për ata dhe shkollat bëjnë përgjegjësi. Por sa për performancën e drejtorisë së arsimit, ndoshta e keni parë

grafikonin e ministrisë dhe e keni pa ku ka dalë. Nga vendi 25 është në vendin e 2 me 0.85 diferencë nga vendi i parë. Presim tash performancën për 2023-ën.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtoreshë. Drejtori i shërbimeve publike fjalën e ka, përgatitet drejtori i bujqësisë pastaj.

Çelë Lamaj (DSHP): Faleminderit kryesuese. Të nderuar kuvendarë, qytetarë të respektuar të komunës së Prizrenit. Faleminderit, faleminderit për shumë pyetje që i bëni edhe mua më jepni rastin që sot që s'pata mundësi me i përcjellë të gjitha punimet që i realizon drejtoria e shërbimeve publike në komune, e këtu po më jepni rastin e mirë e di që t'ju sqaroj edhe juve edhe qytetarëve se çka punohet. Pyetjes se Bajram Kastratit se pagesat për operatorët ekonomikë, ne e dimë shumë mirë që kontratat, shumë pak ka kontrata një vjeçare. Kryesisht janë kontrata dy dhe tri vjeçare. I dimë se sa mjete janë. Unë e kam biseduar me të gjithë operatorët ekonomikë dhe ju kam thënë që ju duheni t'i përcjellni se ata e dinë shumë mirë se sa mjete kanë të planifikuara për këtë vit fiskal, edhe duhet të punoni aq sa keni mjete. Nëse ju keni mundësi me punuar më shumë, që ne pastaj në vitin 2025 t'i bëjmë këto pagesa, në rregull është. Po nëse mendoni që me afër diku 13 milionë euro kemi mundësi me i rimbursuar brenda vitit kontrata tri vjeçare është e pamundur, për atë janë tri vjeçare, dy vjeçare. Kështu që operatorët ekonomikë, jam shumë i interesuar me i mbështetur edhe me gjet format e ndryshme ligjore të cilët kanë mundësi me u rimbursuar dhe mos me i mbetur kërkujt borgj. Kështu që me ta jam kuptuar, unë e di që fillohen punime, unë veç kam filluar me dalë në terren edhe vetë me bashkëpunëtorët e mi, me i vërejt edhe punimet dhe cilësinë e punimeve në terren. Dhe e kam parë edhe gatishmërinë e tyre edhe mundësitë financiare të vetë operatorëve ekonomikë që mos ndërprehen punimet, por deri në një masë sa ata veç kanë mundësi. Përndryshe ne gjatë këtij vitit, me siguri që edhe me këto mjetet e bartura, edhe me një 5% që normalisht që ka me pas ndoshta projekte që s'kemi me mundur me i filluar edhe kanë me u rimborsu. Sa i përket kablllove, kabllot elektrike nuk janë veç në komunën e Prizrenit, janë në tërë Kosovën. Është tmerr, sinqerisht është një prej projekteve që komuna e Prizrenit veç është mendon për atë punë, veç kemi filluar disa procedura. Çdo kontakt të cilin e kemi pasur me Kedin, me nivelin qëndror, kërkesa jonë ka qenë që me mundur mbi nëpër rrugë kryesore dhe në lagje kryesore të intervenohet. Dijeni që është kompetencë komplet e tyre. Ata mund të veprojnë vetëm në mirëkuptim. Ata na kanë thënë që kanë një plan të investimeve dhe kështu që një gjë e tillë nuk është parapa. Pastaj drejtoria e shërbimeve publike ka marrë një iniciativë. Jemi në procedurë të tenderimit të një kontrate për largimin e këtyre kablove. Edhe kjo kontratë ka me qenë kontratë tre vjeçare edhe kemi me pa se si ta implementojmë kontratën. Kemi me filluar vetë, normalisht se Kedsi duhet të na i ofrojë zgjidhje teknike që ato na i ofron. Edhe ne me buxhetin tonë të mundohemi t'i fusim ato kabllot që ka mundësi. Pyetjeve të Ymranit. Sa i përket zbukurimit të qytetit, zonja Ymran, vetë festat e qershorit janë të bukura. Ne duhet t'i festojmë, është drejtoria e administratës me siguri që merret me dekorimin e programit të cilin e ka drejtoria e kulturës, rinisë dhe sportit, kështu që urime festat e qershorit. Prizreni është ashtu është i bukur është. U ngrit çështja Shadërvanit. Ka dhjetra prononcime që i kam dhënë për të gjitha mediat, jo vetëm lokale, por dhe qëndrore, ka pasur një interes të jashtëzakonshëm se çfarë ndodhet me Shadërvanin. Ne e dimë që punimet në Shadërvan kanë filluar para dy muajsh, jo më gjatë. Duhet ta dini shumë mirë që në Shadërvan janë bërë mbi 500 m kanalizim, që do kohë. Janë bërë në Shadërvan për mbi 500 m ujësjellës, lyp kohë. Janë bërë në Shadërvan mbi 500 m kanalizim të ujërave atmosferike, janë përfunduar këto. Duhet kohë! Normalisht që e kemi diskutime të vazhdueshme me Qendrën

rajonale për trashëgimi kulturore, për vendosjen e gypave nëntokësore, në këtë rast është në diskutim vendosja e ormanave. Është zonë që e ka një ligj nën mbrojtje, i cili kërkon kujdes të veçantë. Kemi dërguar disa variante, kemi pasur disa takime. Edhe takimin e fundit që e kemi pasur javën e kaluar, ditën e premte, kur kanë qenë përfaqësuesit edhe të Kedsit, edhe konsulencia jonë, edhe drejtoria e shërbimeve publike, edhe Qendra rajonale për trashëgimi kulturore, jemi përfruar deri në marrjen e atij pëlqimit, por nuk do të thotë që nëse s'e kemi marrë në këtë pëlqim që Shadërvan janë ndërprerë punët. Nuk janë ndërprerë punët në Shadërvan. Në Shadërvan punohet. Patë këtu edhe një kërkesë, patë edhe një shqetësim këtu që një qytetari tash po ndërldhem pasi është puna me Shadërvanin, mos ta zgjasim që ka rënë në një gropë. Është shumë e vërtetë që një operator, një privat ka hapur një kanal privatisht, pa leje! Pse e ka hap ky qytetar? Ne në kuadër të projektit tonë i kemi pasur të gjitha linjat e vjetra të kanalizimit, i ka kyq operatori jonë ekonomik. Në këtë rast në bashkëpunim me Hidroregjionin. Të gjitha lokalet të tjera, të cilët ne e dimë shumë mirë që janë me një metër katror shumë të vogël, nuk kanë pasur as ujësjellëse, as kanalizim. Edhe ata janë, kanë dashur veç me bë ato edhe normalisht që ata si operatorë, si operatorë kanë bërë jashtëligjëm se është dashur me ardh me kërku një leje normalisht në drejtorinë e urbanizmit edhe me fillu me me u kyç, nëse kanë pasur nevojë për kyçje të tilla, por lokalet e tyre janë aq të vogla sa nuk ju mundëson një infrastrukturë të tillë për me bë, se i kanë nga 2-13 m katrorë nuk kanë mundësi të vendosin një banjë ose diçka. Kjo ka qenë domethënë, kyçjet e vjetra janë lidhur krejt me projektin të cilën kanë qenë. Kjo është Shadërvani. Dinamika e Shadërcanit, unë ju kam thënë që projekti i Shadërcanit nuk është vetëm Shadërvani. E keni parë rrugën për Kala. Projekti është tre vjeçar, por është komplet zona e parë historike. Janë edhe rrugë të tjera, nuk është vetëm Shadërvani. Shadërvanin sivjet kemi me e kompletu. A ka mundësi të bëhet kjo për një muaj, dy? Jo, teknikisht nuk ka mundësi. Hajde delini ju këtu e ma thoni një zgjidhje që ka mundësi brenda një muaj me përfund. Nuk ka mundësi. Aty duhet, janë ardhur mjeshtër prej Italie, kanë fillu katër ekipe me punu në sheshin e Shadërcanit dhe sa më shpejt që ka mundësi për me u bërë në mënyrë shumë profesionale ajo punë ka me u bërë. Është punë delikate, nuk është asfalt, nuk është kupza, është kalldërëm. Ata janë veç ty punuar në Shadërvan. Nëse ju nuk i shihni është çështje tjetër. Shadërvan punohet. Punohet, punohet tani kanë me u hap kanalet për vendosjen e gypave të rrymës edhe të internetit. Keds, ne e kemi gjetur Shadërvanin me gropa. E kemi gjetur. Edhe e dini shumë mirë ju qysh e kemi gjetur në Shadërvanin edhe qysh është ndërprerë ajo kontratë me atë operatorin. Edhe në këtë rast, duke e parë që operatori të cilin e ka kontraktuar Keds, nuk ka mundësi me e kthyer infrastrukturën e Shadërcanit të kupzave në nivelin që duhet të kthehet, ne e kemi marrë përgjegjësinë vetë. Si komunë edhe ne kemi me e kthyer atë kalldërm. Mirëpo duhet kohë, kërkon kohë. Kjo kohë është deri në fund të vitit, zotohem që në bazë të dinamikës të cilën do të përfundon Shadërvani. Çfarë është Shadërvani? Është prej urës së Kforit që i themi ne, ura e gurit, qafa e kishës. Komplet ajo pjesë duhet të përfundojë, kurse dy vitet e ardhshme mendojmë edhe rrugica të tjera deri në Marash apo në Panteli, edhe disa pjesë të tjera të rrugëvicave që ndërhyjnë në sheshin e Shadërcanit të përfundojnë. Kjo është ai mega projekti i Shadërcanit. Hiç mos u shqetësoni se është e vërtetë që bizneset kanë pak probleme. Normalisht, po pa u bë kjo infrastrukturë, kur bëhet kjo infrastrukturë kanë me ju trefishuar punët atyre, edhe pse sot në Shadërvan shkoni edhe tashe keni plot me turizëm edhe qytetarë. A është më mirë me e pas të rregulluar po, po për dy muaj ditë nuk rregullohet. Dijeni që është një infrastrukturë që për dy- tre vite gjatë qeverisjes së juaj, veç janë bërë ato gropa, është shkatërruar Shadërvani dhe ka mbetur ashtu. Ne nuk po ju akuzojmë, nuk po akuzojmë kurrëgjë. Unë veç jam duke u marrë që projekti i

Shadërvanit, më afroni një projekt që ka mundësi me u bë për dy muaj ditë edhe për dy muaj ditë. Nuk ka mundësi me u bë. Teknikisht nuk ka mundësi me u bë! Pyetjes së zotit Haziz Hodaj për Shadërvanin e kam marrë përgjegje, për gurishte trafo. Haziz prej vitit të parë që kam ardhë 2022-ën kam pasur kërkesa për atë rrugë, kam dalë edhe vetë edhe pse e kam njohur edhe më herët, kam kaluar vetë nëpër atë rrugë. Aty ka një plan detal urbanistik ku kërkon një infrastrukturë rrugore me prerje tërthore 12-13 m. Nuk ka mundësi të ekzekutohet sepse ka objekte banimi me numër të konsiderueshëm. Unë e kam kërkuar prej qytetarëve të më japin vetëm pëlqime, se të gjitha janë prona private. Më japin pëlqime që atë pjesë të pronës e lirojnë për rrugë edhe unë jam në gjendje qysh nesër me fillu edhe me rregullu atë rrugë. Nuk i binë, i binë tre vetë, 30 nuk i binë. Kështu që unë nuk mund të bëj investime nëpër prona private pa pëlqimin e banorëve se është pronë private, nuk është e shpronësuar. Ne mundem me hy në procedurë të shpronësimit, me hy në procedurë të shpronësimit dihet që ka me zgjatë nga 10 vjet, ça po ta di unë se janë dhjetra dhjetra objekte që duhet rrënu. Kështu që më vjen keq, ne kemi intervenuar me zhavorr, kemi intervenu me bë rrafshime me gëdera, me maqineri të ndryshme, mirëpo problemi i asaj rruge ju e dini çfarë është i kahmotshëm, nuk është tash.

Haziz Hodaj (LDK): Domethënë kjo përgjigja juaj tash është e pashpresë për atë lagje? Janë në pyetje 200-300 familje drejtor, dhe do të duhej me ndërmarrë diçka urgjente, qoftë edhe e përkohshme thashë, qoftë edhe një asfaltim i përkohshëm deri në zgjedhje të problemeve, sepse nuk jetohet, thjesht nuk jetohet në atë gjendje çfarë është ajo lagje. Thash gjatë tërë dimrit ka baltë, e gjatë tërë verës ka pluhur. Ju e dini shumë mirë dhe ato janë kushte të pa jetueshme.

Çelë Lamaj (DSHP): Nëse ata qytetarë donë rruguë, ata duhet ti sjellin pëlqimet në drejtorinë e shërbimeve publike të noterizuara që na e lejojnë pjesën e ngastrës kadastrale për shtrimin e asaj rruge. Nëse ata nuk i binë dokumentacionin edhe ata e kanë hallin e vetë. A don rrugë? Le t'i binë. Është vepër penale nëse unë intervenoj nëpër prona private! Bujari, sa i përket trenit Bujar ka qenë një tren turistik, e dini edhe më herët. Është bërë një shpallje edhe në kohën kur unë jam ardhur, se ka pasur një afat skaduar. Është bërë një shpallje, shpallje publike për konkurrim, është një tren turistik i cili ju ka dashur Prizrenit, qytetit të Prizrenit. Ka pasur një operator ka konkuruar. Si t'i del ky mandat, hapet apet, e ka dikush tjetër edhe një tren mund të bëjë konkurrencë. Edhe ta kemi trenin turistik. Nëse ai tren turistik mendoni që e pengon zhvillimin e komunikacionit, edhe unë jam pak aty që mendoj që Prizreni i ka rrugët e ngushta dhe gjatë sezonit veror. Kemi pasur edhe probleme të tilla që ju kanë tërhequr vërejtja shpesh atij operatori. Kështu që ajo është çështje ligjore e përfunduar me zyrës së prokurimit.

Bujar Hasani (i Pavarur): Të bëra pyetjen edhe për vendin aty. Domethënë në qoftë se mundesh zyrtarisht me më njoftuar operatorit, domethënë në vitin 2018-19 ju ka ndaluar veprimtaria. Tash a ka të drejtë? Unë nuk po ta, në bazë çka ju ka ndaluar, tash në bazë të çka po i jepet leja. Unë këtu nuk po s'po më intereson. Edhe këtu domethënë vendi që është, është për autobus apo për trenin?

Çelë Lamaj (DSHP): Dëgjo, treni ka pasur një ndalje, e dini te Aurora aty që ka penguar mjaft lëvizjen e lirë të qytetarëve, sidomos në mbrëmje. Edhe unë e kam kërkuar personalisht që të bartet aty shumë shpejtë kemi me pas një shenjë të komunikacionit aty që fatkeqësisht nuk kam kontratë për shenjëzim horizontal dhe vertikal. Edhe ka me u vendosur që aty është vetë stacion i autobusave edhe i trenit. Autobusat kanë me pas ndalesë një minutë, për hyrje dhe dalje qytetarëve,

kurse treni mundet me e pasur më gjatë. Domethënë njëra-tjetrën nuk kanë me e penguar. Ka hapësirë të mjaftueshme që mundet me vepruar të dytë. Po është qit një shenjë e trenit veç, kështu që me i treguar trenit se s'bën me u ndal atje poshtë, po me shku atje. Ajo është e përkohshme, shumë është e përkohshme, por ka me u vendosur shenja edhe autobusit edhe e trenit. Dihet që autobusat ndalen edhe vazhdojnë se nuk rrijnë me pritë udhëtarë e kanë 30 sekonda, një minutë e kanë qëndrimin më të madh dhe nuk pengojnë. Kanalizimin në Randobravë dhe procka janë veç në procedurë dhe shumë shpejt kemi me fillu, po, po. Po dëgjo, krejt janë puna e mjeteve. Janë qaq mjete të planifikuara. Kemi me nisur, unë e kam kontaktuar operatorin që me mundësi të vazhdimi të këtij projektit që me 5%shin e mjeteve që kemi të drejtë si drejtori për me i bartë në këto projekte, për me i bartë edhe me përfundu projektin.

Bujar Hasani (i Pavarur): Ti e ke mikun tënd, drejtorin e ke të shkollës, ai jep aty, operatori i cili ka fituar tenderin dhe ka hequr dorë prej tenderit. E ka lënë punën. Sipas informacioneve domethënë që i japin prej fshatit, domethënë operatori ekonomik i cili e ka fituar tenderin për kanalizimin në fshat, ka filluar me punime, mirëpo e ka ndërprerë punën dhe e ka lënë punën, sipas informacioneve të cilët i jep drejtori i shkollës dhe i kam thënë edhe për prockën edhe për këto. Prandaj them, pse është ndërprerë? Arsyeja pse është ndërprerë?

Çelë Lamaj (DSHP): Informacion i gabuar. Unë peshën e kam me rikonfirmuar. Unë veç e kam biseduar, nuk ka katër pesë ditë për këtë projekt, s'më ka thënë që ka ndërprerë punimet. Punimet, çdo vend punishte ku nuk punohet, dijeni që nuk punohet vetëm për arsye që operatorët ekonomikë për shkak mjeteve se ata punojnë sa mjete kanë pasur në dëme. Nëse kanë pasur në dëme 100.000 euro, punojnë 100.000 euro dhe për pjesën tjetër, ne duhet të mendojmë se si t'i plotësojmë ato gjatë vitit 2025, eventualisht këtë vit. Pyetjeve të Shukri Qunit, unë i kam marrë disa pyetje të Shukriut që unë i kam marrë shumë seriozisht. Unë veç dje kam qenë, veç dje kam qenë edhe më vjen keq se nuk mujta me e takuar në Nashec, kam qenë me operatorin ekonomik dhe me bashkëpunëtorët e mi. I kam vizituar punishtet të cilat zhvillohen në Nashec. Janë disa rrugë që për shkak që ka probleme që ato rrugë ishin, kishin mjaft probleme me kanalizim. Aty tha, ka ulje të tokës edhe pse është shtruar me një shtresë të madhe të gurëve, përsëri edhe e presim ndoshta kohën e verës kur do të stabilizohet ai terren edhe do të fillohet edhe me rregullimin edhe atyre rrugëve. I pashë që janë bërë tri mure mbrojtëse kanë mbetur edhe një. Kështu që ka me u punu. Sa i përket ndriçimit duhet t'ju jap një përgjigje të gjithëve se ka shumë pyetje. Kontrata është nënshkruar. Fatmirësisht kontrata është nënshkruar me komunën e Prizrenit. Ju ka dhënë urdhëresa e parë operatorit ekonomik për auditimin e komunës së Prizrenit. Çfarë do të thotë auditim? Do të thotë me skenu gjendjen komplet në komunën e Prizrenit se çka duhet bërë. Kjo, ky auditim na zgjati diku në afat 30 ditorë, pas 30 dite do ta kemi pasqyren e saktë se çka i duhet Prizrenit. Sa kemi mjete, sa është kontrata, se kontrata është diku 2 milion e gjysë euro kontratë tre vjeçare. Çka mund të bëjmë sivjet, çka vitin tjetër dhe çka vitin e fundit me ato 2 milion e gjysë euro dhe cilat pjesë mund t'i ndriçojmë. Pas kësaj, po po merr kohë, merr kohë se si ka aty sikur sakezat me shku në shitore me i ble, po ai duhet me bë porosinë edhe ajo porosi zgjatet. Ajo porosi zgjatet diku, produkti është dy deri në tre muaj ditë që merr kohën derisa të na silltet. Kështu që rreth muajit shtator, eventualisht tetor pritne që Prizreni nuk ka me qenë më në terr. Tash unë po ja jap këtë sqarim, ju edhe në seancën tjetër mund ta ngrisni çështjen e ndriçimit. Përsëri përgjigjen e keni të njëjtë. Para muajit shtator, në riparime kemi me fillu shumë shpejt, shumë shpejt, se ka ekipe për riparim. Mirëpo për ndriçimin e ri Smart në qytet dhe Lledin nëpër fshatra, muajit shtator, tetor do

të fillohet edhe mu ka premtuar prej kompanisë, që gjatë këtij viti qyteti i Prizrenit do të jetë Smart. Shqipe, normalisht që kompanisë tonë, ndërmarrjes tonë publike ekoregjoni ju ka dhënë urdhëresë të pastrohen të gjitha rrugët prej shkurreve, kanë filluar, kështu që shumë shpejt do të shkojnë edhe në Has edhe do të pastrohet. Njëkohësisht është duke u bërë edhe pastrimi i varrezave në komunën e Prizrenit. Tajar, rruga e për Vlajshne, ju e dini shumë mirë se kaloni çdo ditë se në çfarë gjendje ka qenë ajo rrugë edhe çka është bërë. Normalisht që ne kemi kërkuar që edhe ato shqetësime që i the të gjitha janë të trajtuar. Kështu që hiç mos u bë marak se s'kemi me pre asfalt. Ka mjete nëse ka, kemi bërë lëshesa, kemi bërë edhe pak kanalizim aty, e dini shumë mirë ju. E ka intervenime që bëhet nën asfalt kur dojmë me bërë ndonjë gyp edhe ndonjë depërtim. Edhe ato 400 metra që i kam premtuar është veç urdhëresa është e dhënë edhe ajo unë e kam qenë vetë ditën e enjtë, të premte, kam qenë në terren edhe e kam parë edhe atë 400 metëshin tjetër, edhe ajo do të gërryhet një shtresë, do të asfaltohet, urdhëresa është dhënë.

Tajar Susuri (LVV): A ka me u bërë brenda në trup të rrugës apo jashtë saj? Vetëm këtë mu përgjigj.

Çelë Lamaj (DSHP): Kush?

Tajar Susuri (LVV): Infrastruktura nëntoksore në ato pjesë ku nuk ka infrastrukturë. A ka me u pre asfalt apo?

Çelë Lamaj (DSHP): Nëntokë, bëhet me shpim, ka maqineri!

Tajar Susuri (LVV): Po nuk ka edhe ujësjellës aty, nuk ka kanalizim?

Çelë Lamaj (DSHP): Krejt kemi me i bërë. Rruga stanet e Struzhës, Karanfil gjatë muajit qershor asfaltohet. Po, po po, këtë muaj. Këtë muaj, më mbaj për fjale. Gjatë muajit qershor asfaltohet. Aty ka mbërrit, vitin e kaluar ka qenë muaji dhjetor, ka pasur probleme se koha e dimrit. Unë e kam kontaktuar operatorin edhe ka disa punime, normalisht që ka edhe punime të tjera nëpër qytet, po gjatë muajit qershor do të përfundon asfaltimi te stanët e Struzhës. Egzona, dy stacione do t'i keni shumë shpejt. Islami e mori përgjigjen për Shadërvanin edhe për gropën Shadërvan për aksidentin që fatkeqësisht ka ndodhur, pa pasoja. Për farmakosin nuk jam unë, nuk di, s'kam informacion. Iliri, ndriçimin publikke marrë rruga e Ulqinit, po Iliri, është dhënë urdhëresa, shumë shpejt ka me u rregullu. Ne kemi një operator ekonomik, e ka një fenisher, i ka dy, punojmë dy rrugë, tre rrugë, po Prizreni ka për mbi tre, katër mijë rrugë edhe në të gjitha rrugët e komunës së Prizrenit punohet. Po shumë shpejt, shumë shpejt, shumë shpejt. Po që ato, që janë ngjitur me to, kjo pjesën e ka, e ka intervenuar kafeveja gjermane, ka bërë një arnim të asaj ruge, nuk jemi të kënaqur, ky është një operator i cili ka një kontratë jo me komunën, po me hidroregjionin, ata derisa ata nuk e përfundojnë infrastrukturën e vetë, pastaj ne si drejtori e shohim aty ku duhet të intervenohet, të intervenohet. Po fatkeqësisht, fatkeqësisht Bujar është jo, du me ju përgjegj Bujarit. Është bërë një gropë Bujar aty. Po më e mirë se sa që e ke pas Bujar Hasani. Shumë shumë e mirë është bërë. Shumë më bukur se e keni pasur gropa krejt. Rruga Tea – pompa Arbëria, kjo është bërë një temë, shtresa e parë e asfaltit që është vendosur vitin e kaluar ka dështuar. Arsyeja e dështimit të atij asfalti ka qenë që infrastruktura nëntoksore nuk është bërë ngjeshja e duhur. Laboratorët na kanë tregu se nuk bën edhe është ftu operatori. Është bërë një komision, ka bërë një raport prej 5 anëtarëve komisioni, inxhiniera profesionale, edhe ju ka dhënë urdhësesë operatorit që duhet të hiqet ai asfalt dhe të rivendoset, të bëhet shtresa, domethënë tamponi, të rregullohet

mirë edhe të bëhet projekti në bazë të projektit të cilin e ka kontraktuar. Nëse mendoni që paguhet dy herë, harroni atë punë. Ai ka, ai, ai asfalt vetëm një herë paguhet. Aq është kontrata, edhe krejt kjo është shkuar në dëm të operatorit. Në dëm të operatorit është shkuar. Po pse operatori nuk ka dashur me e shtruar asfaltin, pa e parë që ngjeshmërinë nuk e ka pasur nivelin e kënaqshëm. Kështu që aty është shkuar në dëm të operatorit, por me rëndësi që ne jemi brenda kontratës edhe kjo rrugë ka me përfundu gjatë muajit qershor korrik. Për shenjëzim, unaza e qytetit do të fillojë këtë fundjavë. Unë një kontratë të cilën e kemi proceduar na ka shkuar në Oshp, ka probleme përkundër vlerësimeve të ekspertëve që ai ankuesi nuk ka pasur të drejtë, është anku dikush tjetër, këto procedura janë që ne s'mund i ndalim. Unë e kam hapur një procedurë të shpejtë deri në 10 mij euro që kemi pas të drejtë dhe kemi nënshkru një kontratë ditën e djeshme dhe deri në fund të javës do të fillohet unaza e qytetit. Unaza e qytetit do të bëhet shenjëzimi, fillimisht shenjëzimi horizontal pasi e di që ka probleme me zebra, ka probleme me vija, kështu që këtë javë, në fund të javës keni me e pa në qytet. Faleminderit kryesuese.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit edhe juve drejtor. Drejtori Bexhat Bytyqi fjalën e ka, pastaj përgatitet drejtori i shëndetësisë.

Bexhat Bytyqi (D. Bujqësisë): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje për ekzekutivin, asamble, media, shoqëritë civile, qytetarët e nderuar. Florenti parashtroi një pyetje në lidhje me kompenzimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore. Në bazë të udhëzimit administrativ, Kuvendi komunal në Prizren ka formuar një komision i cili merret me vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore. Detyrat dhe përgjegjësitë e domethënë komisionit janë, dalja në terren, vlerësimin e dëmit, formimi i listës, pastaj lista e formuar bjeret në kuvend komunal, nga ju votohet dhe pastaj nënshkruhet nga kryetari dhe dërgohet në komisionin qeveritar i cili bën kompenzimin e dëmeve. Domethënë ne këto punë i kemi kryer Florent nga dëmet që janë shkaktuar vitin e kaluar, ju e keni fjalën. Ju e dini shumë mirë që atë listë e keni votuar, e keni votuar, ka kaluar domethënë tani më nuk është në kompetencat e komunës Prizrenit për kompensim të dëmit. Urdhëro Florent, nëse ke se s'kam unë çka me shtu në lidhje me këtë. Veç shkurtimisht desha me të informuar për detyrat e për.

Florent Ukaj (LDK): Ka qytete, jam i interesuar se ka qytete që i kanë marrë pagesat e këtyre dëmeve.

Bexhat Bytyqi (D. Bujqësisë): Unë kam informacionin që prej komisionit, prej komisionit vlerësues është kërkuar, është kërkuar t'i ndajnë disa kategori ku janë bërë vërshimet. Edhe ata janë tu punu, janë tu punu, nuk e dinë në çfarë faze se nuk është kompetencë direkte e Drejtorisë së Bujqësisë sepse komisioni është i informuar nga disa drejtor edhe janë tu e kry punën, jam i informuar që puna është tu u kry shumë mirë nga ky komision.

Florent Ukaj (LDK): Drejtor. Kjo është se ka zgjatur si procedura.

Bexhat Bytyqi (D. Bujqësisë): Po nuk është kompetencë e jonja Florent, ti duhet me kuptu.

Florent Ukaj (LDK): Nuk mundesh drejtor me thënë nuk është kompetencë e juaja, përderisa dëmet janë shkaktuar në bujqësi. Ti atëherë nëse nëse je duke e parë që nuk ke mbështetje prej ministrisë, duhet me krijuar një fond të veçantë që ata kanë rënë në lajthitje, drejtor, bujqit. Kanë hyrë borxhe me atë listë. Beso! Ti e di më mirë se je vetë prej asaj ane. Ju bë vlerësimi, ju bë krejt.

Atëherë unë propozoj si kuvend ne ta ndajmë, nëse ka nevojë ta ndajmë një fond të veçantë e të kompensohen, se beso në gjendje të mjerueshme janë bujqit sivjet.

Bexhat Bytyqi (D. Bujqësisë): Florent unë po e kuptoj shqetësimin e juaj, gjithashtu edhe shqetësimin edhe dëmet që ju kanë shkaktuar. Unë e kam qenë vetë në terren edhe i kam pa dëmet që me të vërtetë ju kanë bërë bujqve. Janë dëme të parekuperueshme për ata. Edhe pse kanë, domethënë kanë me marrë pagesë për ata, nuk mjafton ai, nuk mjafton. Unë e mirëpres, unë e mirëpres nga ju nëse kemi mundësi me bërë një fond të veçantë për kompenzim të dëmeve nga bujqësia. Iliri u çu, po kërkon kompenzim në shadërvan që ata punojnë me biznese, e do të jetë shumë më e arsyeshme që të formohet një fond për mbështetje të fermerëve. Shumë më e qëlluar se sa me mbështet... unë nuk jam kundër bizneseve, po këto bujqit janë shumë më dëmtuar sesa ato biznese që nuk edhe nuk po e shoh që ka ndonjë dëm atje që është duke ju bërë atyre biznes. Qemal, në lidhje me stacionin meteorologjik apo stacionin për antibreshër. Ne si drejtori, me marrjen e mandatit unë jam i interesuar shumë për me e bërë edhe në plan në buxhet, e kemi futur montimin e stacionit antibreshër në Piranë, në Piranë. Por kemi vështirësi në marrje të lejeve. Ne kemi ndarë një fond diku 70.000 euro për këtë pajisje. Gjithashtu baraz pajisjes për antibreshër ka me qenë edhe stacioni meteorologjik, i cili ka me marrë të dhënat në mënyrë automatike. Ne kemi menduar që të jem model në Republikën e Kosovës, të jemi të parë të cilët do ta implementojmë këtë projekt, po kemi disa vështirësi në lidhje me marrjen e përqimeve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinorë. Jemi në procedura, jemi në bisedime me ta, shohim më tutje se si do të mundem. Po jemi në procedurë, domethënë jemi, kemi marrë shumë seriozisht këtë, këtë punë. Shukri Quni ka parashtuar pyetjen në lidhje me rregullimin e disa rrugëve dhe kanaleve. Gjithashtu, Shukri brenda disa muajve do të rregullohet kjo. Po me operatorët ekonomikë, nuk ka, nuk ka dy javë që e kemi, kemi fillu, kemi filluar me këto punë edhe mbas prioriteteve edhe këto rrugë do të rregullohen. Unë të kam treguar edhe në seancën e kaluar me një bisedë që kemi pasur që i kemi marrë me prioritet edhe kërkesat e juaja, për arsye se janë shumë të qëlluar. Petriti ma ka parashtuar pyetjen rreth shqetësimit të banorëve në fshatin Zhur, që këtë pyetje ndoshta ka vutë vetit me ja parashtrë më shumë, sepse është kompetenca dhe është këshilltar i ministrit atje të bujqësisë edhe kjo më shumë është në kuadër të ministrisë.... Po s'është problem, e di, hiç mos u duhet se ne kemi përgjigje për juve sa doni se jemi duke punuar. Dafina, rreth pyetjes për dezinfektimin e qytetit të Prizrenit. Kontratën e kemi nënshkruar. Dje kam biseduar me operatorin ekonomik dhe prej datës 10 qershor do të fillojmë me deratizimin e qytetit të Prizrenit. Kemi bërë planin dinamik dhe do të vazhdojmë më tutje mbasnej edhe me dezinfektimin e qytetit të Prizrenit. Po fillimisht do të fillojmë me 10 qershor edhe do të fillojmë deratizimi i qytetit.

Dafina Alishani (LVV): A mundeni me dalë me një informim për qytetarët?

Bexhat Bytyqi (D. Bujqësisë): Po patjetër, patjetër. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor. Janë disa anëtarë të cilët e kanë kërkuar replikën, Shukri Quni, Dafina Alishani, Florent Ukaj edhe Petriti pastaj.

Shukri Quni (Nisma): Faleminderit kryesuese. Nuk desha me ndërhyrë, por tash pasi dhanë përgjigje është edhe replika. Drejtor, se çka ju bëni ti këtyre sot qysh i hipnotizove nuk e di. Mua atë ditë janë kanë te më shky, s' u ulëshin me thënë dy fjalë desha me i fol. Po ty bravo të qoftë. Ty sefte që të qetësoj edhe Dafinën. Drejtor unë atë ditë, shumë e vërtetë ka qenë që kam pas me

ju kërkuar disa drejtorëve falje. Pse? Tu fillu prej drejtorit të administratës kur dojke me shti për zgjedhë këshillat e fshatrave nuk e kemi lënë me fol, ulu i thojshëm atje edhe u ulte. Drejtorin e shërbimeve publike Osman Krasniqi, unë për vete tu ju pa juve tash unë e ndjej veten goxha fajtor, se goxha keq jemi sjellë me ta, se kemi lënë me fol. Drejtoreshën e arsimit, valla kemi hy në gjynah me të. Tu ju pa juve tash qysh jeni duke punuar, kemi hy në gjynah me të. Çka i kemi bërë ne si asambleistë katër vjet. Tash nuk po hyj rend krejt, veç këta, goxha e ndjej veten të rënduar, se kemi menduar që kur të vini ju, goxha do punë keni me krye. Veç që jepni fjalë e punë hiç, kjo u pa! Atë ditë unë e kisha me diskutu me fillim qeto, se unë nuk e di tash Qelë ti, këta të rinjtë s'më njohin fort, veç ti goxha më njeh. Unë me bë me ja bë njerit të padrejtë, unë e baj si barrë ata në shpinë, a di them, pse ja bëra. E duke i parë ata këtu do rrethana. Atë ditë këta kolegë kuvendarë, nuk e di çfarë kishin pasur. Të organizuar ishin qenë shumë mirë, unë s'dijsha send. Unë desha me fol, Bujari hava, kadal bre Bujar ulu njëherë të bisedoj diçka kadale mos u ngut. Edhe kolegët tjerë tash mos të hi me rend këtu. Edhe e lëshuan mbledhjen. Këtu paska qenë dashtë vetëm ti me qenë. Edhe ti paske pas me qetësu këtu situatën pa kurrfarë problemi hiç. Qysh po e shoh tash, po më vjen mirë Qelë që po, tash goxha mirë po diskuton, fjalë të forta po punë, për nga unë po flas, je kanë vetë i ke parë aty. Qelë, unë e dua kontratën e punës që ai punëmarrësi që e ka në Nashec. Kjo është kontrata e punës që e ka punëmarrësi në parkun drejtoria e turizmit. E di krejt çfarë kam me punuar. Ai s'më ka afruar kontratë. Unë mos paqa përvoja të tjera, se për këto, për hundë më kanë dalë. Punimet nuk ka nevojë ai me shku me i kap krejt, a ke parë qysh i ka rrukë. Pse s'i ka marrë katër, pesë rrugë me i krye? Pse kanë shku të gjitha ato? Deri kur ti qetë kupëzat, barin ka me marrë unë me kosit. Sikur do trotuar që i ka qit Vetëvendosja në Nashec. Shok kqyre, me kosë duhet me i kosit. Se ata s'kanë bërë kush e di çfarë pune. Po ne i kemi kritikuar. Bile s'i kemi lënë me fol hiç shumë raste. Tu mëndu që kur të vini ju në pushtet, sidomos drejtoreshën e arsimit që po them, se kemi lënë me e shti në rend dite për zgjedhjen, komisionin e për zgjedhjeve për drejtor. Ju kanë ardhur juve gati këtu të gjitha. Edhe sot, s'jeni në gjendje dy fjalë me na u përgjigjur seriozisht. Për atë, Dafina Alshani ka qenë pyetja te unë atë ditë edhe Bujar. Qeshtu. Jo jo, merr ti replikë sa të duash. Atë ditë, unë atë ditë unë jam habitur me ju. Çfarë patë ju në atë farë forme që u qutë, unë se disha a jeni kundër meje a kundër pushtetit o burrë. Unë nuk jam ekzekutiv, unë jam me ju këtu. Edhe ju kam mbrojtur sa kam mundur juve. Kurrë ... e bardhë se kam bërë si ekzekutiv. Tu mundu me i mbrojt kush e mendon të drejtën. E ju atë ditë ishin të përgatitur, po e lëshojmë mbledhjen, qohu lëshone tash. Hajde tash lëshone ta këqyrim sa e keni atë fuqi për shembull, a po e lëshoni, po s'guxoni me lëshu tash? Ju hipnotizojnë!

Dafina Alishani (LVV): Arsyeja e lëshimit të sallës, ka qenë mungesa e drejtorëve të cilët kanë pasur pikë në rend të ditës për të cilat ne kemi pasur me votu. Arsyeja tjetër ka qenë që ne kemi pasur pyetje për këto drejtoritë të cilat kanë qenë duke munguar. Keq edhe hala që nuk është edhe kryetari këtu, nuk ka pasur asnjë bashkëpunim, ajo ka ndodhur. E kemi parë mungesën edhe domethënë e kemi shprehur pakënaqësinë tonë. Edhe s'ka kurrgjë të keqe me i kërku llogari ekzekutivit edhe me i kërku prezencë fundja. Unë s'di pse kaq po bëhet e madhe kjo! Sa i përket... Jo në hava, ne s'kemi kurrgjë kundër juve zoti Quni edhe mos e merrni këto personale, ne kemi punë me ekzekutivin. Secili asambleist, secili asambleist duhet me pas parasysh me i kërku llogari ekzekutivit, qoftë opozitë, qoftë pozitë! Sa i përket se kush po dezinformon këtu lidhur me nënat lehona, zotëri nënkryetar, mua po më vjen keq që po e personalizoni edhe po mundoheni me sulmu në person. Në seancën e fundit ju kam treguar, prapë po ju përkujtoj. Lista e përfituesve për

subvencionimin e nënave lehona është shpallur më 15 shkurt. Afati i ankesave për këtë listë ka qenë 15 mars. Sot data është 4 qershor dhe ne ende kemi pritje për pagesat e nënave. Nëse ju po thuani që 600 personave ju është bërë pagesa, kërkoj nga ju për secilën asambleiste me bë një listë, sepse nënat po i kontaktojnë asambleistët. Ju as s'po i hapni telefonat, as s'po i pritni njerëz nëpër zyre. Na dërgoni listën neve, kush paska marrë subvencionim, edhe ne, kushdo që na kontakton prej nënave, i informojmë edhe i tregojmë kur është data e fundit që kanë me i pranë ato pagesa. Se ka katër seanca këtu që ju keni thënë muajin e ardhshëm, muajin e ardhshëm, se kush po keqinformon, atë e sheh qytetari. Sa i përket drejtorisë së shërbimeve publike, drejtor, a je i vetëdijshëm që me gojën tënde këtu në kuvend, para të gjithë kuvendarëve pranove që po punohet pa leje në Shadërvan. Qysh ju paska ik ai biznesi që paska hapur gropë pa leje midis Shadërvanit? Pse s'po i kontrolloni edhe pse s'po i inspektoni? Pastaj, i keni kërkuar nga 800 euro prej bizneseve për kyqjen në rrjetin e ri të kanalizimit të ujërave të zeza, sepse me projektin e komunës nuk është paraparë kyçja e lokaleve në rrjetin e ri të kanalizimit. Sa i përket rrugës te Tea-ja, a po dalin fjalët tona që nuk ka pasur aty punim kualitativ? Pse nuk i keni marrë parasysh ankesat tona? Pse na keni akuzuar që ne nuk dimë asgjë? Vetë tash po thoni që shtresa e parë paska qenë gabim! E ne këtu në secilën seancë kur e kemi ngritur, na përbuzsše dhe na thoshe që çka dini ju prej asfaltit, nuk merrni vesh kurrëgjë. Sa i përket drejtorisë së arsimit, vlerësimi i Ministrisë së Arsimit po të pëlqen tash a? A vazhdimisht, vazhdimisht ankoheni që niveli qëndror ka vendime politike, nuk ka bashkëpunim. Tash dilni këtu edhe referenca! Zonjë, unë pyetjen e kam, pse po organizohen ekskursione të jashtëligjshëm? Nuk të pyeta apo më lexon statusat, se hiç s'po më intereson a i lexon statusat. Po nuk keni të drejtë, nuk keni të drejtë me përmend emra. Unë nëse e bëj një ankesë, nuk ke të drejtë me ma qit emrin edhe pse s'kam bërë asnjë ankesë tek ju. E keni përmendur secili zyrtar i DKA-së thotë ajo e Vetëvendosjes po i ndalon ekskurzionet. Mu po më vjen keq që ju kanë, ju kanë prishur pazaret. Po më vjen shumë keq! Po nuk keni të drejtë me përmend emra. Edhe kjo nuk ndodh vetëm me DKA. Kjo ndodh edhe në inspektoriat. Unë e lajmëroj inspektorin, inspektori shkon te ndërtuesi, thotë, që se kjo e Vetëvendosjes më ka dërguar. Ne reagojmë për terasat në Ortakoll, shkoni në Ortakoll thoni Iliri edhe Dafina po na dërgojnë, se ne nuk po dojmë me ardhë. Është për të ardhur keq, ligji duhet me ju dërgu nëpër ato terene. Jo Dafina, jo Iliri! Ju bëj thirrje secilit drejtor. E fundit, ne dëgjuam arsyetime për Shadërvan, po nuk morëm përgjigje konkrete. Punimet kur kanë me u përfundu? Ju po thoni italianët kanë ardhur, nuk po i intereson qytetarit a është italian, a është francez? E dëgjova, qysh se dëgjova. Çfarë fundi, cila pjesë deri në fund të vitit? Unë po flas për Shadërvan, ju po e promovoni, po thoni edhe në Kala. Pa u kryer Shadërvani, pse dilni në Kala? Për qejf tondin, po qekjo është arrogancë. Dheze mikrofonin edhe thuaj për qejf tënd.

Çelë Lamaj (Dshp): Pse ti do me ma përcaktu dinamikën time si drejtor? Kur vjen ulesh ti këtu atëherë e përcakton dinamikën tënde.

Dafina Alishani (LVV): Një qytet e ke bllokuar edhe thua për qejf temin. Dheze mikrofonin edhe thuaj për qejf temin, le të ndëgjojnë qytetarët.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju lutem. Drejtor, Dafina, ju lutem, ju lutem. Vazhdojmë. Ju lutem. Pas Dafinës ja kam dhënë fjalën Florentit, ju kisha lut me radhë do ta merrni fjalën. Florenti fjalën.

Florent Ukaj (LDK): Faleminderit e nderuar kryesuese. Unë e pata dhe një pyetje për drejtorin, po shkoj më duket. Edhe për ty, a kemi hapësirë në këtë seancë me propozuar që me nda një fond të veçantë për dëmet në bujqësi?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Meqë u miratu rendi i ditës, e shohim për herë tjetër. Faleminderit Petriti, Petriti. Edhe do të kthehem te drejtorët përsëri.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Kryesuese, drejtori i bujqësisë do të thotë veç e dha një përgjigje dhe iki nuk ndejti me dëgju. Drejtori i bujqësisë Bexhati. Unë kam biseduar me të personalisht, pastaj kam biseduar dhe me drejtorin e agjencisë së pyjeve me Fidanin dhe më është drejtuar tek inspektoriati, ndoshta më lejohet edhe me i përmend emrin Osman Gashi, inspektori të cilin e sqaroi shumë mirë. Sa i përket çështjeve, tha, është përgjegjëse agjencioni i pyjeve, por derisa këtu shoqata e gjahtarëve është pezull në gjykatë prej drejtorisë së bujqësisë, atëherë përgjigja i shkon direkt drejtorisë së bujqësisë që të mirret me rastin, duke i informuar organet kompetente të cilat janë: policia, zjarrfikësit e shumë e shumë organe të tjera. Mirëpo pse drejtori i bujqësisë po priton me u marrë me këtë rast, atëherë nuk mundet me lënë fajësin në pylltari. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, Tajari fjalën.

Tajar Susuri (LVV): Po drejtor, për te rruga nga Tea deri te Arbëria se u bë kjo, ka me hy në libër të guinnessit kjo rrugë. Veç desha me të thënë për replikën që ta pata bërë për matjet gjeomekanike, ti i ke pasur matjet gjeomekanike, që ke dalë me ekspertët e tu, u kanë dashur me marrë një dokument, pata replikuar që i ke fals matjet gjeomekanike. Edhe herën e parë, të lutem, të lutem mos ndërpre. Ke thënë që shtresa e parë e asfaltit është e segregume, i ka depërtuar uji poshtë në bazë. Tash po del që shtresa e tamponit po del e dobët. Nëse i ke ti rezultatet e matjeve gjeomekanike, shtresa e tamponit nuk duhet me dalë e dobët, nëse i ke të sakta. Tash më tregon ti mua, a është tu heq shtresa e asfaltit, a është tu heq tamponi? Vetëm këtë e dua... A je i sigurt? A dalim në terren edhe e çellim një pjesë? Veç unë e ti dalim në terren si ekspertë e kësaj fushe, dalim e çelim një pjesë të vogël, ku të thuash ti? Po dalim ne privatisht unë e ti si shokë edhe si të fushës. Edhe po e çelim diku. S'kemi të drejtë, okej. Veç organi mbikëqyrës? Okej, në rregull.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Karanfil Haxhillari fjalën.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit. Me të vërtetë po habitem me qasjen e drejtorëve. Drejtorë e dini që këtu përballë i keni përfaqësuesit e qytetarëve. Dhe të cilët që të gjithë jemi të votuar nga vota e qytetarit dhe e popullit. Kurse ju paguheni, ju paguheni me krye punë. Ne paguhemi me ju pyet juve dhe me ju kërkuar llogari. Neve, ju nuk jeni duke dhënë llogari. Asnjë përgjigje deri tani nuk e mora saktë dhe të detajuar për ata që paguheni ju dhe për të cilën duhet të punoni ju. Deri tash dëgjuam përralla, deri tash dëgjuam fjalë boshe, mjegull dhe kurrgjë të saktë. Në asnjë përgjigje nuk ishi të saktë, kur fillojnë punimet, kur mbarojnë punimet. Dalin në Kala, dalin në Shadërvan, dalin gjithandej. Dhe tani, unë nuk mora përgjigje për katrahurën që po ndodh në Farmakos. Sepse thota nuk jemi kompetentë, po dikush i ka dhënë leje atij me e prish. Dikush i ka dhënë leje, duhet përgjegjësi dhe duhet të shkojë në burg ai i cili një monument të mbrojtur i ka dhënë leje për me e rrënu. Dhe ju nuk keni përgjigje! Kurse paguheni për këtë punë. Tjetra, kjo arrogancë e juaja ndaj kuvendarëve me spina, me unë s'ni për ju, pastaj bëj çka do unë. Jo mor drejtor se s'mundesh me bë çka do ti. Jo mor burrë. Nuk mundeni çfarë doni me bë ju. Për

momentin ju ndoshta i keni prokurorët, gjyqësitë dhe hetuesat. Por nuk do t'i keni ndoshta më vonë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Bujar Hasani, ju lutem sa më shkurt, lutem zoti Hasani.

Bujar Hasani (i Pavarur): Nënkryetari është në vitin 2016-2017 unë kam qenë pjesë e ekzekutivit edhe nënkryetari e di shumë mirë tash ka qenë kryesues. Në qoftë se doni ju për me i zvogëluar gjithë këto diskutime, gjithë këto, ku ta di unë në lidhje përgjigje, vazhdon atë procedurën, na jepni përgjigje me shkrim. Drejtori le ta dëgjon pyetjen, le ta regjistrojë, na jepni me shkrim edhe na vazhdojmë procedurat, sepse nuk kemi ne të hyjmë në diskutime. Nuk do të thotë që unë jam i pakënaqur, jam i kënaqur ose i pakënaqur me përgjigjen e drejtorit. Drejtori këtu çohet edhe e uzurpon shumicën e kohës, drejtorat e uzurpojnë. 25 minuta ka folur që Qelë Lamaj. Ne tash na merr e drejta fjalës me thënë me bë. Ne bëjmë pyetje, jemi këtu përfaqësues, bëjmë pyetje. Nëse do, ke gatishmëri, ke njohuri, i ke informacionet, e japësh për ne. Nëse nuk do, ekziston shkrimi, jepe me shkrim përgjigjen edhe ne vazhdojmë punën. Na lejoni neve diskutimet që i kemi të drejtën me i bërë pyetje-përgjigje.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, po ju siç e dini ne e kemi edhe një rregullore të cilën, për të cilën jemi mbledhur nja dy- tre herë me shefat e grupeve edhe kemi vendosur me mbetë e njëjta. Po tash edhe unë s'kam çka me bë jashtë rregullores, shumë po duhet me bë.

Haziz Hodaj (LDK): Jo nuk kisha me bë veç me e respektuar rregulloren. Kaq! Edhe nuk jam duke parë rrugë tjetër! Bëjeni bre një takim një darkë si atje në nivel qëndror që keni bërë edhe i qetësoni gjakrat se shumë... Jo po nuk po nuk është mirë me i dhunu anëtarë të kuvendit të tjerë, po pajtohen plotësisht me Bujarin. Pyetjet le të bëhen, le të jenë me shkrim nga drejtorët edhe kaq.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Nënkryetari fjalën, ju lutem, nënkryetari.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Faleminderit. Unë drejtorat që kanë mbetur pa i dhënë përgjigjet, po i ftoj me i kthye me shkrim. Po e mbështes kërkesën e Bujarit edhe nuk po pajtohna veç me një send me Bujarin, veç pak. Bajram, tash ta jap përgjigjen. Nuk po pajtohen, sa i përket pyetjeve dhe përgjigjeve, dy orë kanë kaluar. Domethënë është çdo limit i tejkaluar. Ndash me minutazhë ndash me çka të duash. Parlamenti i Republikës së Kosovës, pyetje-përgjigje i ka 30 minuta. E ju që dy orë jeni duke folur. Nuk e di.. Ai drejtori Qelë Lamaj ai i ka pasur 90% të pyetjeve. 25 minuta janë normale me të kthye përgjigje. Po tash veç drejtori i shëndetësisë le t'i jap Bajramit, të tjerat i kthejm me shkrim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po drejtori i shëndetësisë.

Simir Krasniqi (Drejtore i shëndetësisë): Faleminderit kryesuese, i nderuar nënkryetar, të nderuar drejtor, të nderuar asambleistë. Pasi që unë i pata dhe tre pyetje nga zonja Ymrane, do t'i merr me shkrim, por pyetjes së Bajramit do t'i përgjigjem. Ju Bajram kërkuat një stomatolog në QMF Arbanë. Ju e dini që stomatologu ka shkuar në pension. Dhe ne shumë shpejt do ta zëvendësojmë pra me një stomatolog tjetër. Kurse sa i përket mungesës së mjekëve për këtë muaj, ju e dini që mjekët kanë qenë të angazhuar në vizitat sistematike me nxënës, jo vetëm në Arbonë, por ka pasur ndoshta mungesa edhe në QMF të tjera. Te renovimi, QMF-ja e Arbanës është e re, në 2019-ën dhe në 2020-ën është përruruar, po të shohim mundësinë se çfarë mundet me bërë aty. Ju

faleminderit edhe zotit Islam pra t'i përgjigjem te pyetja e vendimit që është marrë nga zëvendës drejtori i QMF-së. Zëvendës drejtori, pra transferin e mjekëve dhe të punëtorit higjienik e ka me rregullore të brendshëm që në ato vende ku ka mungesë të stafit, e bën bartjen. Nuk është që ka bërë shkelje ligjore. Kjo është përgjigja.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor. Islamit ju përmend emrin, po.

Islam Thaçi (LVV): Faleminderit kryesues. Drejtor, unë e pashë vendimin edhe pyetjen kur e drejtova, do të thotë, arsyetimi i zëvendës drejtorit nuk patë arsyetim që aty mungon stafi. Do të, sa i përket anës ligjore, ato vendos dikush tjetër, unë veç gjetjet që i bëra, i përmenda këtu. Edhe në qoftë se më lejohet kryesuese, e pata për nënkryetarin. Do të thotë, unë plotësisht e mbështes iniciativën e kolegut Bujar Hasani. Mirëpo këtu është problemi i arrogancës së drejtorëve ekzekutivi, për këtë arsye ne seancën e kaluar edhe nuk e mbajtëm në shenjë revolte, e kemi lëshuar seancën. Do të thotë pasojat e arrogancës, fjalorit po bijmë në situata që një seancë po duhet me mbajtur nga dy herë. Ju faleminderit.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesuese, 10 sekonda! Po, disa herë nuk po marr përgjigje kryesuese edhe as me shkrim as këtu në seancë prezent. Një çështje e ngretëm bashkë me një kolegë kuvendar. Në Poslisht është një projekti cili nuk po vazhdon. Uzurpator në atë lokacion është një zyrtar eksponent i PDK-së. Tash ju duheni me sqaru edhe duheni me sqaru veten me opinionin edhe me votues të juve. A jeni duke i ndejtë mbrapa atij personit? Çka është problemi që ka ngecur projekti? Kaq kryesuese.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Dëgjo, edhe disa drejtorë e kërkuan fjalën, por në qoftë se këta bien dakord me i sjellë me shkrim, atëherë e lëmë që me shkrim i sjellin në seancën tjetër, meqë edhe për shkak të kohës. Se po, e di që drejtorisë së turizmit ju u parashtru kjo pyetje. Atëherë kërkojnë nga të gjithë drejtorët, pavarësisht edhe këta që e morën fjalën, edhe këta të tjerët që nuk e morën, mos t'ju hyjnë në hak kuvendarëve dhe që në seancën e tjetër të kenë të gjithë përgjigje me shkrim për pyetjet që i parashtruan sot këtu në kuvend. Ju lutem drejtorë t'i sillni përgjigjet me shkrim në seancën e tjetër. Atëherë po kalojmë te pika e katërt, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 23 prill 2024.

Pika Katër

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 001/011-53593 të datës 23 prill 2024;

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Drejtori i financave fjalën e ka.

Sultan Badalli (DEF): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje për të gjithë. Qetësi nëse bën. Është fjala për bartjen e mjeteve të tejkaluara nga viti 2023, me një vlerë prej 2.487.000. Ju e dini se në mbledhjen e kaluar ka kaluar kjo bartje njëherë këtu, është votuar, mirëpo rekomandimet e Ministrisë, gjegjësisht Departamentit për buxhet, na kanë rekomanduar që të zvogëlohet numri i projekteve që është bërë ndarja në tre projekte dhe dy projekte që janë të shpronësimit, është i

varrezave dhe i objektit këtu mbrapa që e kemi i lirisë. Pra nuk kemi ndryshim të vlerës si total. I njëjti ndryshim është prej 2.487.000, një pjesë shkon prej 64.605 euro te drejtoria e arsimit për paga dhe shtesa, të cilët drejtoresha veç edhe e ceki më herët, ndërsa pjesa prej 2.422.432 euro është komplet për projektet kapitale. Pra bëhet fjalë e njëjta procedurë, por e njëjta procedurë është edhe çdo vit që bëhet bartja e mjeteve. Kërkohet të votohet sepse është në të mirën e vetë komunës tonë, për të mirën e qytetarëve tonë. Faleminderit!

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit drejtor. Po Petrit Hoxhaj në lidhje me këtë pikë.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese. Drejtor, në seancën e kaluar unë e ngrita si shqetësim sepse në listën që na keni dërguar kanë qenë disa projekte të reja dhe ju pyeta se a e keni pyetur ministrinë për vendosjen e këtyre projekteve dhe thatë që po gjithçka është në rregull. Ndërsa tash në listën tjetër nuk ka asnjë projekt i ri, janë thjesht do projekte të cilat janë ekzistuese. A do të thotë që kthimi është shkaku që nuk jeni konsultuar me ministrinë dhe keni vendosur projekte, nga keni dashur me i çuar këto mjetet, kaq.

Sulltan Badalli (DEF): Normal projektet shkojnë ku të do ekzekutivi, se nevojat ku janë, shkojnë projektet. Mirëpo rekomandimi i ministrisë kështu ka qenë. Unë ta tregoja çka është. Edhe herën e parë jemi konsultuar me ministrinë, te departamenti i buxhetit. Tash, pse ka qenë pushim një zyrtar, e tjetri ka ardhur mandej, tash janë probleme të tjera ato. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, Karanfil Haxhillar fjalën.

Karanfil Haxhillari (LVV): Në këtë rast i kam pesë minuta si shef i grupit për pikë të rendit të ditës. Me sa e dimë neve, Nënkryetar, të lutem, të lutem përmbaju, e di që je në siklet. Përmbaju, ruaje qetësinë edhe të lutem mos ndërhyj.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Të lutem. Të lutem, Karanfil, vazhdo në lidhje me pikën e renditjes.

Karanfil Haxhillari (LVV): Po jo sepse në mandatin tonë nënkryetarin se kemi lënë ciu me bë. Kurse ky e ka bërë si pronë e veta me qenë ky kuvend! Prej tani fillojnë minutat. Ju e mbajtët mbledhjen e jashtëzakonshme për këtë pikë. Domethënë keni kërkuar mbledhje të jashtëzakonshme, edhe pse neve patëm thënë që nuk është situatë e jashtëzakonshme për t'u mbajtur një mbledhje e jashtëzakonshme për një pikë të rendit të ditës. Dhe kjo pikë ka kaluar në seancën e jashtëzakonshme dhe përsëri na vjen, e njëjta pikë vjen në mbledhjet të sotme si pikë e rregullt e rendit të ditës. A po e shihni që haberin nuk e keni me këtë punë? Definitivisht haberin nuk e keni me këtë punë. Mbani mbledhje të jashtëzakonshme, në vend se në mbledhje të jashtëzakonshme duhet të përgatitet pika e rendit të ditës në mënyrën më të mirë të mundshme, kjo pikë na vjen si shumë pika të tjera, të kthyera nga Ministria si jo të ligjshme. Dhe neve si pikë të katërt të rregullt të rendit të ditës, duhet me e qit çdo herë shfuqizimi i vendimeve të mëparshme të pikave të rendit të ditës. Sepse kështu po shkon! Në çdo seancë kemi shfuqizime, ndryshime, ndryshim propozime të të njëjtave pika, të cilët në çdo seancë të kaluar neve votohen, kalohen, kurse na kthehen si të paligjshme. Në qoftë se ia hedhim një sy pastaj, bartjes së mjeteve. Pra përveç suficit, afër 7 milionë që ishte, na dalin edhe diku 3 milionë mjete të pashpenzuara të të hyra vetanake. Pra, të pashpenzuara në vitin 2023. Dhe arsyetimet e këtyre projekteve me të vërtetë janë qesharake. Për shembull, po e marrim shembull thotë, rruga Shuajb Spahiu që gjendet në

pjesën historike të qytetit që nga rëndësia dhe funksioni është rrugë e rëndësishme e veçantë. Jo bre! Domethënë, paska projekte që s'kanë rëndësi, paska projekte që janë të parëndësishme dhe kjo rruga papaska rëndësi?! Po duhet të gjitha projektet ta kenë rëndësinë e tyre. Pra, përsëri kemi arsyetime të kota, të cilët na vijnë këtu, na servohen këtu dhe neve si kuvendarë duhet që t'i gëlltitim patjetër. Ju lutem, unë po e di komplet rëndësinë e shumë punimeve të cilët kanë mbetur mbrapa. Po e di edhe dinamikat e caktuara, por vetëm kur po e bëjmë krahasimin e pyetjeve dhe përgjigjeve të cilët i patëm dhe përgjigjet të cilët i morëm. Dhe bartjen e mjeteve po e shohim që në qoftë se nuk kalon kjo pikë e rendit e ditës, shadërvani do të mbetet në pafundësi pa u kryer. Rruga Shuajb Spahiu, po ashtu do të mbetet në pafundësi pa u kryer. Pra është me të vërtetë një jo përgjegjësi, jo planifikim dhe në fund fare kjo është për të ardhur keq sepse jeni mburrë që neve dimë të qeverisim, jeni mburrë që neve dimë të planifikojmë, të realizojmë dhe të cilën për gjatë tre viteve po na del e kundërta. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Dikush tjetër prej anëtarëve të Kuvendit? Po drejtori fjalën.

Sulltan Badalli (DEF): Veç dashta shkurt zoti Karanfil, nuk janë mjete të shpenzuara këto. Këto janë mjete të tejkaluara nga planifikimi në një, edhe nuk është kthyer kjo e jashtëligjshme. Këtu kemi vetëm një plotësim ndryshim. E njëjta vlerë është, totali është. Nuk ka kurrgjë të paligjshme këtu. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po Karanfil a deshte replikë?

Karanfil Haxhillari (LVV): Drejtor, a e mbajtëm një seancë të jashtëzakonshme për këtë pikë të rendit të ditës dhe thatë është shumë urgjente? A kaluan dy muaj po më duket? Prej asaj seancës së jashtëzakonshme? Pra që po bie që nuk u kanë urgjente.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Islam Thaçi fjalën.

Islam Thaçi (LVV): Faleminderit kryesues. Desha me plotësu Karanfilin po edhe ndërhyrjen e drejtorit. Askund ministria nuk ka thënë që është i kundërligjshëm, po të gjitha vendimet po kthehen për shkak të gabimeve në procedura kur po përpilohen. Sa për informim edhe qytetarëve dhe ekzekutivit edhe kolegëve kuvendarë. Që një muaj kam hyrë t'i rishikuar vendimet që janë marrë në këtë kuvend, do të thotë po del që përafërsisht një vlerë numerike që afërsisht 43% të vendimeve janë sjellë në këtë kuvend nga dy herë, nga tre herë nga të marra në këtë kuvend, të përgatitura nga ekzekutivi, e që janë kthyer nga ministritë përkatëse për plotësim ndryshim apo edhe për anulim siç do ta bëjmë në pika më tytje. Do të thotë 43% është pasqyra e keq, ta quaj planifikimit të veprimeve që po i bëni si ekzekutiv. Edhe vërejtja tjetër është që do të thotë që ndërlidhet me drejtorinë e shërbimeve publike, drejtor, që parës nuk e mora fjalën, keqplanifikimi ka pasoja. Domethënë, në fjalorin e juaj, ju thoni megalloman, po megalloman po del për arsye të punëve të keqplanifikuara në fillim. Pastaj po stërgjatet. Unë edhe në qeverisjen e kaluar s'kam qenë idhtarë i projekteve tri vjeçare, katër vjeçare. Për shkak të kostos që po del te qytetarët. Qytetarët po pësojnë, ndoshta në fund po bëhet mirë, po për tre vite, katër vite, pasojat i bartin qytetarët. Jam qenë idhtarë, të bëhet sa më pak projekte, me sa më pak kode buxhetore që të hyhet brenda vitit edhe të realizohet. E jo të ndahet 300 ditë pune, 300 ditë pune janë dy vite e gjysmë, pastaj ngeci. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Dikush tjetër? Në qoftë se nuk ka, po zotëri Hodaj edhe Dafina.

Haziz Hodaj (LDK): Çështja e kthimit të vendimeve të Kuvendit, e kam thënë shpeshherë, e kam përsëritur, e kam ripërsëritur. Sigurisht që do një vëmendje të posaçme prej administratës, prej drejtorive përkatëse, sepse nuk është mirë që në këtë nivel me u kthy vendimet. Ky është trend i vazhdueshëm, domethënë kjo i ka ndodhur Kuvendit të Prizrenit vazhdimisht, kthimi, nuk di a ndodh në komuna të tjera, nuk kam informacione, mirëpo kthimi i vendimeve për çështje krejt teknike, për çështje krejt banale, sinqerisht na qet poshtë edhe si kuvend, edhe si institucion, edhe si komunë. Prandaj duhet me pas kujdes. Ju kam thënë, bashkohuni krejt krerët e komunës edhe kur e hartoni një vendim që e dërgonin në ministri, mos lëni hapësirë me ja u kthy. Vazhdimisht me u kthy vendimet edhe për një mend nuk ka asnjë kuptim, mbledhje e jashtëzakonshme ke thirr për këtë pikë të rendi të ditës dhe tash hala nuk është bërë vonë, domethënë, ke javën e kaluar, mbledhja dështoi, po që se dështon edhe sot, bën edhe më vonë me i bartë këto mjete. Sigurisht që janë të domosdoshme, është nevojë edhe duhet me i aprovu. Mirëpo po them kthimi i vendimeve nuk është mirë për kuvendin, nuk është mirë për institucionin tonë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Fjalën e ka Dafina Alishani, pastaj Bajram Kastrati.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesuese. Drejtor, ju thatë që arsyeja e kthimit të këtij ka qenë që i kanë kërkuar kontratat apo projektet të cilat mbarojnë këtë vit. A është ashtu? Kurse këtu te rehabilitimi dhe revitalizimi i hapësirave publike në zonën e parë të mbrojtur në pjesën e vjetër të qytetit, restaurimi i shesheve dhe objekteve, bartja e të cilit është afër 1.108.000. Këtu te komentet po e shoh që po thotë, konstatojmë se mund të realizohen punime në këtë vlerë prezantuar për bartjen, ndërsa pjesën tjetër zotohemi se do ta realizojmë në vitin 2025, meqënëse ky projekt është tre vjeçar. Prapë po vijmë te ky diskutim i Shadërvanit edhe shtoni këtu te komentet, thoni po e bëjmë projektin për qejf të Qelë Lamajt. Shkruaje këtu, thuaj për pikë të qejfit Qelë Lamaj jemi duke bërë këtë projekt. Edhe e zgjasim, pastaj te Shuajb Spahiu, mos keshni se nuk është për me kesh. Te Shuajb Spahiu na pasket zbuluar këtu, fenomenal e paske të përshkruar. Domethënë thotë, ndërtimi i kësaj rruge, gjegjësisht përshtatja e materialeve ndërtimore me zonën historike ja shton bukurinë kësaj pjese dhe e bën më atraktive për turistët dhe për komunitetin në përgjithësi. Nevoja për financim të këtij projekti është e domosdoshme, andaj edhe ne si DSHP do të angazhohemi të sigurojmë mjetet e nevojshme financiare për përmbushjen e kontratës. Me këto mjetet të bartura përfundon projekti. Ne, sendet e njëjta po i thojmë, po vetëm se jemi opozitë po ju vjen inati me i pranë. Ne po ju alarmojmë që është shumë me rëndësi edhe për atraktivitetin e qytetit, për turistët, stërzgjatje ka, tash kur është puna me i bart mjetet, e zbuluroni këtu dhe na shtoni rëndësinë e atraktivitetit edhe vizitorëve. Edhe këtu, a është qejfi juaj zotëri Çel Lamaj? Shkruaj edhe këtu, thuaj për qejf Qelë Lamaj po dojmë me bë Shuajb Spahiun. Po shtoj edhe për qejf të kryetarit se shtëpinë e ka aty. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Bajram Kastrati, fjalën e ka.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit kryesuese. Sinqerisht jemi bërë të tepërt me disa projekte, disa kërkesa që nganjëherë ndoshta edhe marre po na vjen që me ripërsërit, siç është projekti i varrezave të qytetit edhe varreza të tjera të Arbanës. E krejt çka po më intereson mua edhe herën e kaluar edhe pse nuk isha për rekomandim me seancë të jashtëzakonshme, erdha dhe votuam pro

këtij projekti. Krejt çka po më intereson edhe një pyetje e kam për nënkryetarin ose drejtorin që është kompetent. Cilat janë procedurat dhe kur është një target i fundit që ke me fillu me varrimet e reja? A ka mundësi me dit një afat kohor se me të vërtetë është gjendja e jashtëzakonshme edhe te varrezat e qytetit edhe te varrezat e Arbanës. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, zoti Bujar Hasani fjalën.

Bujar Hasani (i Pavarur): Faleminderit. Do të kyçem edhe unë pak lidhje me kthimin e këtyre vendimeve, por unë në këtë rast pak do të bëhem autokritik ndaj vetvetes, megjithëse unë nuk marr pjesë, por për opozitën. Është mirë që për shembull unë nuk e fajësoj në këtë rast pozitën sepse po vijmë propozimet prej ekzekutivit dhe pozita ka për detyrë i voton. Mirëpo këtu po del që edhe opozita po i voton vendimet, të cilat mandej po kthehen si të jo jashtëligjshme apo jo me defekte administrative. Andaj tani kërkoj prej opozitës, a do ta votojmë tash këtë propozim për këtë bartje apo nuk do ta votojmë? Për arsye sepse në qoftë se është jo qekaq urgjente, është kërkuar mbledhje e jashtëzakonshme, dhe tash prapë po vjen pyetja, prapë me disa përsoshkrime prapë me u votu, atëherë t'i thirrjmë mendjen edhe për shembull edhe ne duhet të analizojmë dhe të vijmë deri në një përfundim që propozimet të cilat nuk janë konform standard ligjeve, të cilat janë, mos të votohen. Pozita i ka votat, i ka numrat le ta voton dhe e mbart përgjegjësinë pozita, prandaj, sepse këtu shumica domethënë po votohet prej shumicës. Kaq kisha. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Alban Bislimaj fjalën.

Alban Bislimaj (PDK): Faleminderit kryesuese. Përsoshndetje kolegë, kuvendar dhe ekzekutiv. Unë mendoj që ky kthim është bërë më shumë prej çështje politike, si çdo kthim që na bëhet deri më tani, prej marrjes së mandatit, domethënë kemi shumë kthime të vendimeve për shkak që anës politike duke e ditur që nivelin qëndror udhëheq Vetëvendosja. Edhe nga ajo xhelozia që nivel qëndror shumë pak punohet dhe në komunën e Prizrenit punohet shumë, edhe s'kanë qysh me na ndalur ne ndryshe, veç me na kthy vendimet. Është e qartë Karanfil, është një send që shihet edhe krejt e shohim se çfarë po bën qeveria. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Po Shukri Quni fjalën, pastaj Karanfil.

Shukri Quni (Nisma): Te kthimi i vendimeve, nuk e di sa e mban mend Karanfil, sa herë kur kemi diskutuar mandatin e juaj që mos me i votu disa, se e dishim që kanë me i kthyer prapë. Thashë bënu real edhe ti pak, sikur unë nganjëherë që po bëhem real që po them të vërtetën. Ka pasur raste që ju thënë mos e votoni se kanë me kthy mbrapa. Kanë me kthy. Edhe mua më vijke më shumë siklet se po devalvohet kuvendi. Se ne kemi një farë rëndësie këtu. Shumë herë po thirrmi në emër të qytetarëve, veç kur të ngritet dora këtu për me votu, nuk është mirë me na kthy mbrapa ato. Po kjo ka ndodhë edhe në kohën e juaj edhe në kohën më herët. Po kur është në interes të qytetarëve duhet me i votu. Unë e pajtohna me kolegun me Bujar Hasan kur tha pse po i votoni ju opozita? Unë bile sa kam qenë në opozitë asnjë vendim s'ja kam votuar juve hiç. Edhe kur e keni pasur mirë, e kam thënë se keni mirë edhe u kry puna, mos e voto. Faleminderit.

Karanfil Haxhillari (LVV): Neve grupi i kuvendarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në këtë mandat, si pozitë, gjithmonë kemi qenë konstruktiv dhe ato projekte të cilat kanë qenë për të mirën e qytetarëve.. Veç ta kryej, të dëgjova. Gjithmonë për të mirën e qytetarëve kemi dhënë votë për, kur kanë qenë projektet në rregull. Për këtë pikë, të rendit të ditës, Bujar edhe la Shuk, nuk kemi

qenë pjesëmarrës në seancë të jashtëzakonshme në qoftë se ju kujtohet. Kur ka kaluar kjo pikë e rendit të ditës. Dhe e kemi kundërshtuar seancën e jashtëzakonshme dhe nuk kemi qenë këtu. Prandaj me plot përgjegjësi e them që neve si opozitë nuk e kemi votuar këtë pikë të rendit të ditës dhe edhe sot nuk do ta votojmë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Prezent jemi 29 anëtarë po e hedhi në votim këtë pikë të ditës. Kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Ju lutem mbani dorën 22 jemi për. Kundër? 5 kundër. Abstenim? 0 abstenim. Atëherë miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Po shkojmë me një orë pauzë, domethënë deri në ora 1:30. I kisha lut anëtarët e KPF-së, vetëm një minutë një takim e kemi, anëtarët e KPF-së.

Pas pauzes.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Atëherë të nderuar anëtarë, përshëndetje edhe njëherë. Atëherë pas pauzës po e bëjmë edhe vazhdimin e mbledhjes. Prezent për momentin jemi 21 anëtarë. Kështu që pra siç e dini kemi mbetur te pika e pestë.

Pika e pestë:

Shqyrtimi dhe miratimi i rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores të datës 08/3/2012 për përdorimin e gjuhëve në komunën e Prizrenit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Pra siç e dini ne e kemi marrë një vendim për njohjen e gjuhës romë në përdorim zyrtar. Po meqë e kemi këtu edhe kryesuesin e komisionit po ja japim atëherë fjalën pasi që është dashur me u marrë edhe me u bë plotësim ndryshimi i rregullores. Zotëri Berisha, fjala për juve.

Imer Berisha (Kryesues i Komisionit): E nderuar kryesuese, të nderuar drejtorë, i nderuar nënkryetar zoti Gashi, të nderuar kuvendarë. Unë si si zakonisht kam kënaqësinë që të komunikoj me cilëndo audiencë, me cilëndo autoritet, e kam shumë të qartë se krejt jemi të dobishëm dhe krejt i kontribuojmë vetes sonë, familjes edhe qytetit. Ndaj është kënaqësi që të bisedojmë edhe sot. Kryetari i Komunës dhe lidhshipi zoti Shaqir Totaj me drejtorët edhe Nënkryetarin, Kryesuesin, vitin e kaluar kanë marrë një vendim administrativ që komuniteti rom, qytetarët e komunitetit rom që jetojnë në territorin e komunës së Prizrenit, të përfaqësohen institucionalisht në institucionin më të lartë komunën, me gjuhën e tyre romë si gjuhë zyrtare në përdorim. Kam kënaqësinë që vendimi i sotëm për këtë vendimmarrje sa humane, sa etike, sa profesionale, që ju mundëson njerëzve që të ndihen komod dhe mirë në territorin ku ata jetojnë. Kjo vendimmarrje normalisht që sipas kërkesave ligjore ka kërkuar që të formohet një komision dhe si kryetar komisioni kam ruajtur të drejtën që me patjetër komuniteti rom të jetë i përfaqësuar në komision dhe ta jep mendimin e tyre. Jam falenderues për punën e tyre, falenderues për organizatat e shoqërisë civile, falenderues edhe për ju meqë do të jeni pjesëmarrës të drejtpërdrejtë dhe kjo ndodh njëherë në jetë, kur komunitetit rom, ju si kuvendar me votën tuaj u thoni që po hapësira për ata që të flasin në gjuhën e tyre romë, është e lejuar në komunën e Prizrenit dhe për këtë jemi komuna kampion e para në nivel republike, flas në komunat me shumicë shqiptare pasi që edhe Graçnica e ka një vendim të formalizuar të tillë. Por me vendimin e sotëm nëse do të kemi sigurisht edhe vota të tuaja, qytetarët e komunitetit Rom, domethënë mund t'i drejtohen komunës së tyre me

kërkesë për dokumente që të përkthehen në gjuhën rome. Ne kemi bërë një marrëveshje me IOM-in të cilin e falenderojmë dhe e kemi të punësuar një përkthyes të komunitetit Rom, është veç duke përkthyer dokumente. Nëse tani hyni në webfaqen e komunës së Prizrenit, nuk e gjeni në asnjë webfaqe të komunave të Kosovës, është një link i veçantë dokumentet në gjuhën rome të cilat janë përkthyer. Kështu që me këtë rast ne kemi bërë veprime konkrete dhe normalisht unë e ruaj kujdesin intelektual edhe profesional që të qasemi. Qeverisja e Shaqir Totës, në fillim ka thënë do të bëj këtë, do të bëj atë, tani vijmë me argumente, vijmë me veprime konkrete brenda gjysmës së mandatit, me rezultate konkrete të cilët i mirë administrojmë qytetarin e komunës sonë. Sot flas për komunitetin rom, por nesër do të flasim për një komunitet tjetër politik. Me rëndësi është që autoriteti i komunës të prekë secilin qytetar edhe ta lehtësojë jetën e secilit qytetar. E keni parë projekt-rregullorja është ndryshuar në një nen, e kemi edhe një fjali atje, kemi shtuar një paragraf, ku gjuha rome është gjuhë zyrtare në përdorim, ka një dallim për audiencën rome më shumë, por edhe edhe shqiptare edhe boshnjake dhe turke. Nuk është e barabartë me gjuhët tjera, për arsye të specifikave, për arsye se komuniteti romë ende nuk e ka të formalizuar, për shembull, alfabetin rom të pranuar, ashtu kanë probleme të tjera të natyrave, se si do ta jetësojnë këtë vendimmarrje. Por me rëndësi është se komuniteti shqiptar, Komuna e Prizrenit, me kujdesin maksimal, me kujdesin human dhe etik, ka zhvilluar të gjitha procedurat dhe procedura sot është e fundit. E përmbysim vendimmarrjen administrative për qytetarët romë dhe e kam kënaqësinë ndaj normalisht në përmbysje dhe kërkoj nga ju vota të jetë unanime për arsyen të qëllimit që është shumë i mirë dhe do të bëjmë përpjekje maksimale që ata qytetarë ta jetojnë të drejtën e tyre të gjuhës sikurse të gjithë qytetarët e komunës sonë. Dhe për këtë unë kisha pasur qejf nëse kemi votë unanime nga të gjithë edhe një duar torkitje se njëherë ndodhë në krejt jetën. Për komunitetin rom, një duar turkitje ju lutem. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Berisha. Atëherë po kisha desha me shkuar me qëndrimet e shefave të grupeve, mandej mund ta merrni edhe ju fjalën. Po fillojmë me Lëvizjen Vetëvendosje.

Karanfil Haxhillari (LVV): Ky kuvend përdorimin zyrtar të gjuhës rome e kemi votuar edhe në seancat e mëhershme. Ekzagjerimin e zotërisë në fjalë Ymerit, po dua me e minu për arsye sepse këtu vetëm ata të cilët kontribuan për futjen e gjuhës rome në përdorim zyrtar nuk u cekën. Këtu duhet të falenderohen të gjithë ata aktivista të komunitetit rom, të cilët punuan pandalshëm dhe arritën që të kontaktojnë me të gjitha grupet parlamentare, të na bindin dhe ky kuvend e votoi në seancat e kaluara. Kurse sot neve do të votojmë për futjen në rregullore, ndryshimin e rregullores për përdorimin e gjuhëve. Dhe këto fjalë me të vërtetët kenë tepër ekzagjeruese, sepse as nuk u kanë premtim elektorale i Kryetarit të Komunës, qysh e tha Ymeri. Po kjo ka qenë iniciativë e aktivistëve të komunitetit Rom, dhe grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, vetëm për këtë arsye votojnë për, pra për shkak të koloritit të komunës së Prizrenit, ku edhe komuniteti Rom e pasuron komunitetet në përgjithësi në komunën e Prizrenit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit vazhdojmë me PDK-në.

Egzona Hoxhaj (PDK): Edhe ne do ta përkrahim dhe do të votojmë pro.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, LDK.

Haziz Hodaj (LDK): E mbështesim edhe ne.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Nga AAK-ja.

Bajram Kastrati (AAK): E mbështesim edhe na.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Nisma.

Shukrije Berisha (NISMA): Edhe ne e mbështesim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Nga komuniteti turk si kemi këtu. Nga SDU dhe Kualicioni VAKAT.

Admir Alilji (SDU): Edhe ne e mbështesim.

Sead Arifi (VAKAT): Edhe kualicioni Vakati e mbështet.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit të gjithëve. Atëherë prezent jemi 26 anëtarë, Më fal, po, thashë që pasi ta marrin shefat. Atëherë po, Bujar Hasani edhe Islami fjalën.

Bujar Hasani (I pavarur): Unë faktikisht i përshtesha të gjithë këto gatishmërinë, mirëpo fjalimi i zyrtarit për transparencë mua pak më preki në Po. Edhe isha kështu i emocionuar kur e dëgjova sepse ai kur fol gjithë të emocionon, po mos shkon në drejtimin në qoftëse dikush është kundër votimit për arsye se është kundër Romëve. Nuk duhet të jetë në këtë nivel që me u drejtuar në aspektin që, po në qoftëse është ky votim apo ai votim. Është një propozim i cili na krijon neve shpenzime, që jeni pajtuar të gjithë, por është një propozim që mos, në qoftë se unë personalisht jam, unë jam personalisht për shkak të shpenzimeve. Nuk kundër romëve, as kundër asnjë komuniteti. Mirëpo, duke i parë kapacitetet tona të cilat edhe në gjuhën shqipe po na mungojnë, e lëre edhe në gjuhë të tjera, domethënë unë e kam një mendim të kundërt. Ndërsa të gjithë ju të tjerët që jeni të gatshëm, votohet dhe nuk ka asnjë të keqe, kurrëgjë të keqe. Veç mos të orientohet ajo çështja që në qoftë se nuk votohet është kundër komunitetit. Kjo është shqetësimi im. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Islam Thaqi, pastaj Selman Sokolaj.

Islam Thaqi (LVV): Për plotësim të z. Berisha, duhet theksuar karshi komunitetit se duhet falenderuar siç tha dhe Karanfili, aktivistët e komunitetit RAE për punën e tyre të palodhshme. E vërteta e kësaj rregullore është se si nisëm ka afërsisht më shumë se pesë apo gjashtë vite që ka filluar, falë aktivistave të vetë komunitetit edhe shoqatës së tyre, Novo Konceptit. Mirëpo ajo që është shqetësuese që zoti Imer Berisha, e di edhe jemi ndesh në tryezën e organizuar nga IOM-I, është çështja e obligimeve që i merr komuna karshi rregulloreve të ngjashme apo të tilla. Realisht këtu është një dallim sa i përket edhe vetë termi e deklaron, do të thotë është gjuhë në përdorim,

edhe sa herë të paraqitet nevoja nga vetë komuniteti, komuna obligohet që kërkesat e tyre t'i plotësojë. Po s'është e obliguar gjithnjë pa ardhur një kërkesë nga vetë komuniteti që shembull ta përkthejë një dokument apo qasjen e dokument zyrtar në gjuhën e kërkuar. Është shqetësuese për faktin se komuna për momentin nuk ka paraparë me sa di unë edhe në planifikimin e sistemit, punësimin e një zyrtari i cili do të ruajë rolin e përkthyesit. Për momentin komuna do të shfrytëzojë marrëveshjen së bashku me komunën e Graçanicës të një përkthyesi në gjuhën në fjalë. Mirëpo shpresoj që komuna si institucion pavarësisht kësaj qeverisje, po si institucion do ta marrë seriozisht edhe deri në fund do t'i rri karshi zotimeve përmes rregulloreve që kalojnë në këtë kuvend. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Selman Sokolaj, Dafina Alishani pastaj.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit Kryesuese. Sa i përket votimit të kësaj rregullore, normalisht që edhe si individ do ta votoj për, mirëpo kjo ndahet në dy pjesë. E para nuk ka të bëjë me çështje morale etike kështu qysh e paraqiti parafolësi. Domethënë në emër të komunës, është obligim ligjor, besoj që përfaqësuesi i OSBE-së është edhe na rikujtojnë vazhdimisht kushtetutën, karakterin e kushtetutës tonë edhe ligjin për gjuhët që e keme miratu dhe tani çdo akt normativ normal që duhet me u nënshtruar kushtetutës si akti më i lartë juridik i një vendi. Ndërsa pjesa e dytë që ka të bëjë me komunën e Prizrenit, zoti Berisha foli për IOM-in, mirëpo nuk na tregoi ndonjë hap konkret që komuna e ka marrë që kjo çështje të zgjidhet në mënyrë afatgjatë. Që një punëtor kur të skadon kontrata me IOM-in, një përkthyesi ose çfarëdo qoftë, komuna të punojë edhe ta zgjidhë këtë në mënyrë afatgjatë. Domethënë kjo pjesa që i takoj me na sqaruar, nuk morrëm sqarime ose veç na tregojqë me IOM-in e kanë bërë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Këtu është, besoj se mund të marrim sqarime. Po Dafina Alishani, pastaj zotëri Berisha përsëri.

Dafina Alishani (LVV): Ju faleminderit, edhe unë jam e të njëjtit mendim që do të duhej t'i falenderojmë aktivistët e komunitetit Rom, edhe mendoj që edhe ju si ekzekutiv do të duhej t'i merrni shembull ata, për shkak që kanë qenë tepër profesionistë në aspekt të lobimit me secilin edhe janë munduar maksimalisht me e shpjeguar arsyen se pse duhet votuar. E sa i përket për senzitivitetin e kryetarit për komunitetet, unë e ftoj zotërin Berishaj që ta bëjë edhe një ftesë dhe ta zgjedhë edhe Nënkryetarin për Komunitete, sepse ka vite të tëra që nuk e kemi. Nëse nime e ka senzitivitetin për komunitete, e ka mundësinë me e treguar në përzgjedhjen e këtij posti. Mos i merrni meritat e tjetërkujna. Unë i falenderoj secilit e secilitës cilës aktiviste të komunitetit rom që e kanë bërë këtë gjë të tillë edhe uroj që këta aktivista në mandatin e ardhshëm do t'i kemi edhe në këto ulëse këtu si përfaqësues të këtij komuniteti edhe do të llobojnë më shumë edhe për kërkesa të tjera të tyre. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, zoti Berisha, fjalë.

Imer Berisha (Kryesues i Komisionit): Kështu, jeta na ka mësuar që koha është më e çmueshme se gjithçka tjetër. Është dhuratë e Zotit, është dhuratë e Zotit dhe ta shfrytëzojmë. Unë për atë arsye nuk u ndala në detaje, nëse keni arritur me e kuptuar. Zoti Selman Sokoli tha, nuk është etike

morale e të tjera. Ligji për gjuhët thotë: qytetarët në Republikën e Kosovës nëse kanë 3% të popullsisë së vendit, kalojnë në kategori ligjore për me i trajtuar domethënë me gjuhën e tyre zyrtare. Në këtë rast, komuniteti rom nuk i ka 3%, dhe absolutisht këta nuk janë kategori ligjore. Pastaj kujdesi i lidërshit të komunës së Prizrenit, në kërkesën ose lobimin që e kanë bërë aktivistët e komunitetit Rom, ne kemi mundur me e bërë skip. E kemi marrë e kemi shqyrtuar me seriozitetin institucional edhe kemi ardhur deri në përmbyllje sot me votën tuaj, një të drejtë, po jo ligjore, një të drejtë të vullnetit të lidërshit të komunës së Prizrenit. Komuniteti Rom e ka të qartë këtë problematikë, me Islamin kemi qenë edhe me IOM-in. Veprimet që ka marrë komuna e Prizrenit, në muajin tetor të vitit të kaluar 2023, Njësia që e udhëheq unë ka bërë shkresë zyrtare në adresë të burimeve njerëzore dhe Kryetarit të Komunës, mund t'ju dëshmoj letër zyrtare për lejimin e një zeri buxhetor të punësimit të një përkthyesi në gjuhën rromë. Pastaj kjo kërkesa ime është formalizuar, kam informacione zyrtare nga burimet njerëzore, që është inkorporuar në zërat shpenzues buxhetor për vitin 2024, adresuar qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës për me. 2024-tën flas, 23-tën është bërë kërkesa nga unë për 2024-tën. Për fatin jo të mirë, deri në këtë moment që flas, nuk kemi marrë përgjigje që kemi të drejtë me hapur një konkurs të tillë, jemi në pritje. Nesër nëse vjen, ju premtoj publikisht këtu që tha dhe për diçka, nesër nëse vjen nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave që Komuna e Prizrenit i lejohet hapja, ta dhashë edhe adresën ku e keni. Për një pozitë pune të komunitetit rom, po ju premtoj në maksimum kemi me qenë edhe natën me hapur konkursin edhe me punësuar një qytetar i cili e di gjuhë rromë, shembull Islam, unë po tregoj gatishmëria jonë. Mirëpo, mirëpo unë prapë do të thoj, nuk ka politikanë që do me bë karrierë nëse nuk ka etikë dhe moral. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Berisha. Po zotëri Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Ne u përgjigjem shkurt duke menduar që jemi tuj votuar një rregullore të cilën për të cilën e meriton komuniteti rom edhe kem pro. Po këtu tash Ymeri e kajti me lot si e ka zanat atë paraqitjen e tij. Vetëvendosja në mënyrën e vetë kërkoi me i falenderuar aktivistët që natyrisht ata kanë bërë barrën kryesore për me prurë rregulloren këtu. Po në fakt ata duhet me na falenderuar neve, që ne po e votojmë edhe po jua aprovojmë kërkesën e tyre. Kështu që hajde se gjysmën e votave të komunitetit rom i morë PDK-ja, gjysmën Vetëvendosja, na mbetën pa to, pa përkrahjen e tyre. Kështu që kështu që jemi pro. Nëse ju mjafton komunitetit rom kjo, unë besoj që duhet me na falenderuar si kuvend që jemi pro të gjithë një zërit me jua aprovu kërkesën e tyre. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit. Atëherë në qoftëse nuk ka edhe dikush tjetër diçka, po e hedhi në votim. Prezent jemi 27 anëtarë. Kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Unanimisht, faleminderit të gjithëve, ju faleminderit shumë. Kalojmë te pika e gjashtë.

Pika e gjashtë:

Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-rregullores për shërbime publike komunale në komunën e Prizrenit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po zyrtaari i cili do ta prezantojë këtë pikë, e kemi këtu prezent.

Rrahim Destani (Kryesues i Komisionit): Faleminderit e nderuara Kryesuese, drejtorë, kuvendarë dhe të gjithë të pranishëm në sallë. Ne sot po e prezantojmë një draft të rregullores e cila ka kaluar në procedurat deri tani. Me propozim të Drejtorisë për Inspektoratë, Kryetari i Komunës së Prizrenit Shaqir Totaj, me vendim 01/010/2024 të datës 12.01.2024, ka formuar grupin punues për hartimin e rregullores për shërbimin publike komunale. Rregullorja për shërbime publike komunale në pjesën më të madhe është përmbajtje e vendimit komunal për rregullimin e qytetit dhe shërbimeve komunale me numër 01/011 datës 18.11.2004. Me këtë rregullore synohet të sigurohet efikasiteti në punën e inspektoratit komunal dhe drejtorive të tjera komunale. Rregullohet hyrja dhe baza ligjore, harmonizimi i akteve të tjera juridike si dhe harmonizimi i gjobave sipas ligjit të ri për kundërvajtje. Rregullorja për shërbime publike komunale në komunën e Prizrenit, përmban: ujësjellësi dhe kanalizimi, gjelbërimi publik, sipërfaqet publike, gropimi dhe mënyra tjetër e dëmtimit të sipërfaqeve publike, rrugët dhe trotualet, objektet e përkohshme, kiosqet, tavolinat, karrikat, strehat e autobusëve, qadtrat reklamat e tjera, ndërtesat dhe pamja e tyre e jashtme, vitrinat, rrethojat, gropat dhe pusetat në rrugë, terrenet sportive, ndriçimet publike, tregjet e të tjera. Domethënë kjo rregullore përgjithësisht përmban menaxhimin e sipërfaqeve publike në territorin e komunës së Prezentit dhe inspektimin e tyre nga ana e inspektoratit komunal. Kaq, faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Prej anëtarëve të Kuvendit a dëshiron dikush me marrë fjalën në lidhje me këtë? Po Bujar Hasani fjalën e ka.

Bujar Hasani (I pavarur): Faleminderit për fjalën. Rregullorja, kjo prezantimi ke mjaftë i shkurtër, nuk ke mënyrë detale i dhënë për çfarë arsye po bëhet. Unë që nga viti 2001 kam qenë një ndër hartuesit e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave publike. Dhe që nga atëherë shumë pak ka dallim ose diçka përmirësime. Po është një theks i veçantë të Lëvizja e Vetëvendosje, pak më herët e futi në rend të ditës që bizneset të cilat janë në zonën historike dhe këto që po dëmtohen, me i zhdëmtuar dhe me i liruar prej pagesës, ndërsa tash vjen një rregullore, aty ku të thotë, hapësirat publike, sidomos këto lokale afariste dhe zona e parë, tavolinat të cilat i kanë të vendosura edhe gjatë sezonit të dimrit, të obligohen me u paguar pagesë për shkak që vetëm rrinë tavolinat edhe karrikat. Përndryshe janë të obliguar me i bajtur dhe me i hequr, me i liruar hapësirën. Me krijuar shpenzime, të cilat janë shpenzimet për mua, për mendimin tim, janë shpenzime të paarsyeshme, të panevojshme, sepse ato hapësira janë të dedikuara për ato lokalet që janë pronarë aty. Prandaj kjo ka qenë unë këtu, anën tjetër, rregulloren të cilën ne sot po kërkohet me u votuar. A janë të parapame me ligj, ligji i parashikon shumë në mënyrë të saktë se çka ka të drejtë të shfrytëzohet, çka nuk ka të drejtë të shfrytëzohet. E paraqet shumë mire aty dhe tash propozimi kësaj, unë nuk e di ku do të arrijë efektin, cili është efekti i kësaj rregullore, për me u propozuar një rregullore e re, që po them në detaje nuk u dha ku është qëllimi. Qëllimi i kësaj rregullore, ku është qëllimi, ku do të arrihet qëllimi? Pra në qoftë se votojmë diçka, në qoftë se nuk është e

rregulluar deri tash, nuk ka qenë e rregulluar me asnjë rregullore, me asnjë ligj dhe tash parashihet me u rregulluar, me u precizuar, duhet me ardhur në mënyrë precize për shembull për këtë fushë apo për këtë lëmi dhe jo në mënyrë të përgjithshme me u kërkuar një rregullore e cila për mua, për mendimin tim është e pa bazë dhe e pavlefshme. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Zotëri Hasani, fjalën Bajram Kastrati e ka.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit kryesuese. Të them të drejtën, rregulloren në përgjithësi se kam lexuar. Po u ndala te cilësia e ujit. Ne e dimë që kemi shumë gypa të ujit që janë nga azbesti edhe te mbikëqyrja dhe cilësia e ujit nuk po e shoh që është një vendim për eliminimin e tyre që realisht në shumë vende ai konsiderohet si kancerogjen edhe duhet me urgjencë me u larguar. Unë me sa e di kemi shumë gypa të tillë dhe nuk e vërejta në ndonjë nen që e kanë paraparë eliminimin e tyre. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Kastrati, po Selman Sokolaj.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesuese. Unë këtë draft-rregullore po e shoh veç një propozim bazë të mirë për diskutim, mirëpo edhe formalisht edhe përmbajtësisht ka gjëra që do duhej të renditeshin ose të ndërtoheshin më mirë. Për shembull në nenin tre, i kemi objektet komunale publike në vështirësi të kësaj rregullore konsiderohen rrjeti tërësisht i ujësjellësit dhe kanalizimit me të gjitha pajisjet, rrugët, trotarët, sheshet. Hartuesi i rregullores mundet me, ose prezantuesi i rregullores mundet me na sqaru, Mirëpo nuk konsideroj që objekt komunal është rrjeti i tërësisht i infrastrukturës! E ujësjellësit mundet me qenë, infrastrukturë, rrjet, aset, por jo objekt komunal. Edhe për shkak të kompetencave të menaxhimit të ujit, po e konsiderojmë objekt komunal në një aset të hidroregjionit, për shembull në këtë rast. Kështu që si rregullore e kam lexuar, nëse ju mendoni që i keni votën me kalu, kaloni mirëpo kishte qenë mirë me diskutuar edhe ne përmes shefaave të grupeve parlamentare edhe me i dhënë ato vërejtjet e sugjerimet që janë. Edhe strukturalisht nuk është në rregull, e dinë, nenet nuk janë të renditura, nuk janë të shkruar ashtu konform formës qysh e kërkojnë hartimi i rregulloreve dhe udhëzimeve ose ligjeve. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit dikush tjetër. Në qoftë se dëshiron me e marrë fjalën. Po Faruk Tahiri.

Faruk Tahiri (LVV): Faleminderit kryesuese. Edhe unë desha diçka me folur rreth kësaj rregullore, edhe unë pashë që ka disa citate këtu që bien në kundërshtim me ligjin, me ligjet në fuqi. Edhe kjo rregullore si shumë rregullore që kanë ardhur në këtë kuvend, unë besoj që do të kthehet nga ministria për shkak të procedurave dhe shkelleve të ligjit. Unë nuk di pse deri më tash asnjë rregullore nuk kemi arritur ta kalojmë në përmbushje të komplet të ligjeve në fuqi. Po duket që çdo gjë që dojmë dhe kemi dëshirë apo që ballafaqohemi me probleme, mundohemi t'i vendosim rregullore dhe t'i zgjidhim si probleme pa u ndryshuar ligji për to. Për shembull, thuhet këtu për menaxhimi, rregullimi, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave në bashkëpronësi, vendosja e objekteve të përkohshme, tavolina, terasa, tendat, gjeneratorët statikë, pajisjet dhe është një nen 88.2 ku thotë hapësirat e jashtme të objekteve të banimit në bashkëpronësi, pavarësisht pronësisë

publike apo private, kushdo që i shfrytëzon këto hapësira për qëllime biznesi dhe qëllime të tjera duhet të pajiset me leje nga organet kompetente komunale, do të thotë për me realizuar një funksion të tillë. Unë këtu shoh që nuk, disa prej ndërtesave që të cilat as nuk kanë pranim teknik, as nuk kanë leje për ndërtim, por që janë përfunduar, nuk mundesh me i trajtuar ti si të mirëqena dhe t'i japësh leje atyre objekteve. Ata nuk i plotësojnë kriteret bazike që i kërkon ligji, që do të thotë të ketë një pranim teknik, të ketë një leje për ndërtim. Ne në këtë formë si po shkojmë me bërë lehtësira, kam frikë që nuk do të aplikon askush për ta legalizuar pronën të cilën e ka bërë të palegalizuar. Nëse dikush do me shfrytëzuar një lokal në një pronë, e cila nuk ka leje ndërtimi, nuk mund me shfrytëzuar pa u pajis me një leje ndërtimi. Përndryshe ne nuk kemi mundësi se si t'i regjistrojmë të gjithë këto pronat që janë të palegalizuara në komunën e Prizrenit. Prandaj ligji thotë që për ta bërë një leje në shfrytëzim, duhet të ketë pranim teknik. Dhe ne themi këtu, pa marrë parasysh pronën, publike apo private do të pajiset me leje, që është në kundërshtim faktikisht me ligjin. Ajo që dashta me me konsultuar pëlqimin në 88 paragrafi 88.1.4, pëlqimin ose kontratën me mbi 50% të pronarëve, ku përcaktohen obligimet e shfrytëzuesit të hapësirës ndaj pronarëve, hapësirat e brendshme. Do të thotë 50% e nënshkrimeve po, po sa përqind e hapësirës publike mund me shfrytëzuar? Për shembull, nëse një banesë apo një ndërtesë e përbashkët i ka shtatë kate apo tetë kate, ka diku 20 banesa, i merr nënshkrimin e 10 apo 11 familjarëve, kurse hapësirë të përbashkët kanë diku 200 m². Sa është përqindja që i lejohet me shfrytëzuar? A mund me shfrytëzuar komplet apo ka një përqindje të kufizimit për shfrytëzimin e asaj hapësire. Thotë, këtu nuk pashë që ka diçka të tillë, veç thotë me marrë një pëlqim prej 50% të banorëve aty dhe mjafton pastaj cilën hapësirë të don mundesh me e shfrytëzuar. Unë mendoj që duhet të vihet një kufizim edhe hapësirën publike duhet të lënë që edhe njerëzit që jetojnë aty, qytetarët që jetojnë aty ta shfrytëzojnë. Nuk mundemi 100% t'ia lëmë në shfrytëzim bizneseve apo kushdo që ka ndonjë aktivitet aty. Pra është mirë me kufizuar 20%shi, 30%shi, 40%shi apo sa keni menduar me lënë. Unë mendoj që rregulloret janë të mira edhe e lejojnë punën e zyrtarëve punën tonë, mirëpo duhet të kemi kujdes që këto rregullore mos të bijnë ndesh me ligjin dhe t'i bëjmë ashtu si duhet që të jenë funksionale dhe të qarta edhe për ata të cilët bëjnë kërkesë për me shfrytëzuar një pronë publike, por edhe për ata të cilët ë i japin në shfrytëzim pronën publike qytetarëve apo bizneseve kushdo që bën një kërkesë të tillë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Po t'i marrin njëherë anëtarët e Kuvendit apo doni me u përgjigj? Ti marrim njëherë fjalime të anëtarëve të Kuvendit, pastaj përgjigjet edhe zyrtari. Po Petrit Hoxhaj edhe Dafina.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit Kryesuese. Kam një pyetje, sa do të jetë në zbatim kjo rregullore dhe ju si inspektoriat në këto. A do, a keni me pasur problem gjatë zbatimit të kësaj rregullore sepse në disa pika, në disa fusha ka një far ndryshimi që bjen ndesh me gjendjen faktike që është tash do të thotë në komunën tonë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Dafina Alishani fjalën.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit unë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa i kam treguar shqetësimet e mia. Është shumë e mirëseardhur me pas rregullore, por kur ka rregullore të cilat i përzihen kompetencat e drejtorive përkatëse, atëherë mendoj që kjo është një iniciativë për

me u bë kaos më i thellë. Njëjtë edhe unë e kam, e kam ngritur si shqetësim sepse këtu po e shoh te neni i tretë që objektet komunale publike në vështrim të kësaj rregullore konsiderohen rrjeti i tërësisë me ujësjellësit me kanalizim. Me pas ndonjë shkelje, unë e di që këtu sa për ujë për kanalizim ose ujësjellës non stop dërgohemi në hidroregion. Tash ju po merrni kompetencat e hidroregionit këtu edhe unë e di që ka me pas problem qytetari kur ka me ardhur me kërkesa te ju, ju keni me orientuar prapë në hidroregion. edhe pse rregulloren e keni paraqitur si përgjegjësi. Pastaj e kam paraqitur edhe çështjen e terreneve sportive, prapë edhe këtu po e shoh të arsyeshme me e përsërit. Terrenet sportive edhe objektet sportive kulturore menaxhohen prej një bordi i cili është votuar në këtë kuvend. Tash nëse kemi ndonjë problem në atë terren sportiv, qytetari ka me pas të përzime kompetenca te kush me shkuar. Ju u arsuat që ne jemi ata që i monitorojmë, mos ka ndonjë prishje aty, mos ka ndonjë dëmtim aty, po terrenet sportive ose objektet komunale sportive edhe kulturore kanë staf teknik për këta që janë përgjegjës. Unë po e shoh këtu që janë dyfishim të përgjegjësi edhe ka me ndodhur e njëjta siç po ndodh me i sjellë qytetarët prej një drejtorie në drejtorinë tjetër ,e asnjë drejtori mos me marrë parasysh përgjegjësitë që i ka. Po ashtu, kështu një pyetje e kam për drejtorin, a qekjo rregullore ju paska munguar për me operuar ju si inspektoriat? Nëse qekjo rregullore juve po ju aktivizojke me dy duar po ju votoj. Po që tre vite ju arsyetoheni në rregullore të ndryshme a punë nuk po shohim. Unë po e them edhe po e shoh. Kjo rregullorja a ka me aktivizuar edhe inspektoriatin në respektimin e ligjit në zonën historike? A ka me aktivizuar edhe inspektora sanitar që nuk i shohim kërkah e që ka goxha shkelje nëpër të gjithë qytetin? A ka me pasur inspektime? A është mungesa e vetme e suksesit të inspektoriatit kjo rregullore apo kemi me pas edhe ndonjë rregullore tjetër me arsyetimin që s'po mujmë me operu se s'kemi rregullore. Ju i keni ligjet për me operu por nuk po operoni. Keni gjetur tash me prodhuar rregullore, hajde ta shohim çka ka me ndryshuar kjo rregullore. Ju kam thënë disa herë edhe tash po ju them, për rregullore, strategji, memorandume plot, në praktikë jemi zero. Faleminderit, dikush tjetër prej anëtarëve të Kuvendit?Në qoftë se nuk ka, atëherë përsëri po ja kalojmë fjalën zyrtarit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Dikush tjetër prej anëtarëve të kuvendit? Në qoftëse nuk ka, atëherë përsëri po ja kalojmë fjalën zyrtarit.

Rrahim Destani (Kryesues i Komisionit): Faleminderit kryesuese.

Dafina Alishani (LVV): Veç edhe diçka kam harruar me përmend. Reklamat, kam harruar me i asi. Këtu në qytet ka reklama ndriçuese të cilat janë të operatorëve ekonomikë privat. Si ka mundësi tash a keni me i pasur kontrollimin edhe atyre apo tash e mas çfarë bëhen këto reklama? Sepse këtu te neni tre janë edhe panot ndriçues, pajisjet, po mendoj tabelat për shpallje dhe panot ndriçuese reklamat. Cilat janë ato panot për shpallje?

Rrahim Destani (Kryesues i Komisionit): Faleminderit. Sa i përket cilësisë së ujit që ishte në fillim si shqetësim. Cilësinë e ujit, inspektorati komunal nuk e bën, e bën inspektorati sanitar me kompetencat që i ka. Inspektorati sanitar, nuk është në kompetencën e komunës fare, domethënë prej vitit 2022 janë në agjensi të ushqimit të veterinarisë. Te shqetësimi për hapësirat e përbashkëta. Unë mendoj se rregullorja trajton aspektin legal në bazë të ligjit, përndryshe objektet që nuk janë legale ne nuk mund me i trajtuar. Janë të rregulluar me ligj. Te shfrytëzimi i hapësirave publike ku

është pasur shqetësimin ish-drejtori Bujar Hasani. Do të thotë ka qenë një rregullore e pashkruar me një me fakt. Gjashtë gjashtë muaj janë pajisur me leje gjashtë muaj jo. Tash është caktuar me kërkesën edhe të bizneseve që ka kërkuar 50% më lirë me u paguar gjatë sezonit të dimrit. Domethënë në shtator-prill ë 50% më lirë në krahasim me rregulloren për taksa, tarifa dhe ngarkesa, qysh e ka paraparë. Reklama dhe të gjitha të tjera që janë të vendosura në hapësira publike që i trajton rregullorja për shërbime publike dhe komunale, do të inspektohen nga inspektorati komunal. Edhe një sqarim, inspektorati komunal përpos ligjit për inspektime, ligjit të procedurës administrative, punon me rregullore dhe vendime të Kuvendit Komunal. Domethënë baza, ligjet bazike janë ligji për inspektorat dhe ligji për procedurën e përgjithshme administrative që e japin kompetencë inspektoratit komunal me punuar. Të gjitha këto i kemi punuar deri më tani në bazë të vendimit komunal për rregullimin e qyteteve dhe shërbimeve komunale, vetëm se ligji për kundërvajtje dhe ligjet e tjera kanë filluar me e bërë pak të pazbatueshëm këtë vendim, prandaj është qenë e detyrueshme me u ripërpunuar dhe me u nxjerrë një rregullore e re që inspektorati komunal në nivel të komunës së Prizrenit, me funksionuar si inspektorat normal. Faleminderit.

Bujar Hasani (I pavarur): Të jemi të qartë. Thashë unë që nga fillimi, domethënë që nga viti 2001 është bërë rregullorja për shfrytëzimin e hapësirës publike. Unë nuk besoj që bizneset kanë kërkuar që gjashtë muaj sepse ajo është gjashtë muaj, parashihet pagesa për gjashtë muaj, duke mos ja zbritur asnjë ditë kur është ditë që s'mund ta shfrytëzojnë hapësirës publike. S'munden me shfrytëzuar, domethënë operatorët ekonomikë nuk munden me shfrytëzuar hapësirën publike. Dhe deri tash kanë paguar në bazë të ligjit për shfrytëzimin, domethënë ligji që e parasheh, por edhe rregullorja që ka pas paraparë, domethënë që nga 1 prilli deri më 30 shtator. Domethënë ka qenë e paraparë. Është e vërtetë që ajo ka qenë tavolinat dhe karrikat nuk është bërë presion ndaj operatorëve ekonomik për ti larguar gjatë sezonit të dimrit. Në qoftë se operatorët ekonomikë paskën bërë kërkesë që gjatë sezonit të dimrit me i larguar tavolinat dhe karrikat, me i transferuar në një vend tjetër dhe pastaj gjatë sezonit me i pru prapë, kjo qenka risi për mua. Mirëpo unë mendoj që aty po e bëjmë një ngarkesë ndaj operatorëve ekonomikë, shpenzime të kota, të cilat shpenzime janë të paarsyeshme. Domethënë nuk ka ndonjë arsye sepse ajo hapësirë publike nuk shfrytëzohet gjatë dimrit nga qytetarët apo nga kushdo tjetër subjekt, nuk shfrytëzohet. Ajo është hapësirë e cila është e dedikuar për ato lokale. Flasim konkret, domethënë, flasim konkret. Sa i përket kësaj kanalizimit të ujit. Jo tash, por që në vitin 2001, komuna, të gjitha ujësjellësat, kanalizimet që i kanë ndërtuar dhe që i ndërton tash, në mënyrë automatike e ka bërë të drejtën e pronësisë hidroregjionit, që domethënë është pronar i këtyre aseteve, kanalizimit dhe ujësjellësit, domethënë është hidroregjioni. Dhe kyçja dhe kyçja për në këto rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit duhet të merret pëlqimi nga hidroregjioni, jo nga inspektorati. Inspektorati e bën inspektimin në qoftë se dikush kyqet apo nuk kyqet në mënyrë legale apo ilegale, domethënë ka leje apo nuk ka leje, prandaj t'i bëjmë këto dallime. Unë këtu e kam theksin, nuk e pata për atë arsye. Ekzistojnë ligjet, bëhet, veprohet në bazë të ligjit edhe nuk e di spe rregullore tjetër që duhet me u paraparë rregullore tjetër kur ekziston ligji. Shumë kjartë është ligji, i parasheh, të gjitha i parasheh. Faleminderit. Unë i ftoj opozitën që të këtë propozim mos ta votojnë. Pozita le ta bartë atë përgjegjësinë e vet, i ka votat edhe nuk ka problem. Faleminderit.

Rrahim Destani (Kryesues i Komisionit): Vetëm për një sqarim. Drejtoria e Urbanizimit lëshon leje, hidroregjioni jugor jep pëlqime. Vetëm me sqaruar te kyçja në rrjetin ujësjellësit dhe të

kanalizimit. Çdo vend ku prehet asfalti, trotuari dhe krejt këto Drejtoria për Urbanizimin, këtu e përfshin dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike që e kemi drejtorin këtu që e dinë shumë mirë që pëlqimet i lëshojnë Drejtoria e Shërbimeve Publike varësisht prej territorit ku janë për me plotësuar lëndën për mu u nxjerr leja për kyqjen në rrjetin publik të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Bujar Hasani (I pavarur): Drejtoria e urbanizimit jep leje. Po kërkesa bëhet në Drejtorinë e Urbanizimit ajo e orienton pëlqimin në hidroregjion, hidroregjioni jep pëlqimin, pastaj Drejtoria e Urbanizimit të jep lejen për kyqje. Domethënë është e kuartë kjo, nuk ka këtu. Prandaj kjo është. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Faruku e ka fjalën edhe Karanfili pastaj. Edhe pse për here të dytë, port ë lutem sa më shkurtë.

Faruk Tahiri (LVV): Po veç shkurt se nuk mora përgjigje për pjesën e hapësirës publike, sa përqind mund me shfrytëzuar. Domethënë, nëse 50% i duhet me marrë nënshkrime për me ja dhënë lejen për me shfrytëzuar, sa përqind i asaj hapësire publike lejohet me shfrytëzuar, këtu nuk ke.

Rrahim Destani (Kryesues i Komisionit): Kjo përgjigje është kur bëhet aplikimi për pajisje me leje, drejtoria për urbanizëm i kanë projektet dhe në bazë të projekteve vlerësojnë shfrytëzueshmërinë e hapësirës në këto vende ku e kemi diskutu.

Dafina Alishani (LVV): çfarë projekti ka urbanizmi që vendos sa përqindshin e hapësirave mundet me, a ka ndonjë rregullore? Sipas çkafit e jep atë leje? A jeni të vetëdijshëm çfarë informate jeni duke na dhënë? Një banesë kolektive e ka një hapësirë gjelbëruese, sipas çkafit i jepet leja për shfrytëzim një operatori ekonomik edhe sa përqind. Ku ka, ku ka projekt urbanizmi për me vendosur këtë? A ka? Pse, pse po na dezinformoni kështu? A ka projekt urbanizmi që e ka parasysh sa përqindshin e hapësirës me dhënë leje? Jeni në kuvend komunal, mosni ju lutem.

Rrahim Destani (Kryesues i Komisionit): E nderuar kuvendare, po më duket se unë e shpjegova kuartë. Ai kërkoj për objekte banesore. Këtu jemi të folur për hapësira publike gjelbëruese. Të gjitha hapësirat publike gjelbëruese vendos Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po drejtor urdhëro, pastaj edhe Karanfili.

Çelë Lamaj (Drejtor DSHP): Faleminderit Kryesuese. Një sqarim. Në të bazë ligjeve në fuqi, sipërfaqet e gjelbëruar janë të ndaluara me ligj të jepet për asnjë shfrytëzim përveç hapësirë gjelbëruese, quhet hapësirë gjelbëruese. Edhe unë mendoj, edhe pse ndoshta prej kësaj pozitës time, nuk ka mundësi banorët me përcaktuar një hapësirë gjelbëruese se kujt duhet me i dhënë 50%. I jep dikujt 50%, edhe çfarë ndodhet 50%-shi tjetër duhet ta vuajë atë. Drejtoria e Shërbimeve Publike në bazë të ligjeve që i ka në fuqi, nuk jep asnjë pëlqim. Drejtoria e Urbanizmit mundet me çuar një kërkesë të ne për pëlqim, por ne nuk japim pëlqim në hapësira gjelbëruese për me ushtruar asnjë veprimtari në këtë rast, as vendosjen e tavolinave apo karrigrave.

Dafina Alishani (LVV): Më falni, më falni, po pikërisht kjo ka me ndodhur. Ky ka me thënë s'është kompetencë e jona, urbanizmi thotë s'është kompetence e jona. Çfarë bëhet? Mbetet qytetari, sorollatët nëpër zyrë edhe nuk ka ku paraqet ankesën për shkak që ki mbi veprime mes neneve edhe përgjegjësive. Bash këtë shqetësim unë e kam. Edhe nuk qysh po thoni ka urbanizmi projekt qysh i jep hapësirat publike.

Çelë Lamaj (Drejtore DSHP): Mundet me pas me plan rregullues, mundet me pas me plan rregullues ose plan detal urbanistik mundet me pas sipërfaqe të pllakosura ku sikur Shadërvanin, se pengon kurrkush me dhënë se është hapësirë publike, por nuk është zonë e gjelbëruar. Unë po them brenda zonave të gjelbërta nuk jepet.

Dafina Alishani (LVV): Kolegu shumë mirë e sqaroi në objekte ku ka banim kolektiv. Ne e kemi një kaos, ka aksione, s'është mirë me i dhënë hiç, po ju po i legalizoni me me rregullore. Ju e keni shkruajtur, po që tash, urbanizmi. Ku është urbanizmi me u përgjigjur? S'ka. Pikërisht kjo ka me ndodhur tek qytetarët. Një qytetar ka musolla prej zyrës në zyrë për shkak që drejtoritë kanë me thënë s'është përgjegjësia ime, s'është e imja, në fund shkon ai detyrohet me bë jashtëligjshëm ndonjë veprim për shkak që asnjë drejtori nuk e merr përgjegjësinë. Pikërisht që kjo rregullore e bën këtë kaosin që unë e thashë edhe në Komitet për Politikë dhe Financa.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Karanfil Haxhillari, fjalën e ka.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesuese. Këtu po vijmë në një situatë të cilën mbi përshkrimi i përgjegjësive, pastaj ndërhyrja e kompetencave nga dikush në dikush tjetër dhe renditja e neve të cilët me të vërtetë lënë për të dëshiruar. Unë, neve po e kuptojmë që kemi nevojë për një rregullore sepse qysh nga 2004 është një rregullore tjetër edhe nuk jemi absolutisht kundër rregulloreve. Por tash këtu na shtini në lajthitje neve si opozitë dhe lashuk na nxjerr gojën kur të na kthehet prapë. Po po. Sepse neve e votojmë këtë rregullore, edhe t'i shohim dhe domi përmes rregulloreve që t'ju mbajmë përgjegjës edhe juve si inspektoriat, se punën a do ta kryeni sipas kësaj rregullore. Shumë okej. Por ama kjo rregullore, unë jam i sigurtë që do të na kthehet prapë që në seancën tjetër të bëjmë ndryshime, rregullime të neve dhe prapë na bie që edhe opozita po e voton një rregullore të cilën po është e jashtëligjshme.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, Islam Thaçi fjalën edhe pastaj Haziz Hodaj.

Islam Thaqi (LVV): Faleminderit Kryesuese. Po mendoj se fillimisht desha me diskutuar këtë pjesën juridike apo preambulën juridike në nalt. Mendoj se rregullorja, atë që unë e kam vërejtur që ka mangësi është gërshetimi apo futja e neve të caktuar nga ligji për inspektoratin, për inspektime mjedisore dhe hapësinore. Meqënëse e di që ka disa nene që mund të ishin futur këtu e që inspektorat komunal apo inspektorat të shërbimeve publike do t'i kryejte punë. E dyta kjo rregullore qëllimin kryesor meqënëse pak a shumë Rrahimi u mundua ta elaboroj, do t'i shërbejë vetëm dikasterit ku Rrahimi është te udhëheq. Do do t'i shërbejë dikasterit të shërbimeve publike apo inspektorëve komunalë si i quajmë ne. A ka qenë e nevojshme apo a është e nevojshme një rregullore e tillë? Unë mendoj se po. e di që ka pasur nisma edhe në mandatin e kaluar, por edhe më herët që pikërisht në disa nene të statutit të komunës të ndërhyhet për shkak që inspektorët në

fjalë karshi shqiptimit të gjobave mandatore nesër kur dilet në në në terren t'i kenë duart juridikisht më të lira në shqiptimin e gjobave edhe që mund t'i inkasojnë ato gjoba si dikaster. Vërejtja ime Rrahim është që në këtë rregullore nuk keni future nene apo prembula nga ligji për inspektim dhe për inspektim mjedisi dhe planifikimit hapësinor. E di që ka disa nene që keni mund me i fut këtu, e që si rregullore do të ishte më e kompletuar. Do të thotë për të gjithë kolegët kuvendarë, inspektorët inspektojnë lejet, por nuk i lëshojnë lejet dhe këtu është thënë një farë ngatërresë të debatit që po bëhet.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Haziz Hodaj fjalën e ka.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit shumë. Unë sinjerisht nuk e pata mend me biseduar rreth kësaj rregullore se e kam lexuar edhe jemi konsultuar edhe me zyrtarët që e kanë, që e prezantuan, që është një rregullore që është e domosdoshme ta ketë qyteti i Prizrenit. Sigurisht se nuk është më perfektja, sigurisht se ka vërejtje, sigurisht se do të ketë vërejtje edhe në të ardhmen. Mirëpo këtu ne në mënyrë hipotetike nuk mund t'i parashohim gjërat që kanë me ndodhë, ka mu dhënë ose nuk ka mu dhënë. Nëse jepet hapësira e gjelbërt si e shfrytëzuar, atëherë është shkelje e ligjit, jo dihet shkurt edhe shqip. Ne jemi në kuvend prapë edhe do të jemi, do ta përcjellim punën edhe të inspektoratit, edhe të drejtorive përkatëse. Mirëpo me thënë tash që ka me ndodhur kjo apo ka me ndodhur ajo, është hipotezë, me hipoteza është problem të marrim vendime. Kështu që ne do ta votojmë këtë rregullore. Sigurisht që i kemi vërejtjet tona dhe dor ti përcjellim në ndërkohë, por nuk domethënë që se asnjë rregullore, asnjë vendim që e kemi nxjerrë këtu që e kanë nxjerrë të gjitha forumet, qoftë parlamenti i Kosovës, qoftë parlamente të tjera, nuk i vjen tamam krejt njerëzve. Sigurisht se ka vërejtje, ka sugjerime, ka vend edhe për ndërhyrje, po është mirë që ne mund të ndërhyjmë edhe më vonë në këto rregullore dhe mund t'i evitojmë defektet. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Urdhëro Rrahim.

Rrahim Destani (Kryesues i Komisionit): Ta sqaroj më herët drejtori Islam, te ish drejtori. Prej nenit 37 deri 54 është kompetenca është kompetencat e inspektorit të mjedisit përgjithësisht që ata ai ka dhe me ligj për mbrojtje të mjedisit, lejet mjedisore komunale, ligji për zhurmën e krejt ato i ka.

Islam Thaqi (LVV): Rrahim su kuptuam. Unë thashë veç preambula juridike naltë, te hyrja e rregullores. Se poshtë e kam lexuar.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Atëherë në qoftë se nuk ka dhe dikush tjetër.

Faruk Tahiri (LVV): Jo mos mos të keqkuptohemi për hapësinat gjelbrune as unë se pata qëllimin, po janë disa hapësira afër banesave ku shfrytëzohen, e shfrytëzon komplet komuniteti. Jo be parqet nuk janë parqet. Po në rregull, do të thotë veç me u caktu me u përcaktuar përqindja. Për shembull nëse i ka 50 m2, hapësirë të përbashkët, 20%-shin e qetij 50 m2 mundet me shfrytëzuar. Se ka afër në banesa kolektive ka edhe kate të para që janë dhënë për shfrytëzim të lokaleve. Ta kemi mundësi me propozuar që në momentin që mirret një nënshkrim, momentin që mirret nënshkrimi

për 50%, kështu po thotë rregullorja. Rregullorja po thotë nëse me 50% të nënshkrimeve të banorëve?

Rrahim Destani (Kryesues i Komisionit): Ai ka me plotësuar një kriter për pajisje me leje.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Atëherë prezent jemi 25 anëtarë po e hedhin votim. Kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës?

Karanfil Haxhillari (LVV): Veç le të dihet që prapë opozita po e voton këtë rregullore, sepse pozita nuk është këtu, veç katër vetë janë prej pozitës.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): 22 jemi për. Kush është kundër? Ju lutem jemi në proces të votimit. Kush është kundër? 1 kundër. Abstenim? zero abstenim. Miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Ju falenderoj të gjithëve. Kalojmë te pika e shtatë.

Pika e shtatë:

Miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimeve sipas rekomandimeve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po drejtori do ta ketë fjalën në lidhje me këto 13 vendime.

Çelë Lamaj (Drejtor i DSHP): Faleminderit Kryesuese. Me datën 11 janar na ka ardhur një kërkesë prej Institutit për Mbrojtjen e Natyrës, për 13 objekte të natyrës për me u fut në mbrojtje. Kjo ka qenë kërkesë e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Pasi që Asambleja Komunale e ka miratuar, Ministria përkatëse e Administrimit të Pushtetit Lokal e ka kthyer për shkak që nuk janë përcjellë procedurat! Për mua është e pakuptueshme sepse sipas tyre thotë është anashkaluar një hap ligjor i procedurës pasi që paraprakisht është dashur të mirret një pëlqim nga ministria përkatëse! Domethënë ministria edhe bënë kërkesë, ministria vetë, institucioni vetë bënë kërkesë për me u futë si monument të njëjtën kohë thotë s'keni lyp pëlqim, këtë nuk kena mujtë me e kuptu. Sipas zyrtarit të ministrisë sipas të cilit herën e kaluar ka qenë këtu dhe është prezantuar ky projekt me kalu nëpër organet e Kuvendit, thotë, po them gjithmonë, sipas zyrtarit nga ministrisë i cili është marrë me këtë çështje, e njëjta procedurë është përcjellë edhe nëpër komuna të tjera edhe është kthyer ligjshmëria, veç në Prizren nuk kthehet, nuk e di pse! Prandaj kërkohet që të anulohet edhe të fillojnë procedurat e reja për këtë akt.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor. A dëshiron me marrë fjalën dikush në lidhje me këtë pikë? Po, Dafinë urdhëro.

Dafina Alishani (LVV): Ne e kemi votuar për shkak që atë ditë ka qenë prezent edhe një përfaqësues nga ministria dhe gjithçka ka qenë në rregull. Tash, çfarë ndodh tash me këtë shfuqizim edhe çfarë ndodh me këto, a duhet ministria me i bë apo?

Çelë Lamaj (Drejtor i DSHP): Jo, tani ne si komunë duhet me ju drejtuar ministrisë. Qatë kërkesën e juaj apo na jepni pëlqim? Kjo është diçka që unë s'jam kah muj e kuptoj. Domethënë

vetë institucioni kërkon me fut si asete nën mbrojtje edhe vetë thotë, keni anashkaluar procedurat se keni vyet, ne me pas pasur si kërkesë, gjithçka është në rregull. Tash ne duhet edhe njëherë me u taku me ta, me bë një kërkesë në ministri apo na jepni pëlqim me i fut këto? Edhe në një pikë tjetër, seancën e ardhshme do ta procedojmë.

Dafina Alishani (LVV): Domethënë përsëri do të vijë si rend dite për me u votuar në kuvend. Okej.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Atëherë po e hedhim në votim edhe këtë pikë. Prezent jemi 23 anëtarë. Kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Unanimisht me sa po e shoh. Ju faleminderit të gjithëve. Kalojmë te pika e tetë.

Pika e tetë:

Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit të punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës 2024-2026.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po drejtori e ka fjalën. Ju lutem a ka mundësi për pak qetësi? Drejtori e ka fjalën. Ju kisha lutë të nderuar kolegë kuvendarë.

Rasim Demiri (Drejtor i DPMS): E nderuara Kryesuese, i nderuari Nënkrjetar Gashi, të nderuar drejtorë, të nderuar asambleistë, të nderuar të pranishëm, të nderuara media. Në emër të Kryetarit të Komunës zoti Shaqir Totaj dhe Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i jemi mirënjohëse ekipit për të drejtat e fëmijës, Nevo Konceptit dhe Save dhe Children, grupit punues, drejtorive komunale për kontributin dhe angazhimin në hartimin e planit të punës për ekipin për të drejtat e fëmijëve në Prizren. Faleminderit Nevo Konceptit për punën dhe angazhimin që më në fund Prizreni ta ketë planin e punës për ekipin për të drejtat e fëmijëve. Patjetër që dua të falenderoj secilin për kontributin e dhënë. Faleminderit grupit punues që kanë qenë të gatshëm të përgjigjen takimeve tona dhe të na jepet hapësira e duhur që të bëjmë më të mirën në këtë dokument. Qëllimi është që kuadër të komunës së Prizrenit, përkushtimi ynë qëndron në nxitjen e një mjedisi të sigurtë dhe edukues për fëmijët. Nëpërmjet zbatimit të planit të veprimit për t'i drejtat e fëmijëve, objektivi ynë parësor është të kultivojmë ndërgjegjësimin në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe të trajtojmë në mënyrë proaktive sfidat që fëmijët hasin në jetën e tyre të përditshme. Për më shumë ne jemi të vendosur për ta luftuar dhunën dhe abuzimin ndaj fëmijëve duke adoptuar një qëndrim dhe reagim institucional me zero tolerancë ndaj çdo forme të keqtrajtimit. Nëpërmjet fushatave, ne synojmë të ndërhyjmë menjëherë dhe të ofrojmë ndihmë dhe mbrojtje për fëmijët që përballen me vështirësi të tilla. Objektivat, masat dhe veprimet që shërbejnë si udhëzime në fazën e zbatimit të planit të punës. Shërbimet cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët, vetëdijësim dhe avokim për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, hapësirat e sigurt dhe miqësore për fëmijë, aktivitete sportive, kulturore, edukative, lojëra dhe rekreative për fëmijë, pjesëmarrja e fëmijëve, implementimi, monitorimi, vlerësimi dhe raportimi. Ju faleminderit për vëmendjen tuaja.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit drejtor shumë. Dikush prej anëtarëve të Kuvendit, në qoftë se dëshiron me e marrë fjalën rreth këtij drafti? Në qoftë se jo, atëherë po e hedhim menjëherë në votim. Po Dafina Alishani.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit. Unë veç desha me e shpreh indinjatën time rreth një komentimi apo reagimi të një kolege tonën, e cila na ka sulmuar si opozitë që ne nuk jemi për përkrahjen e këtij plani. Ne e kemi sqaruar që lirimi i sallës ka qenë mu për arsye të mos përgjegjësisë së ekzekutivit, nuk kemi asgjë kundër fëmijëve dhe planit të punës për fëmijët. Nuk është mirë me krijuar armiqësi përmes postimeve dhe me vë në lajthitje personat, sepse ne ishim të gjithë si opozitë të pajtimit që ky plan të hyjë në rend të ditës, pavarësisht që ka ardhur në ditën e KPF-së edhe ishim të mendimit që me 1 qershor, para 1 qershorit të votohet. Para se të thirret përgjegjësi ndaj kolegëve, mendoj që mirë është edhe pozita me i ftuar edhe për përgjegjësi ekzekutivin edhe me qenë prezent këtu e mos me ju gjuajtur opozitës pa nevojë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Atëherë po e hedhi në votim këtë pikë, pra pikën e tetë. Prezent jemi 22 anëtarë të Kuvendit, kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Unanimisht ju faleminderit shumë. Po kalojmë te pika e radhës.

Pika e nëntë:

Informatë rreth raportit të punës së Zyrës-njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore për vitin 2023.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Zonja Mybexhele fjalën e ka.

Mybezhele Zhuri: (Udhëheqëse e NDNJBGGJ): Faleminderit zonja Kryesuese. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Ju të gjithë keni pranuar një informatë për raportin tim vjetor në formë tabelare, ku janë ofruar informata orientuese për sferat që i mbuloj, që nuk janë më pak se pesë të tilla. Vetëm për njoftim, unë përpos që raportoj në vijë vertikale fillimisht dhe mbështetem nga Drejtori i Drejtorisë së Administratës, e vendosur sipas organogramit komunal dhe përmes tij tek Kryetari i Komunës. Unë vazhdimisht në vijë horizontale raportoj në Agjencionin për Barazi Gjinore Ministrinë e Pushtetit Lokal, Zyrës për Qeverisje të Mirë, komisionerit për përdorim gjuhëve në cilësinë e kontakt personit për përdorimin e gjuhëve. Nevoja për fuqizimin e njësisë vazhdon të jetë aktuale sepse siç e dini njësia ende përbëhet vetëm nga një zyrtar. Si udhëheqëse e njësisë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore kam me të shumta e në rend të parë të siguroj rekomandime dhe këshilla profesionale për Kryetarin e Komunës, drejtorët komunalë me qëllim të promovimit dhe integritit gjinor dhe të drejtave të njeriut në të gjitha politikat, programet dhe aktivitetet e institucionit komunal që rregullisht e kam kryer përmes pjesëmarrjes aktive me sugjerime konkrete për bartësit e politikave apo projektet konkrete përmes punës, nëpërmes grupeve punuese gjatë hartimeve të politikave komunale siç janë planet strategjike dhe rregullore që nuk kanë qenë të pakta. Po më duhet të theksoj se i jap theks të veçantë barazisë dhe promovimit të saj, si dhe respektimit dhe promovimit të drejtave të njeriut, se është obligimi i të gjithëve. Në bashkëpunim me të gjithë akterët përgjegjës, duke filluar prej kryetarit, drejtorëve, juve kuvendarëve, të cilët keni të drejtën e votës edhe për t'i ngritur dhe votuar çështjet e të drejtave të njeriut dhe politikat dhe programet përmes të cilat ato edhe realizohen. Ju njoftoj që nga viti i kaluar në bashkëpunim me organizatën ndërkombëtare Un Women, në bashkëpunim me Agjencionin për Barazi Gjinore, kemi filluar me implementimin e buxhetimit gjinor me analiza gjinore, së pari në Drejtorinë e Kulturës, për të vazhduar me Drejtorinë e Bujqësisë dhe ku përmes

hazit të parë që është analiza gjinore, në bazë të gjeturave të analizës kemi nxjerrë rekomandime dhe objektivat dhe janë inkorporuar dhe disa të tjera që do të inkorporohen në kornizën afatmesme buxhetore, që do të thotë përfshirja e nevojave të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në këto dy fusha. Pastaj kam dhënë kontributin gjatë hartimit të planit tre vjeçar për banim social, duke kërkuar normalisht të përfshihen integrimi i çështjeve gjinore, rastet sociale dhe gratë vetë ushqyese apo gratë viktime të dhunës në familje. Kam qenë pjesë edhe e ekipit për të drejtat e fëmijëve që pak më herët e dëgjuam prezantimin e planit të njëjtës, si dhe funksionimin e mekanizmit komunal kundër dhunës në familje. Gjithashtu vitin e kaluar me vendim të kryetarit u formua grupi punues për hartimin e planit komunal për barazi gjinore, që për qëllim ka integrimin gjinor në të gjitha fushat e politikave gjinore. Këtë vit ky draft-plan u hartua dhe u mbajtë javën e kaluar edhe konsultimi publik dhe së shpejti vjen në kuvend për shqyrtim dhe miratim. Pak kisha ndaluar edhe tek korniza fatëmesme buxhetore, për t'ju informuar se pas analizës gjinore dhe ndryshimet tek i njëjti, kemi bërë përfshirjen e aspektit gjinor, mundem me ju lexuar pjesët sepse pak është edhe korniza pak më e gjatë, po nëse keni lexuar me vëmendje, keni me parë se janë bërë ndryshime në aspekt gjinor. Pas analizës gjinore në Drejtorinë e Kulturës, vitin e kaluar gjithashtu i kemi shtuar disa objektiva dhe tregues që do të na ndihmojnë të masim realizimin e planifikuar sepse kjo është edhe kërkesë e programit të Kosovës për Barazi Gjinore. Mundem me ju i lexuar vetëm këto pjesë. Apo e keni lexuar ndoshta vetë nëse s'doni me, vetëm objektivat specifike të cilat janë paraparë dhe të njëjtat mbas analizës gjinore që e kemi bërë edhe në Drejtorinë e Bujqësisë, do të inkorporohen në KAB dhe në vazhdimësi do të pëson ndryshime. Do të jetë organi monitorues apo mekanizmi monitorues i cili ka me i monitoruar këto ndryshime dhe realizimin e objektivave apo treguesve të cilat janë të përfshira në kornizën e afatmesme buxhetore. Nëse keni ndonjë pyetje, jam e gatshme se janë sfera goxha të gjëra, të gjitha kanë ligjet e veta, strategjitë e veta që një njeri duhet me i ditur edhe gjithkua nga pak me kontribuar. Aq sa po më jepet mundësia, jam munduar me e bërë më të mirën e mundshme.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zonja Zhuri. Mundeni me u ulur këtu te pjesa e parë që mos qëndroni në këmbë. Në qoftë se ka eventualisht ndonjë pyetje. Kush dëshiron me e marrë fjalën? Po Petrit Hoxhaj.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese. E kam lexuar me vëmendje dhe të përgëzoj për të gjithë këtë vullnet dhe këtë punë të cilën po e bënë për të drejtën e barazisë gjinore. Mirëpo shqetësimi im ka të bëjë më shumë me mosprezencën e asamblesë së pushtetit, të cilët ne po detyrohemi me ja bërë numrat dhe ata vetë nuk janë në seancë dhe çka është, çka është tjetra është që derisa ne flasim për barazi gjinore, ndërsa pjesa e gjinisë femërore nuk është në seancë. Kjo është një mos respekt ndaj ndaj kësaj, ndaj këtij rendit të pikës. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Dafina Alishani, Selman Sokolaj.

Dafina Alishani (LVV): E nderuara zonja Zhuri, ju keni qenë shumë të zëshëm në secilën qeverisje në aspekt të pjesëmarrjes së zyrës suaj si në mbledhjet e ekzekutivit, si në çështje të cilat i keni rekomanduar, por asnjëherë nuk na thoni se si ju qaset ekzekutivi i Shaqir Totaj edhe vetë Shaqir Totaj. Ju nëpër forume të brendshme po ankoheni shumë, por në kuvend këtu nuk e përmendët që në bordin e drejtorëve nuk jeni të ftuar. Pastaj nuk e përmendët ose nuk e përmendët

se çfarë keni bërë për premtimin që është dhënë 50-50. A nuk po ju pengon hiç me parë kaq shumë burra në ekzekutiv, kaq pak gra në ekzekutiv. Pastaj këtu i keni paraqitur kjo raport nuk është, kjo është një raportim i axhendave të juaja, të cilat keni marrë pjesëmarrje. Këtu i keni ndarë domethënë tabelën, iniciativat, qëllimi i aktivitetit, përkrahja, data e fillimit, te rezultati e keni shkruar që janë bërë trajnimet edhe janë bërë vizita. Çfarë keni arritur me këto trajnime, me këto vizita, është dashur këtu me u paraqitur si rezultat. Këtu, domethënë ju e keni bërë, rezultati është kërkesë për regjistrimin e të dy gjinive në pronësi, kjo është kërkesë e kahmotshme. Na është dashur si komunë me pas rezultate dhe me pas statistika se sa është numri, a është rritur apo është zvogëluar. Dhe nëse s'ka ndonjë rritje, çka duhemi me bë ne si komunë. E jo këtu me paraqitë që keni shkruar në trajnime. Ajo është përditshmëria e juaj që ju doni me bë si zyrtare, po çka po arrijmë me këto trajnime? Pastaj, mospërmendja e grupit joformal të grave është për mua me të ardhur keq. Ne po diskriminohe mi prej Zyrës për Barazi Gjinore. Skanimi këtu për çështjen e kancerit është bërë bashkë me asamblistët. Edhe nëse ne anashkalohe mi prej Zyrës për Barazi Gjinore, vërtetë kemi shumë punë për të bërë. Është për të ardhur keq qysh 13 asambleiste këtu, as nuk përmendën, vazhdimisht ju bëjmë thirrje për bashkëpunim, vazhdimisht ju bëjmë thirrje për përkrahje. Është për të ardhur keq kjo mos me u përmend, kur e di që iniciativa ka qenë enkas e grupit tonë edhe jemi munduar, më shumë janë munduar edhe Egzona, edhe zonja Ymran, e mos me u përmend këtu bashkëpunimi mua po më vjen keq. A keni folur ndonjëherë me kryetarin me thënë, kryetar ke pasur premtim për 50% me pas ekzekutivin gra, ku janë ato gra drejtoresha. Edhe ngacmimet nëpër shkollë, ne e kemi ngritur si shqetësim, asnjë reagim nuk e keni bërë si zyrtare? A jeni marrë me këto shqetësime? A keni diskutuar me drejtoreshën pse po mbulohen këto ngacmime seksuale? Unë jam tepër kundër çështjet gjinore me ja lënë vetëm një zyrës. Po edhe ajo zyre duhet me pasur bashkëpunim me ata që e kanë njëmend përkushtim me bërë çështjen e barazisë gjinore në nivel, me e ngritur në komunë. Andaj po më vjen shumë keq, por çdo vit ne i kemi kështu lloj raportime që mu për këtë qasje që e bëni edhe ju, edhe ekzekutivi, e kemi këtë mungesë të asambleistëve se më kjo punë është bërë hajgare. Është hera e tretë që vjen këtu në raportim, mungesat që nuk mundeni me ardhë, tash e di që keni me arsyetuar që jeni vetë, e di që jeni arsyetuar, për shembull vitin e kaluar keni pasur premtim këtu që keni me pas asistent. A ju ka siguruar asistent kryetari? Jo. Pse s'keni ardhur këtu me na informuar këtu neve asambleistëve ose pse s'e keni bërë si kërkesë me ju me ju bërë, ne vazhdimisht me bërë këtë kërkesë. Çështja gjinore nuk duhet të jetë çështje e cila diskutohet një herë në vit. Edhe ato me zor po diskutohet, se është hera e tretë që po vjen në rend të ditës. Mua po më vjen shumë keq, po nuk mundem me heshtur karshi këtyre papërgjegjësive që po ndodhin, qoftë me kastë, qoftë pa kastë. Dilni edhe akuzoni qysh i keni akuzuar qeverisjet e kaluara, dilni thuani kryetari s'po më fton mua, as s'po më vetë, pse s'po dilni? Kur çështjet gjinore janë pa dallim partie, është dashur me pasë senzitivitetin e njëjtë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Selman Sokolaj, fjalën.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit Kryesuese. Unë deshta me pyetë zonjën. Kemi pasur një keqtrajtim ose një presion të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, edhe shefit të kabinetit, të paktën ashtu është raportuar në media dhe zoti Totaj, e ka pranuar në Kallxo.com, që ka pas një konflikt verbal me zyrtaren e urbanizmit Xhejlane Xhini. Mirëpo ai e ka arsyetuar me idenë që performancës, ne nuk e dimë qysh, qysh kërkohet performancë prej një zyrtari komunal apo prej

një shërbyesi civil, ashtu në atë formë gojore, janë metoda të tjera të matjes së performancës. Ajo çka po më intereson si zyrë e juaja, e keni trajtu këtë rast? për shkak se për mendimin tim ka qenë rast shumë i rëndë edhe shembull për të gjithë të tjerët, sidomos ndaj Drejtorisë së Urbanizmit, sidomos aty ku jepen lejet e ndërtimit, e sidomos në një vend si Kosova ku lejet e ndërtimit edhe ata që qëndrojnë prapë pas lejeve, ndonjëherë të tejkaluara, ndonjëherë të kundërligjshme, janë tepër persona të fuqishëm. Mirëpo prej zyrës së juaj, unë s'kam arritë me pa reagimin ose a është marrë dikush me këtë rast, se përndryshe është një mesazh shumë i keq, edhe një shembull shumë i keq që nëse kryetari e pranon qysh thashë më herët që e ka pranuar përmes një portali që ka pas një konflikt le ta quajmë ashtu. E pranon publikisht edhe nuk ka reprodukime ndaj tij për këtë veprim. Paramendo qysh veprojnë zyrtarë të tjerë të komunës, shërbyesit tjerë civilë, sidomos nëse askush nuk gjindet afër tyre ose nuk i mbron, ose nuk i ndjek rrugët ligjore administrative për t'i mbrojtur të drejtat e tyre. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. A ka dikush tjetër? Në qoftë se jo, zonja Zhuri, në qoftë se keni ndonjë përgjigje?

Mybezhele Zhuri: (Udhëneqëse e NDNJBGJ): Aq shumë kritika patë, kritika nëse mundem me thënë, ose janë vetëm sugjerime ta them, unë ashtu e kisha marrë se më lehtë po më vjen. Unë në fillim thashë, një njeri në shumë pozita. Ju kërkoni që unë të jam perfekte në çdo fushë, nuk është e mundur. E dyta është partitë politike vetë i përcaktojnë drejtorët, jo unë. Edhe shumë mirë e njohin ligjin, ligji nuk i vlen për zyrtaren për barazi gjinore, por për të gjithë, edhe për partitë politike, edhe për çdo forum ekzistues, ashtu që ai që nuk e respekton, nuk e respekton nga aspekti i vetë, jo nga aspekti jem. A do të ankohem? Ankesat e mia ose propozimet e mia shkojnë atje ku unë marrë pjesë. Nuk mundem me qenë gjithkrah. Sa i përket zonjës Xhejlane, asnjë ankesë në zyrën time s'ka ardhur dhe gjithashtu zonja zonjusha Dafina, tha që ne jemi këtu, ju pse s'po ankoheni? Unë nuk jam në gjendje me shkuar pas 13 deputeteve femra edhe të tjerët jeni 41 të gjithë, se nuk më premton koha. Përndryshe bashkëpunimi me grupin joformal është në rregull, bashkëpunimi me komisionin për barazi gjinore është në rregull. Dhe ky raport unë qysh në fillim thashë, është informatë, nuk është raport. Raporti i detajuar shkon atje ku duhet, te drejtori, në agjencion, ku kërkohen detajet. Asnjë rregullore nuk më obligon me raportuar në detaje në këtë forum këtu. Vetëm që për shkak, nuk më obligon drejtorit, kryetarit, ju lutem agjencionit edhe ministrive të cilat kërkojnë raporte për të gjitha fushat. Shumë është lehtë me dhënë zonjë kritikë sepse me ju lënë juve me punuar në 5, 6 pozita. Po punoj se e kam obligim pune aq sa mundem derisa edhe vjen dikush tjetër. Nuk kam refuzuar sepse kam pranuar me punu në atë vend pune, me kalimin e kohës është rritur vëllimi i punëve dhe me atë është rritur edhe nevoja për zyrtarë të tjerë. Kërkesat i kam bërë, janë edhe zyrtarisht mendoj janë të gjitha të drejtuara në organet gjegjëse, po kjo nuk varet prej meje. Unë mundem vetëm, aq kam kompetenca, me kërkuar edhe pres realizimin e tyre. Mirëpo mos harroni se edhe më herët edhe në pushtetin tjetër unë kam ekzistuar po kërkush asnjëherë s'më ka thirrur dikë, as si zyre nuk kam qenë e përfaqësuar askund.

Dafina Alishani (LVV): Qetash a je e përfaqësuar?

Mybezhele Zhuri: (Udhëneqëse e NDNJBGGJ): Jam, të lutem, kujdes me fjalorin. Nuk i frigohem askujt, as ty më së pakti. Unë punoj aq sa mundem edhe bëjë sugjerime edhe kritika aty ku kompetencat e mia më lejojnë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po replikë Dafina.

Dafina Alishani (LVV): Ju po thoni që nuk e keni obligim me ardhur këtu me raportuar. Ne si kuvend e kemi votuar në plan të punës, dhe çka votohet këtu, duhet me pas parasysh secili që e ka përgjegjësi për me raportuar. Ne ju kemi ftuar juve për me e raportuar. Ne e kemi rend ditës raportim, ju tash po thoni që është informatë. Unë po ju pyes, në këtë pushtet, a po ju pyesin për diçka edhe a jeni të kënaqur me përfshirjen e zyrës së juaj në këtë pushtet. Ju po më ktheni përgjegjësi për pushtetin e kaluar. Zonjë, ju jeni këtu shërbyes civil, mos u bëni partiak. Përgjegjet tona duheni me i dhënë të paanshëm. Edhe nuk është e vërtetë që nuk ju kemi ftuar në mandatin e kaluar, si grup jo formal po flas, që i kemi këtu asamblistët që kanë qenë edhe në mandatin e kaluar. Mosni se po na hyni në hak edhe neve. Edhe unë nuk e kam nijet me u shty ose me të frikësu. Po thjeshtë nuk është serioze me thënë që unë nuk e kam obligim këtu, kam ku raportoj edhe kaq. Jo jo, legjislativi këtu është organi më i lartë është Kuvendi Komuna. Nëse nuk e dini po më vjen keq.

Mybezhele Zhuri: (Udhëneqëse e NDNJBGGJ): Jo, unë shumë mire e di. Unë thash që nuk kam nevojë me raportuar në detaje, Informatë kam dhënë ato qysh ka shkru në rendin e ditës.

Dafina Alishani (LVV): Rendi i ditës është raport zonjë, nuk është informatë por raport edhe raporti i detajum, ish dashtë me ardhë këtu me rezultate e jo me axhendën e juaj se ku keni marrë pjesë nëpër trajnime. Po më vjen keq.

Mybezhele Zhuri: (Udhëneqëse e NDNJBGGJ): Të lutem, çdo prani e imja, kudo qoftë që kam qenë, e ka kontributin e vetë edhe e ka rezultatin e vetë. Se nuk bëhen këto punë, nuk është shitblerje, po ndikime.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Dikush tjetër, në qoftë se nuk ka, atëherë po ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen në diskutim në këtë pikë. Po kalojmë te pika e fundit, pra që është bërë propozimi i ri sot.

Pika e dhjetë:

Subvencionimi dhe kompensimi i dëmit për biznese të shkaktuara si pasojë e punimeve në zonën historike.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Nuk e di Ilir, a ke nevojë përsëri me e marrë fjalën apo Nënkryetari? Nënkryetari, atëherë se e kërkoi i pari fjalën.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Faleminderit Kryesuese. Shumë shkurt, është një propozim që ka një vullnet politik edhe prej anës tonë me shtyrë përpara dhe besoj edhe grupe të

tjera parlamentare, por është pak i ngushëm sepse mendoj që duhet me pas një analizë. Çfarë kemi me bërë me këtë vendim? çfarë ka me u falur edhe çfarë ka me u ndihmuar. Nëse një vendim e marrim sot pa e qartësuar mirë bazën juridike të tij, unë besoj që ai kthehet, qysh po kthehet edhe ndonjë aty këtu. Kështu që ju rekomandoj që ky vendim me u shty për seancën tjetër, me u diskutuar me grupet parlamentare, sepse nëse ne thojmë me i subvencionuar bizneset, ta keni parasysh që kjo është kundërligjore për faktin se ne kemi rregullore që e përcakton këtë fushë mire, një. E dyta, u përmendën taksat komunale, nuk e di a e dini. Në komunën e Prizrenit nuk paguhet taksa komunale, domethënë është e larguar. Çka kemi me falë? Në anën tjetër, ne duhet me ditë cilat biznese përfshihen në këtë vendim me emër dhe mbiemër. Ku janë qiratë, ata 90% të lokale qiratë i paguajnë privatëve, s'na paguajnë neve. Ja paguajnë privatnikëve, atyre që ja shfrytëzojnë. Lokale të komunës ka pak në shatërvan, siç e dini. Edhe duhet me ditë në cilën pjesë përfshihen se projekti i shatërvanit nuk është i përfshirë në krejt lokalitetin. Një lokal ndoshta e ka përjetuar dy muaj, lokali tjetër e ka përjetuar një javë. Duhet me pasur analizë të saktë se cili lokal përfshihet edhe çfarë kemi me bërë me këtë vendim. Në anën tjetër, nëse e merr një vendim të ngutshëm, besoj ka me qenë pa efekt se me automatizëm, qysh e ka lexuar Iliri, bjerë ndesh me dy rregullore të këtij kuvendi.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit nënkryetar. Po, Karamfili e ka fjalën.

Karanfil Haxhillari (LVV): Unë po mendoj që propozuesi i pikës së rendit të ditës në këtë rast, Iliri, së bashku me zyrtarët ligjorë, të ulen edhe ta përpilojnë, domethënë, aty ku kemi kompetencë si komunë për me i falur gjërat, sepse në qoftë se e kemi të drejtë ata të cilët i kanë lokalet e komunës me qira, e ka të drejtën komuna me ja falë qiranë. Aty ku e shfrytëzon hapësirën, taksë komunale për karriga, tavolina që i ka, e ka të drejtën komuna. Në qoftë se jem në dyshim për shembull subvencionimin që e bënë në humbje që ka pasur, këtu kam dyshimet e mia, a munden me na me na pranuar ministria apo jo. Por unë e kisha rekomanduar që këtë pikë të rendit të ditës të ulen propozuesit së bashku me zyrtarët ligjorë, ta bëjnë në mënyrë juridike efektive që edhe ne si kuvend ta votojmë që mos të na kthehet mbrapshtë. Këtë e mendova unë, po besoj që ndoshta është iniciativa domethënë doli sot, që e votuam, por me kushtet mbetet si pikë e rendit të ditës që na vjen në seancën e radhës dhe që e pamë që të gjithë patën vullnet që ta votojnë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po shumë qartë Karanfil, edhe unë i bashkangjitemi mendimit të Nënkyetarit dhe tuajit. Edhe ashtu ashtu për momentin nuk kemi kuorum me e qitë në votim. Kështu që kisha kërkuar që të mbledhet materiali, t'i bëjmë gjërat më konkrete edhe e qesim në seancën e radhës pa problem. Po Dafina Alishani.

Dafina Alishani (LVV): Kryesuese, këtu i kemi ne tre pika. Edhe dy pikat e para janë gjëra të cilat janë të mundshme të bëhen nga komuna. Hajde po e llogarisim që subvencionet nuk kemi të drejtë, ato po ju lëmë juve si ekzekutiv e merrni një vendim edhe nëse jeni pro subvencionimit. Për faljen e borxhit të taksave komunale, për shfrytëzimin e hapësirave publike, ju veç keni çuar letra nëpër lokale për pagesë të hapësirave publike, a është e vërtetë? Është koha adekuate për të cilën duhemi me pas parasysh edhe me e iniciu këtë edhe me procedu tutje, se i keni të dhënat të gjitha, janë terasat të evidentuara, i keni dërguar fatura, hajde po fillojmë, nëse jemi të pajtimit me i fillojmë me një gjë e cila është e mundshme me e marrë komuna si përgjegjësi. Për subvencione

okej, po na bindni që duhet me pas një modalitet ligjor në rregull, por të parën duhemi me shty përpara. Për lirim për qira, janë ato lokale të cilat janë në shfrytëzim, domethënë prona komunale, edhe ata janë të dëmtuara, bash ku ka prona komunale, ka pas punime edhe janë dëmtuar. Të tjera gjëra që keni shtesë, rekomandime janë të mirëseardhura, po kjo faza sidomos për pjesën e shfrytëzimit të hapësirave publike, nuk kemi çka humbim kohë, pasi që edhe patëm miratimin e gjithë kuvendarëve që është një ide, initiative e mirë, ta fillojmë me këtë. Tjerat vazhdojmë ekzekutivi sa atraktiv edhe sa kreativ që është.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Nënkrjetari fjalën përsëri.

Kujtim Gashi (Nënkrjetar i Komunës): Veç edhe njëherë shkurtë. Edhe me I liruar nga pagesa e shfrytëzimit të hapësirave fakturat burojnë prej rregullores. Edhe nuk besoj që mund me pasur një vendim i cili e shfuqizon në mënyrë parciale një rregullore që është në fuqi. Prandaj duhet me pasur kujdes çfarë vendimi po marrim se nuk mund me marrë vendim në kundërshtim me një rregullore që është fuqi, e me të cilën rregullore bëhen edhe pagesat e hapësirave publike edhe të qirave të gjitha. Kështu që mos nxitoni se mund të jetë vendim i paligjshëm.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po Dafina dhe Petriti pastaj.

Dafina Alishani (LVV): Po zotëri Nënkrjetar, edhe borxhet e kanë një ligj dhe një rregullore, por kur vendoset falja e borxheve, realizohet.

Kujtim Gashi (Nënkrjetar i Komunës): Po veç thotë në bazë të ligjit, nenit kaq, rregullores kaq, sot se dime.

Dafina Alishani (LVV): Po nuk është hera e parë ne që e kemi marrë këtë vendim. Është marrë vendimi edhe më herët edhe nuk ka pasur diçka jashtë ligjore, nuk është viti i parë që ne sot po e shpikim faljen e pagesës.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po, Petrit Hoxhaj.

Petrit Hoxhaj (Guxo): E mbështes mendimin e Karanfilit që tha që është mirë me lënë për një seancë tjetër dhe me ulur dhe me vendosur sepse unë mendoj në këtë formë do t'i dëmtojmë bizneset të cilat nuk kanë vende të komunës në shfrytëzim dhe si do t'ju falet aty dhe çka do t'ju falet. E kështu që ish kon mirë që me lënë me u vendos shefat e grupeve bashkë me këto dhe me marrë një vendim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po, patjetër që duhet edhe me Drejtorinë e Financave. Ashtu ashtu, për me hedh në votim këtë pikë rendi i ditës nuk jemi sepse për prezent jemi 18 ose 19, s'po mundem tash me e ditë tamam. 19 anëtarë. Unë po ju falenderoj shumë për pjesëmarrjen dhe shihemi në seancën e radhës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Kuvendi Komunal Prizren
Skupstina Opština Prizren
Prizren Belediyesi

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027

Qershor 2024

KËRKESAT E PRANUARA PËR PROJEKTET KAPITALE SIPAS DREJTORIVE PER VITIN 2025-2027					
	EMERTIMI I PROJEKTEVE	KODI I PROJEKTEVE EKZISTUESE DHE PROJEKTET E REJA	SHUMA E PLANIFIKUAR 2025	SHUMA E PARASHIKUAR 2026	SHUMA E PARASHIKUAR 2027
			21,425,881.00	23,804,076.00	26,374,437.00
	KK - PRIZREN		0.00	0.00	0.00
	TOTALI I PROJEKTEVE KAPITALE - PRIZREN		21,425,881.00	23,804,076.00	26,374,437.00
	180 SHERB.PUBLI.MBROJT.CIVIL.EMER				
1	Rregullimi i trotuareve në unazen e qytetit, Rruget Remzi Ademaj, Adem Jashari,Zahir Pajaziti,Ibrahim Rugova, vazhdim projekti	54610	382,288.65	0.00	0.00
2	Rregullimi i rrugëve,kanalizimit, ujësjellesit dhe ndriçimit publik në Lagjen "Dardania II"	52691	800,000.00	845,788.23	290,587.00
3	Shtimi I kapacitetit të ujit të pijës në Komunën e Prizrenit	53833	200,000.00	200,000.00	500,000.00
4	Vendosja e ujëmatësve dhe pusëtës për konsumator në pronë publike-Zhur Dobrushtë, Vërmicë, Shkozë, Vlashnje, Muradem, Kobajë dhe Nashec	52402	800,000.00	1,221,403.00	1,200,000.00
5	Rehabilitimi I ujësjellesit në rrugën "Edit Durham"	52403	150,000.00		
6	Ndërtimi i ujësjellesit në Lubizhdë të Prizrenit , ndërtimi i bazenit të ri.	51105	177,000.00		
7	Ndërtimi I kanalizimit dhe rrugëve në lagjën "Bajram Curri	53805	200,000.00	500,000.00	1,500,000.00
8	Ndrtimi i Infrastrukturës (rruge,kanalizim,ujesjelles etj) në lagjen "Jeta e re".	52100	200,000.00	30,000.00	500,000.00
9	Instalimi i ndriçimit të ri publik dhe riparimi I ndriçimit ekzistues	82446	500,000.00	700,000.00	1,000,000.00
10	Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugeve me asfalt në qyte dhe fshatra (aty ku paraqitet nevoja për intervenime)	53818	800,000.00	1,200,000.00	1,500,000.00
11	Rehabilitimi, ndërtimi, trotuareve dhe shesheve me elemente betoni (intervenimi ne ato vende ku paraqitet nevoja) në qytet dhe fshatra të Prizrenit	53817	500,000.00	400,000.00	800,000.00
12	Rehabilitimi dhe mirembajtja e sistemit të kanalizimit dhe ujësjellesit në qytetin e Prizrenit dhe fshatra të Prizrenit (aty ku eshte nevoja për intervenim)	53834	500,000.00	800,000.00	1,000,000.00
13	Shenjëzimi horizontal, vertikal dhe sinjalizues në qytet dhe fshatra të Komunës së Prizrenit (aty ky paraqitet nevoja per intervenim)	53826	200,000.00	300,000.00	400,000.00
14	Projekte ambientale (parqe, rrethoja,karrika, ndriqim dekorativ etj) në pjesën kryesore të Qytetit të Prizrenit	53811	250,000.00	200,000.00	300,000.00
15	Ndërtimi i projekteve infrastrukture-rrugeve,kanalizimit,ujësjellesit,mure mbrojtëse,urave etj, projekte te vogla në Qytetin e Prizrenit dhe fshatrave	53804	200,000.00	200,000.00	300,000.00
16	Ndërtimi i Infrastrukturës (rrugë,kanalizim,ujesjelles etj) Tusus	52104	200,000.00	300,000.00	400,000.00
17	Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në lagjen "Arbana" në qytetin e Prizrenit	53808	200,000.00	200,000.00	200,000.00
18	Ndërtimi i rrugës Billushë-aksi rrugor Zhur-Dragash	52507	84,014.59	0.00	0.00
19	Ndërtimi I infrastrukturës në fshatin Karashengjergj	51116	38,227.12	0.00	0.00
20	Ndërtimi I rrugëve dhe kanalizimit "11 Marsi"	53806	181,097.83	0.00	0.00
21	Ndërtimi I infrastrukturës në Kobajë	52137	100,000.00	127,777.77	0.00
22	Ndërtimi I infrastrukturës në Kushnin Has	53807	98,929.82	0.00	0.00
23	Hapja e rrugës pyjore Udha e staneve në Vërmicë	52591	200,000.00	487,779.00	0.00
24	Ndërtimi I infrastrukturës në Nashec (rrugë,kanalizim dhe ujësjelles)	52135	250,000.00	0.00	0.00
25	Ndërtimi I infrastrukturës Planejë-Gorozhup	52592	210,000.00	0.00	0.00
26	Rehabilitimi i infrastruktures (rrugët , kanalizimi ,ujësjellesi, ndriçimi publik etj) , në Zhur	49724	150,000.00	200,000.00	200,000.00
27	Ndërtimi I kanalizimit dhe rrugëve në Skorobisht	52295	178,202.08	0.00	0.00
28	Ndërtimi I ndriçimit publik në Korishë	52408	204,000.00	0.00	0.00
29	Ndërtimi I rrugës Velezhë-Smaç	52472	29,349.39	0.00	0.00
30	Ndërtimi I infrastrukturës, rrugët dhe kanalizimi në fshatin Piranë	53812	58,546.26	0.00	0.00
31	Ndërtimi I kanalizimit në fshatin Landovicë	52468	42,696.75	0.00	0.00
32	Ndërtimi I rrugës Qafa e Kushninit-Stanet e Struzhës	52107	71,844.71	0.00	0.00
33	Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapsirave publike në zonen e parë të mbrojtur në pjesen e vjeter të qytetit, restaurimi shesheve dhe objekteve	52402	1,250,000.00	1,200,000.00	300,000.00
34	Rehabilitimi I rrjetit të ujësjellesit në rrugën "Nënë Tereza"	52405	500,000.00	179,000.00	0.00
35	Ndërtimi I infrastrukturës në Korishë	40602	400,000.00	624,995.00	0.00
36	Ndërtimi I infrastrukturës në Hoqë të Qytetit	54068	300,000.00	425,000.00	400,000.00
37	Ndërtimi I rrugës Sërbicë e Poshtme-Zojz	52548	127,037.80	0.00	0.00

38	Ndërtimi I toaleteve publike në Komunën e Prizrenit	54141	63,484.00	0.00	0.00
39	Rregullimi i murëve mbrojtëse në Komunën e Prizrenit ne Landovicë, Randobravë,fshatra te Zhupës, Has, Vërrri etj	54021	300,000.00	500,000.00	600,000.00
40	Ndërtimi I shtratit të Lumbardhit nga Ura afër kampusit universitar në vazhdim të rrjedhës	52118	200,000.00	1,000,000.00	1,000,000.00
41	Shtresimi i rrugeve me asfalt ne fshatin Hoqë e Qytetit	53838	148,980.00	0.00	0.00
42	Rregullimi I rrugëve dhe trotuareve në lagjen 2 Korriku	52399	300,000.00	700,000.00	2,300,000.00
43	Ndërtim I kanalizimit dhe mureve mbrojtëse në Krushë të Vogel	52728	300,000.00	400,000.00	0.00
44	Ndërtiim I infrastrukturës në Gjonaj	49728	200,000.00	500,000.00	600,000.00
45	Ndërtimi I infrastrukturës në Zojz-Ndërtimi I Urës	52593	300,000.00	300,000.00	300,000.00
46	Zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës me asfalt në fshatin Novakë	52115	60,000.00		
47	Rregulimi i infrastrukturës si dhe renovimi i objektit të stacionit të autobusave	54141	250,000.00	500,000.00	1,000,000.00
48	Rregullimi i ndriçimit publik në Lubizhdë të Hasit	52474	93,000.00		
	TOTALI SHERBIMET PUBLIKE - PRIZREN		€ 12,948,699.00	€ 14,241,743.00	€ 16,590,587.00
	ADMINISTRATA				
1	Ndertimi dhe renovimi i objekteve te K.K Prizren		100,000.00	200,000.00	230,000.00
2	Ndertimi I vorrezave ne Krushe te Vogel		18,630.00	10,000.00	10,000.00
3	Ndertimi I Memorialit ne Krushe te Vogel		160,420.00	10,000.00	10,000.00
4	Blerja e veturave per nevojat e Komunes se Prizrenit		100,000.00	200,000.00	220,000.00
	Totali i Administrates		€ 379,050.00	€ 420,000.00	€ 470,000.00
	ZJARRFIKESIT				
1	Vendosja dhe mirëmbajtja e kamerave të sigurisë në Komunën e Prizrenit	48539	150,000.00	565,000.00	500,000.00
2	Ndërtimet e mureve mbrojtëse nga rrëshqitjet e dheut	55875	125,000.00	125,000.00	100,000.00
3	Blerja e paisje për brigadën e zjarrfikësve (Gjenerator, motorrsharr, kompresor, Shkalle etj)	52143	50,000.00	50,000.00	50,000.00
4	Automjet per brigadën e zjarrfikeseve	53357	125,000.00	100,000.00	200,000.00
	Totali I Zjarrefikesve		€ 450,000.00	€ 840,000.00	€ 850,000.00
	TURIZMI				
1	Ndërtimi i infrastrukturës (rrugët dhe ambient) turizmit kulturor - Leskovec	53442	30,000.00	50.000.00	30.000.00
2	Ndertimi i infrastrukturës (rrugët dhe ambient) turizmi malor dhe rural - Nashec, Jabllanicë, Vërmicë	53438	50,000.00	40.000.00	50.000.00
3	Ndërtimi I infrastrukturës (rrugët,ujë,kanalizim) Kisha e Shën Pjetrit-Kabashë në Korishë dhe Gurri I Kallugjerit Jeshkovë -Billushe	54623	196,911.90	40.000.00	60.000.00
4	Rregullimi i ambientit të jashtëm në fshatin Poslishtë	52146	67,838.40	0.00	0.00
5	Hapja e rrugëve malore (Kala Pashaqeshme, ZHUR, Kapanavode, Vermicë)	53467	52,420.35	0.00	0.00
6	Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve në Poslisht, Nashec, Struzhë, Kabashë - Korishë "Krijimi I ambientit turistik në Malet e Kabashit dhe të Korishës"	52147	17,687.00	0.00	0.00
7	Ndërtimi i shtigjeve për bicikleta në Cvilen dhe Vlashnje	53369	17,786.19	0.00	0.00
8	Ndertimi I infrastruktures (rruget, kanalizim, ambijet) rruget malore ne rajonin e Sharrit (Zhupa), Zhur, Verrinit, Has dhe Kabashe Korishe	54608	50,000.00	80,000.00	100,000.00
9	Ndërtimi I infrastrukturës (rrugët,ujë,kanalizim) në dy burimet e ujit në Vërmicë	54527	92,000.00	80.000.00	120.000.00
10	Restaurimi I Xhamisë së vjetër në fshatin Leskovec	Projekt i ri	0.00	100,000.00	60.000.00
11	Rregullimi infrastruktures te ujevarja e Donje Lubinjes	Projekt i ri	70,000.00	80.000.00	20.000.00
12	Ndertimi i infrastrukturës (rrugët dhe ambient) turizmi malor dhe rural - Vlashnje dhe Muradem	Projekt i ri	100.000.00	80,000.00	12,000.00
13	Ndertimi I infrastruktures ne Parkun Ekonomik Lubizhde	Projekt i ri	50,000.00	80,000.00	100,000.00
14	Shtigjet per biciklistat	Projekt i ri	0.00	100,000.00	70,000.00
	Totali i Turizmit		€ 694,643.84	€ 440,000.00	€ 282,000.00
	BUJQESIA				
1	Rehabilitimi I rrugeve fushore (kontrat korniz 3 vjeqare)	53848	193,333.00	193,333.00	193,333.00
2	Rehabilitimi kanaleve ujitese dhe kullimi I tokave bujqesore	53840	114,298.51	160,000.00	160,000.00
3	Ndërtimi I Stacionit Antibreshër	54669	70,000.00	70,000.00	-
4	Ndërtimi Strehimorës për trajtimin e qenve endacak	54628	100,000.00	-	-
	Totali i Bujqesise		477,631.51	423,333.00	353,333.00
	SHENDETESIA				
1	Ndërtimi i QKMF-së në Kfor	51098	450,000.00	0.00	0.00
2	Paisje mjekësore	89621	100,000.00	200,000.00	250,000.00
3	Paisje stomatologjike	89622	30,000.00	50,000.00	150,000.00
4	Paisje Laboratorike	89626	50,000.00	200,000.00	150,000.00
5	Paisje jomedicionale	48493	50,000.00	100,000.00	170,000.00
6	Mamografi	49286	150,000.00	0.00	0.00
7	Autoambulanca	48472	150,000.00	250,000.00	150,000.00
8	Ndertimi i QMF-së në lagjen e Trimave (Tusuz)	53535	470,000.00	200,000.00	0.00
9	Instalimi dhe montimi i ngrohjes qendrore dhe klimatizimi eficient në objketet shëndetësore	55119	50,000.00	50,000.00	100,000.00
10	Digjitalizimi I sherbimeve te analizave laboratorike	54645	0.00	0.00	0.00
11	Ndërtimi i AMF-së në fshatin Vlashnje	Projekt i ri	0.00	300,000.00	100,000.00
12	Blerja e Autoveturave për nevojat e KPSH	Projekt i ri	0.00	200,000.00	0.00
13	Ndërtimi i QMF-së në fshatin Piranë	Projekt i ri	0.00	150,000.00	350,000.00
14	Ndërtimi i AMF-së në fshatin Randobravë	Projekt i ri	0.00	0.00	200,000.00
	Totali i Shendetesise :		1,500,000.00	1,700,000.00	1,620,000.00
	SHERBIMET SOCIALE				
1	Ndertimi i banesave sociale ne Lgjen Petrove - Prizren	45867	250,000.00	550,000.00	650,000.00

2	Ndërtimi i Aneksit te Shtëpia Rezidenciale (salla për rekreacione fizike-sportive)	53608	20,000.00	20,000.00	130,000.00
3	Ndërtimi i QPS2	48704	55,000.00	60,000.00	150,000.00
4	Rregullimi i infrastrukturës për ndertesën e QPS 2		30,000.00	15,000.00	1,000.00
5	Ndërtimi i shtëpisë emergjente për mbrojtjen e fëmijëve	53610	215,000.00	215,000.00	215,000.00
6	Ashensor (Lift) për shtepin 2QPS	Projekt i ri	30,000.00	20,000.00	30,000.00
7	Ashensor (Lift) për shtepin e të moshuarve	Projekt i ri	45,000.00	20,000.00	10,000.00
8	Ndërtimi i koridorit për lidhjen fizike në mes të objekteve të QPS-së dhe objektit të Arhivit si dhe vendosja e ashensorit për mundësimin e qasjes së përsnoave me aftësi të kufizuara në objektin e QPS-së	Projekt i ri	5,000.00	60,000.00	10,000.00
Totali Sherbimet sociale			650,000.00	960,000.00	1,196,000.00
URBANIZMI					
1	Hartimi I planeve detale nga HZK ne zonen urbane dhe rurale dhe riparcializimi I zonave sipas nevojave				
2	Hapja e rrugeve sipas HZK-se				
3	Hartimi I PZHK-se				
4	Mirembajtja e objekteve te banimit kolektiv (kulme dhe lyrje)				
Totali i Urbanizmit			€ -	€ -	€ -
ARSIMI					
1	Ndërtimi I objektit të ri shkollor "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" (ish Pjeter Mazrreku) në Mazrrek	40755	376,800.00	0.00	0.00
2	Ndërtimi I objektit të ri shkollor në Krushe të Vogël - faza e dyte	46665	148,750.00	100,000.00	0.00
3	Ndertimi i aneksit te shkolles ne Vermice	52153	53,865.00	0.00	0.00
4	Ndertimi i aneksit te shkolles se mesme ne Romajë - Has	53425	18,218.00	0.00	0.00
5	Rregullimi I ambientit te oborreve ne shkollat e Prizrenit	53862	141,630.00	0.00	0.00
6	Ndertimi i aneksit te shkolles "Besim Ndrecaj" Lutogllave	53433	100,000.00	199,000.00	0.00
7	Renovimi I objektit shkollor SHF "Lekë Dukagjini" Prizren	53437	16,800.00	0.00	0.00
8	Ndërtimi I qerdhes ne Lagjen Tusus Prizren	53443	300,000.00	300,000.00	262,517.00
9	Ndërtimi I qerdhes ne Fshatin Zhur - Prizren	54447	50,000.00	150,000.00	150,000.00
10	Ndërtimi I qerdhes ne Lagjen Arbana Prizren	54449	200,000.00	400,000.00	200,000.00
11	Renovimi i teresishem i obj.shk. "Mati Logoreci" Prizren	54450	150,000.00	0.00	0.00
12	Renovimi i njeve sanitare ne objektet shkollore: Ibrahim Fehmiu dhe Deshmoret e Kabashit	54539	50,000.00	0.00	0.00
13	Ndertimi dhe rregullimi i stadiumit ne shkollen "Meto Bajraktari" ne Recane	54541	50,000.00	0.00	0.00
14	Punimi terrenit sportiv dhe rrethojes se oborrit ne SHFMU"Naim Frasheri" Kobaj Prizren	54565	150,000.00	0.00	0.00
15	Digjitalizimi i sistemit te institucioneve arsimore ne shkollat; Emin Duraku, Mati Logoreci, Leke Dukagjini, Abdyl Frasheri, Hysen Rexhepi, Gani Saramati, Ibrahim Fehmiu, Fadil Hisari,	55123	100,000.00	100,000.00	0.00
16	Projektet e Komunitetit	Projekt I Ri	100,000.00	0.00	0.00
17	Projektet e Komunitetit	Projekt I Ri	100,000.00	0.00	0.00
18	Projektet e Komunitetit	Projekt I Ri	100,000.00	0.00	0.00
19	Ndrrimi i kalldajave ngrohjes qendrore, ne shkollat; SHFMU"Motrat Qiriaz" Iagj.Kurile Prizren, "Luigj Gurakuqi" Nashec dhe "Brigada 125" Medvec	Projekt I Ri	100,000.00	0.00	0.00
20	Ndert, I SEF Gani Saramati	Projekt I Ri	50,000.00	150,000.00	150,000.00
21	Ndert I njeve sanitare shk. Sinan Thaqi" Zojz	Projekt I Ri	30,000.00	0.00	0.00
22	Ndertimi I aneksit te shkolles "Fatmir Berisha" Prizren	Projekt I Ri	50,000.00	0.00	0.00
23	Ndertimi I depose per lende djegese per ngrohje ne SHFMU "Leke Dukagjini" Prizren dhe "Mushnikova" Mushnikovë	Projekt I Ri	80,000.00	0.00	0.00
24	Renovimi I teresishem I objektit shkollor "Deshmoret e Zhurit" Zhur	Projekt I Ri	100,000.00	200,000.00	0.00
25	Renovimi I teresishem I objekteve shkollore ne Gorozhup	Projekt I Ri	50,000.00	0.00	0.00
26	Mirembajtja e sistemit te ngrohjeve qendrore neper shkolla	Projekt I Ri	0.00	100,000.00	150,000.00
27	Ndërtimi I aneksit të objektit shkollor Gjmnazi "Remzi Ademaj" në Prizren	Projekt I Ri	0.00	200,000.00	200,000.00
28	Renovimi I teresishem I objektit parashkollor "Lidhja e Prizrenit" Prizren	Projekt I Ri	0.00	150,000.00	0.00
29	Adaptimi I hapësirës për laboratore dhe furnizimi me paisje, ne shkolla	Projekt I Ri	0.00	200,000.00	200,000.00
30	Ndërtimi I sallës së edukatës fizike në shkollën "Mithat Frasheri" në Krajk	Projekt I Ri	0.00	200,000.00	300,000.00
31	Ndërtimi I sallës së edukatës fizike në shkollën "Dy Deshmoret" në Piranë	Projekt I Ri	0.00	200,000.00	200,000.00
32	Ndrimi I dyerve dhe dritareve te SHFMU"Emin Duraku" Prizren	Projekt I Ri	0.00	100,000.00	0.00
33	Renovimi I kulmit te objektit shkollor "Luigj Gurakuqi" Nashec	Projekt I Ri	0.00	50,000.00	0.00
34	Renovimi I kulmit te objektit shkollor "17 Shkurt" Atmaxheë	Projekt I Ri	0.00	30,000.00	0.00
35	Ndrrimi I dyerve dhe dritareve te SHFMU"Ibrahim Fehmiu" Arbane Prizren	Projekt I Ri	0.00	100,000.00	0.00
36	Ndrrimi I dyerve dhe dritareve te SHFNU"Pjeter Budi" Lubizhde Has	Projekt I Ri	0.00	100,000.00	0.00
37	Renovimi I teresishem I objektit shkollor "Izvor" Lubinje e Eperme	Projekt I Ri	0.00	100,000.00	0.00
38	Ndrimi I dyerve dhe dritareve te SHFMU"Haziz Tola" Prizren	Projekt I Ri	0.00	0.00	100,000.00
39	Ndërtimi i objektit të ri shkollor ne Zym te Hasit	Projekt I Ri	0.00	0.00	500,000.00
40	Renovimi I SEF te SHMU "Abdyl Frasheri" Prizren	Projekt I Ri	0.00	0.00	200,000.00
41	Ndërtimi I objektit të ri shkollor ne Lagjen "Bajram Curri" Prizren	Projekt I Ri	0.00	0.00	700,000.00
Totali i Arsimit			€ 2,666,063.00	€ 3,129,000.00	€ 3,312,517.00
KULTURA					
1	Ndërtimi i objekteve sportive dhe kulturore në qytet dhe fshatra	54673	400,000.00	800,000.00	1,000,000.00
2	Ndërtimi i sallës Multifunkionale	49873	207,066.45	0.00	0.00
3	Ndërtimi i varrezave të martirëve në Landovicë	53628	8,635.90	0.00	0.00
4	Ndërtimi i stadiumit në Kabash (Has) KK Prizren-FFK	53618	250,000.00	250,000.00	

5	Ndërtimi i memorialit "Xhavit Elshani"- Leopardi	53854	800.00	0.00	0.00
6	Restaurimi i Kullës në Gjonaj (Komuna dhe QRTK)	54672	100,000.00	0.00	0.00
7	Kulla e "Remzi Ademaj" Zhur	53622	6,291.30	0.00	0.00
8	Ndërtimi i Qendrës Kulturore Turke	40728	100,000.00	250,000.00	300,000.00
	Ndërtimi i Qendrës Kulturore në Pousk	53623	187,000.00	0.00	0.00
9	Ndërtimi i tribunave Tribuna në Stadiumin ne Gjonaj KK Prizren- FFK	Projekt I Ri	100,000.00	0.00	0.00
Totali i Kultures			1,359,793.65	1,300,000.00	1,300,000.00
FINANCA					
Bashkfinancim me donator			300,000.00	350,000.00	400,000.00
1	Rinovimi i Eficiences e energjise te ndertesave publike ne Prizren				
Total Financa			300,000.00	350,000.00	400,000.00



Republika e Kosovës
 Republika Kosova
 Republic of Kosova



Kuvendi Komunal Prizren
 Skupstina Opstina Prizren
 Municipal Assembly Prizren

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2025 - 2027

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Prizrenit, është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2025-2027, të dhëna nga MFPT (Ministria e Financave Punës dhe Transfereve) përmes Qarkores buxhetore 2025/01 për Komunat si dhe financimi nga grandet ndërqeveritare dhe kufijtë fillestar të buxhetit komunal për vitin 2025 dhe parashikimet për 2026-2027. Ky dokument i ka kushtuar rendesi të veçantë alokimit të buxhetit nga aspekti i barazisë gjinore. Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e Komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme tri vjeçare. Me Kornizën Afatmesme Buxhetore – Komunale, do të paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioritetëve duke u bazuar në komponentine barazisë gjinore duke marrë për bazë nevojat e grave dhe burave gjatë planifikimit nga aspektet e punësimit, përfituesve të bursave , participimin në vendimarrje në projekte të ndryshme, kultura, subvencionet, pjesëmarrje në degjime publike etj. të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Prizrenit, si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush dhe përkrah projektet me prioritet, duke promovuar rritjen e mireqenies sociale dhe familjare me fokus të veçantë në grupet në nevojë dhe barazinë gjinore që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2025– 2027 gjithnjë duke u bazuar në :


- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
- Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe
- Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal

I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantojmë është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike duke marrë për bazë nevojat grave dhe burrave dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritimit sa më të mirë në procesin buxhetor. KAB promovon rritjen e mirëqenies sociale përmes zgjerimit dhe ngritjes së cilësisë, ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, me fokus të veçantë në grupet në nevojë dhe barazinë gjinore. Kjo është në përputhje me KASH-in.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2024-2026 të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritar të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2025-2027. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



II**1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi te barabarta për të gjithë**

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimi të standardeve të arsimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirsim, bursa për studime, laboratore)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë përmes subvencionimit të grave dhe burrave fermerë.
-

2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile me theks të vecante të gratë dhe grupet në nevojë
- Promovimi i projekteve për rininë dhe kulturë, dhe ofrimi i terreneve të reja sportive për vajza dhe djem.

3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij

Në bazë të hulumtimit të nevojave të grave dhe burrave Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimi dhe rigjenerimi të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik dhe numerizimi); transportit; dhe kanalizimit
- Përmirësimi të standardeve të ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara
- Ofrimi i mundësive për pjesëmarrje aktive të grave dhe grupeve në nevojë;

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

4. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve dhe nevojave të grave dhe burrave.

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve (burrave dhe grave) duke u fokusuar qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:

Ndërtimit dhe rekonstruimit të zyreve komunale (të gjendjes civile) në pika më të afërta të vendbanimeve, më qëllim të ofrimit të shërbimeve për gratë dhe burrat

Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2025-2027 do të shoqërohen me një miks të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

II. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtë për drejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyren fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2025-2027 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike siç janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2025-2027 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë të grave dhe burrave në Komunë, që në periudhën afatmesme pritet të ulet , nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrjedhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Operative**. Komunitat po ashtu janë pranuese të **granteve të donatorëve** (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Prizrenit në periudhën afatmesme buxhetore 2025-2027 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, sic e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

❖ OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Korniza Afatmesme Buxhetore për vitin 2025 – 2027 planifikohet në bazë të Buxhetit i cili bazohet në “Buxhetin e Programeve “ dhe është i orientuar në objektivat dhe në deklarata të Misionit të Programeve . KAB 2025 – 2027 është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore nr. 2025/01 e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritet e programeve .

Është pjesë përbërëse e KASH-it të Republikës së Kosovës. Karakteristikë tjetër e buxhetit të tashëm është përfshirja e “Kornizës afat mesme të shpenzimeve”. Kjo na ka mundësuar që të Planifikojmë të hyrat dhe shpenzimet jo vetëm për vitin pasus, por edhe për dy vite të ardhshme. Ajo që tani na duhet është definimi i “ Misionit tonë” së paku për tri vite tjera të kthyer në objektiva, programe, veprime dhe shifra.

Misioni i komunes eshte qe te promovon dhe ofron zhvillim dhe rritje te mireqenies se qytetareve duke ruajtur dinjitetin njerëzor dhe duke ofruar sherbime sa ma cilesore ,ne kohe dhe te barabarte per te gjithë, te ndjeshëm per nevojat e grave dhe burrave.

Deklarata e MISIONIT

Misioni i komunes eshte qe te promovon dhe ofron zhvillim dhe rritje te mireqenies se qytetareve duke ruajtur dinjitetin njerëzor dhe duke ofruar sherbime sa ma cilesore ,ne kohe dhe te barabarte per te gjithë, te ndjeshëm per nevojat e grave dhe burrave.

❖ Objektivat e Komunës së Prizrenit:

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së qytetit
- Hartimi i planit zhvillimor të Komunës dhe planeve rregullative në zonat urbane
- Kthimi i të zhvendosurve në prona të veta
- Zhvillimi i sferës së Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale
- Ngritja e nivelit të Arsimit dhe Edukimit
- Zhvillimi i sferës së Kulturës, Sportit dhe Rinisë
- Promovimi dhe përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme
- Përmirësimi i nivelit të kooperimit ndëretnik
- Zhvillimi i turizmit kulturor, historik dhe malor
- Riatdhesimi i qytetarëve të kthyer.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

Objektivi i përgjithshëm:

- **Krijimi i politikave dhe programeve kulturore, rinore dhe sportive që gjatë hartimit dhe zbatimit të tyre të behet promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave;**

Objektivi specifik:

- **Sigurimi i mjediseve te favorshme per zhvillimin e aktiviteteve sportive te vajzave dhe grave duke mundesuar rritjen e pjesemarrjes se tyre ne jeten sportive, dhe tejkalimin e normave diskriminuese sociale.**

Indikatori:

- **Të nxitet krijimi i klubeve sportive vetëm për gra dhe vajza, ku në vitin 2022 ishte vetëm një klub i udhëhequr nga gratë, në vitin 2023 numri u shtua në 2, deri në vitin 2025 të jenë së paku 5 klube sportive të udhëhequra nga gratë dhe vajzat.**

Drejtoria e Bujqesise

➤ **Objektivi strategjik**

- Përmirësimi i dhe koordinimi i politikave komunale me qëllim të Inkurajimit të vazhdueshëm dhe mbështetjes së programeve për pjesëmarrje dhe përfitimeve të barabarta për gratë dhe burrat në sektorin e Bujqësisë në një nivel lokal, përmes promovimit të rëndësisë së rolit të grave në zhvillimin e bizneseve bujqësore ,pronësisë së tokës nga gratë, mbështetjes financiare për gratë për të filluar ose zhvilluar biznese vetanake bujqësore si dhe ofrimin e trajnimeve të specializuara për të përmirësuar aftësitë e tyre bujqësore dhe menaxheriale.

- Sqarim: Kjo do të ndihmojë të sigurohet që gratë dhe burrat të kenë një pjesë të barabartë në përfitimet dhe pjesëmarrjen në sektorin bujqësor në nivel lokal, e cila do të përmbushet nëpërmjet një sërë masash dhe politikash të orientuara drejt përmirësimit të barazisë gjinore në të gjitha aspektet e zhvillimit dhe menaxhimit të sektorit bujqësor.

➤ **Objektivi i pergjithshëm**

- Promovimi dhe mbështetja e grave dhe vajzave nga zonat rurale dhe sigurimi i programeve të ndryshme për fuqizimin e tyre me njohuri dhe shkathtësi në sferën e bizneseve bujqësore si dhe këshillime rrethë zhvillimit të vizionit për hapje të bizneseve, rrjetizimi i bizneseve te grave si dhe aksesin në burimet financiare dhe teknologjike;

➤ **Objekti specifike**

- Përmirësimi i përfaqësimit të grave dhe burrave në organet vendimmarrëse dhe **komisionet perzgjedhëse-vleresuese** të nivelit lokal të lidhura me sektorin e bujqësisë, përfshirë këshillat bujqësore dhe komitetet për zhvillim rural.

➤ **Indikatori gjinor**

Pjesëmarrja në vendimmarrje: Të rritet përqindja e grave në raport me burrat në vendimmarrje dhe komisionet perzgjedhëse që kanë të bëjnë me politikat bujqësore lokale, si **planifikimi i Strategjis së zhvillimit të bujqësië**

